

Fatbardha Reka

# LIBËR PËR MËSUESIN/EN

Matematika

6



BOTIME

pegi



Fatbardha Zogaj

LIBËR PËR MËSUESIN/EN  
**MATEMATIKA 6**

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

**BOTIME**



Prishtinë, 2024



## BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI  
Recensentë të MASHTI-t:  
?????????????  
Korrektore letrare: Oriada DAJKO  
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA  
Kopertina: Elvis BEJTJA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë  
ISBN: 978-9951-843-16-4

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024  
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Të gjitha tekstet letrare dhe joletrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.*

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Sektori i shpërndarjes:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** marketing@botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

# Hyrje

*“Mësuesilja mediokër tregon. Mësuesilja ile mirë shpjegon.  
Mësuesilja superior/e demonstroi. Mësuesilja madhështor/e inspiron.”*

*W. A. Ward*

Të nderuar mësues/e!

Libri i mësuesit për librin Matematika 6, ju vjen si një ndihmë për punën tuaj të përditshme në formë të një udhëzuesi e që është i bazuar në dokumentet bazë për Arsimin Parauniversitar të MASHTI-t. Libri Matematika 6 që është dedikuar për nxënësit e klasave të gjashta do të jetë më kuptimplotë për ju të dashur mësues/e kur do të përdorni edhe Librin e mësuesit dedikuar për të. Këtë libër do ta keni udhërrëfyes për punën tuaj në një vit shkollor me të gjitha dokumentet bazë që i duhen një mësuesi të matematikës për planifikim, zbatim dhe vlerësim.

Një planifikim i mirë nuk do të thotë vetëm një letër më shumë në portofolin e mësuesit/eses, por një skenar se si do të zhvillohet mësimdhënia, të nxënit, arritja e rezultateve të synuara dhe vlerësimi në klasë.

Në te do të gjeni: **Planin vjetor, Planet dymujor, Planin javor, Plane ditore**. Të gjitha këto janë punuar në formatin e dhënë në **Udhëzuesin praktik për zbatimin e Kurrikulës (fusha e kurrikulës MATEMATIKA, prill 2018)**.

Për të pasur më të lehtë përdorimin dhe zbatimin në praktikë të planeve dhe materialeve të tjera do t'u japim udhëzime dhe sqarime veç e veç për secilën nga to.

## Plani vjetor

Plani vjetor është i ndarë në dy periudha në të cilat janë shpërndarë temat të cilat janë marrë nga libri bazë Matematika 6. Periudha e parë fillon nga 1 shtatori deri në pushimin dimëror dhe periudha e dytë pas pushimit dimëror deri në pushimin veror. Plani vjetor përmban rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të cilat merren nga Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (gusht 2016). dhe përcaktohen bazuar në temat që do të shtjellohen për një vit shkollor, përkatësisht në klasën e gjashtë.

### Plani dymujor

Planet dymujore janë vazhdimësi e planifikimit vjetor të fushës/lëndës së Matematikës. Në planin dymujor fillimisht përzgjidhen temat (nga plani vjetor), përcaktohen rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen gjatë shtjellimit të temave për këtë dymujorësh. Gjithashtu ky planifikim përcakton dhe rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen për temat e përzgjedhura.

Në Planin dymujorësh përfshihen edhe rezultatet e të nxëniet për tema mësimore (nga plani lëndor) nga të cilat mësuesi/ja përcakton njësitë mësimore dhe orët për temën mësimore. Pjesë e Planit dymujor janë edhe metodologjitë e mësimdhënies, metodologjia e vlerësimit, lidhja me lëndë tjera mësimore dhe çështjet ndërkurrikulare dhe burimet. Të gjitha këto elemente të planit dymujor janë elemente që do t'i përdorim për planin ditor.

Për periudhën e parë janë planifikuar dy plane: Shtator-Tetor dhe Nëntor-Dhjetor, për periudhën e dytë: Janar-Shkurt, Mars-Prill dhe Maj-Qershor.

### Plani javor

Të gjithë mësuesit/et e një klase, të të gjitha lëndëve vendosin në një tabelë të përbashkët njësitë mësimore të planifikuara t'i realizojnë gjatë javës.(nga plani dymujor). Paraprakisht secili duhet të ketë planifikuar planin javorë për lëndën përkatëse. Ky plan përfshin njësitë mësimore, orët e përcaktuara për njësi dhe përshkrimi i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës.

### Plani ditor

Plani i orës mësimore ka për qëllim që të gjitha planifikimet e mëherëshme t'i bëjë të zbatueshme në punën me nxënësit në klasë dhe jashtë saj brenda një ore mësimore. Plani ditor është rrjedhojë e planit vjetor, dymujor dhe javor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore janë:

Fusha dhe lënda kurrikulare,

Shkalla e kurrikulës dhe klasa,

Tema (nga plani dymujor)

Rezultatet e të nxëniet të temës (nga plani dymujor),

rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës( të synuara),

rezultatet e fushës kurrikulare (të synuara).

Aspektet specifike të orës mësimore janë:

Njësia mësimore (nga rezultati/et e të nxënit të temës)

Fjalët kyçe- në planifikimet e orëve të punuar në këtë libër janë dhënë fjalët dhe togfjalëshat kyç për secilën njësi mësimore

Rezultatet e të nxënit për orë mësimore – përcaktohen nga mësuesi/ja dhe duhet të arrihen Brenda një ore mësimore duke shtjelluar njësinë mësimore. Ato duhet të përcaktohen duke zbatuar Taksonominë e Blumit dhe nivelet e njohjes tek nxënësit. Në planifikimet e orës që janë dhënë në këtë libër bashkë me rezultatet janë përfshirë dhe kriteret.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore – Përveç librit bazë Matematika 6, në planet e dhëna janë parashikuar të përdoren dhe shfrytëzohen edhe burime të tjera që mësuesi/ja mund t'i sigurojë lehtë. Psh veglat e gjeometrisë, kubet lidhëse, fletushkat e dyqaneve etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore (nga plani javor) – Mësimdhënia dhe nxënia është një zinxhirë lëndor që nuk mund të paramendohet si I ndarë. Nuk do të kishte kuptim të mësohet matematika pa u lidh me gjuhën shqipe, gjuhën e huaj, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore, jetën dhe punën. Me matematikën lidhen shumë situata jetësore dhe zhvillime në jetën reale, Kot nuk thuhet “Matematika është mbretëreshë dhe shërbëtore e shkencave”.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Fazat e orës, metodologjitë e mësimdhënies, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies dhe format e punës janë pjesët kryesore të kësaj pjese të planit të orës mësimore.

Ora mësimore në planifikim ndahet në tri faza të cilat duhet të kenë një lidhje të fortë dhe të pandarë.

*Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* (Rikujtimi i njohurive, gjithëpërfshirja, motivimi apo vendosja e qëllimit për të nxënë)

*Ndërtimi i njohurive të reja* (ndërtimi i njohurive, kontrollimi i njohurive)

*Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur* (Përforcimi i njohurive, krijimi i shkathtësive për komunikim, përgatitja e nxënësve si mendimtarë kritik, krijues dhe zgjidhës të mirë të problemeve).

Metodologjitë e mësimdhënies: Me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen, bazuar në qasjen e integruar, bazuar në kompetenca, e diferencuar të çështjeve ndërkurrikulare dhe çështjeve jashtëkurrikulare janë përfshirë në planifikimin e bërë në të gjitha planet e këtij libri mësuesi.

Teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies si dhe aktivitete të ndryshme të të nxënit, që janë përdorur në planet e orës mësimore janë përshtatur niveleve dhe stileve të ndryshme të të nxënit te nxënësit për të synuar arritjen e rezultateve të të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave të përcaktuara me kurrikulë. Gjithashtu teknikat, strategjitë dhe aktivitetet zhvillojnë dhe zbulojnë shkathtësitë e nxënësve të përcaktuara për arritjen gjashtë kompetencave. Po përmend disa nga ato që i kemi përdorur dhe përshkruar në planet e orëve mësimore në këtë libër.

Stuhi mendimesh, DRTA, INSERT, Ndërthurja I dhe Ndërthurja II, Lexim me ndalesa, Ditari dypjesësh, Pesëvargëshi, Di/Dua të di/Mësova, Tryeza e rrumbullakët, Turi i galerisë, Stilolapsat ne mes, Pema e mendjes, Diagrami i Venit, Gjeje titullin, Një dy tre hop (Lojë duke numëruar në rreth secili nxënës. Ai që duhet të thotë numrin shumëfish të 2 ose 3 ose 4 ose... që kemi zgjedhur thotë fjalën hop. Kush gabon len lojën).

## **Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi në orët mësimore është bazuar në parimet e vlerësimit: transparencë, vlefshmëri, besueshmëri

dhe paanshmëri. Ai është vlerësim i vazhdueshëm (nëpër orët mësimore me anë të instrumenteve të përcaktuara me listën e kontrollit të njohurive dhe formave të tjera p.sh. ngjyrat e semaforit, fytyrat. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë është përfshirë në disa planifikime të orës mësimore. Vlerësimi sumativ (vlerësimi përmbledhës) është paraparë në fund të çdo teme me një përsëritje dhe një testi vetëvlerësues përmbledhës ku synohet të vlerësohen dhe vetëvlerësohen nxënësit për arritjet e rezultateve të të nxënimit të temës përkatëse.

### **Detyrat dhe puna e pavarur**

Janë paraparë detyrat dhe puna e pavarur që u jepet nxënësve të punohen në shtëpi dhe që janë të dhëna në Matematika 6-fletore e pune.

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëreflektim, vetëvlerësim për mbarëvajtjen e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

*Në planifikimin që po ju ofrojmë ne përmes Librit të mësuesit ju keni të dhëna 134 orë mësimi të planifikuar nga 148 sa parashihen në Planin mësimor për klasën e gjashtë. Orët e paplanifikuara në plane orësh mësimore (14 orë) janë shpërndarë nëpër temat e caktuara në katër planet dymujore, përkatësisht dy plane mujore. Këtu kemi menduar orët që ju duhen për projekt, për ndonjë aktivitet jashtëkurrikularë apo ndërkurrikularë që ju keni autonominë e plotë ta planifikoni dhe t'ia caktoni orët në planin dymujor, ku ju mund ta realizoni. Në planin vjetor kemi vendosur disa rezultate të kompetencave që do të arrihen pikërisht përmes projektit apo aktiviteteve jashtëkurrikulare apo ndërkurrikulare.*

*Gjithashtu ju keni mundësinë e ndryshimit të planit të ofruar, duke vlerësuar njësitë mësimore nga libri bazë p.sh. dy njësi t'i fuziononi në një, apo një njësi mësimore ta ndani, por duke pas kujdes që të mos anashkaloni rezultatet e të nxënimit për temë mësimore.*

*Si mësuesle matematike duhet të nxisim te nxënësit idenë se që të dish matematikën, do të thotë të kuptosh marrëdhëniet ndërmjet koncepteve të ndryshme matematike, të zgjidhësh problema të vërteta në mënyrë konkrete dhe që kanë kuptim për jetën dhe jo thjesht të dish të bësh llogari me numra.*

*Shpresojmë që ky Libër i mësuesit i Matematika 6 të jetë udhëzues për një punë të suksesshme, të frytshme dhe lehtë të realizueshme për ju. Qëllimi madhor i Kurrikulës që mësimdhënia dhe nxënia të jetë e bazuar në kompetenca që udhëhiqet nga qëllimet dhe parimet e arsimit parauniversitar le të jenë abc-ja e punës së mësuesit/ses.*

*“Nëse keni dështuar në planifikim, ju keni planifikuar dështimin”*

*Fullan*

*Emri i shkollës*

*Llogo e shkollës*

**Projekt**

*FUSHA: Matematikë*

*LENDA: Matematikë*

**Tema:**

**“Grumbullimi, përpunimi dhe interpretimin i të dhënave”**

**Klasa VI**

**Mësuesi/ja:**

\_\_\_\_\_

## **Tema: “Grumbullimi, përpunimi dhe interpretimin i të dhënave”**

**1 Kohëzgjatja:** Projekti do të zgjasë një periudhë kohore prej pesë javësh të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e matematikës.

**2 Klasat pjesëmarrëse në projekt: Klasat VI<sub>1,2,3,4,5</sub>.**

### **Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore për shkallë:**

#### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (komunikues efektiv):.**

**I.6** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**I.7** Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

#### **Kompetenca e të menduarit(mendimtar kreativ dhe kritik:**

**II.2** Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

**II.3** Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

#### **Kompetenca të mësuarit për të nxënë (nxënës i suksesshëm):**

#### **Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis (kontribues produktiv):**

**IV.4** Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

**IV.5** Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnimin të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.

**IV.7** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

#### **Kompetenca personale (individ i shëndosh):**

**V.3** Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.

**V.7** Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.

## Kompetenca qytetare (qytetar i përgjegjshëm):

**VI.1** Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

**VI.6** Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmer, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

**VI.8** Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

## 3 Rezultatet e të nxënimit për fushën e matematikës:

Nxënësi/ja lexon, kupton dhe interpreton të dhënat statistikore për të marrë vendime në jetën e përditshme. Ai/ajo demonstroi njohuritë e marra për grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave. Interpretimi i të dhënave perfeksionohet me përfshirjen e konceptit të modës, mesatares aritmetike, mesores.

- ☞ **Zgjidhja problemore:** Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të të dhënave të grumbulluara.
- ☞ **Komunikimi në/përmes matematikës/s:** Përdor terminologjinë matematikore për të përshkruar situata të ndryshme nga jeta e përditshme.
- ☞ **Lidhjet në matematikë:** Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.
- ☞ **Modelimi matematik:** Përdor tabelat dhe grafikët, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.
- ☞ **Përdorimi i teknologjisë në matematikë:** Përdor teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacion matematik.

## 4 Lista e njohurive që do të përforcohen

- Përcaktimi i pyetjes kërkimore, i qëllimit të studimit, hartimi i pyetësorit, përcaktimi i kampionit të nevojshëm për studim.
- Grumbullimi i të dhënave të pyetësorëve.
- Përpunimi i tyre, tabela e të dhënave.
- Moda, mesorja, mesatarja.
- Paraqitja grafike me anën e diagrameve të ndryshme.
- Interpretimi i të dhënave

## 5. Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve

Biseda me prindër, mësues.

**6. Baza material:** letra A4, flipchart, markera, fletë punëdore, foto, ngjitës.

**7. Partnerë** Mësues, prindër, nxënës.

## 8. Përshkrim i veprimtarive kryesore që do të kryhen.

- Diskutim me nxënësit/let lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.

- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës të nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Hartimi i pyetësorit, përzgjedhja e popullacionit në të cilën do të bëhet pyetësi
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, komunikimi me mësuesit, prindërit etj.
- Shpërndarja e punës në grupe, çift dhe individuale.
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë secili nga nxënësit/et.

## 9. Tematikat e orëve mësimore të planifikuara në planin mësimor.

**Ora 1.** Përzgjedhja e temës. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup.

**Ora 2.** Diskutim i pyetësorëve të përgatitura nga nxënësit/et dhe hartimi i draftit të projektit si rezultat i punës individuale dhe në grup. Shpërndarja e pyetësorëve në atë kampion ku është planifikuar të bëhet. Grumbullim i pyetësorëve.

**Ora 3.** Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

## 10. Temat e sugjeruara për çdo grup pune.

- ☞ Kënaqësia e nxënësve të shkollës për shërbimin arsimor që shkolla afron.
- ☞ Kënaqësia e komunitetit për shërbimin arsimor që shkolla afron.
- ☞ Bullizmi sa i pranishëm është në mes të nxënësve tanë në shkollë.
- ☞ Pyetësorë me klasat e gjashta.
- ☞ Rrjetet sociale që frekuentojnë më shumë, sa të mbrojtur janë gjatë përdorimit të këtyre rrjeteve sociale.
- ☞ Menaxhimi i kohës së lirë etj.

## 11. Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet duke marrë në konsideratë:

- Angazhimin e çdo nxënësi/e në mbledhjen e informacionit të kërkuar.
- Në pjesëmarrjen e tyre në sistemimin dhe përpunimin e informacionit.
- Në cilësinë e prezantimit.
- Saktësinë e drejtimit të pyetjeve apo të dhënies së përgjigjeve për pyetjet që drejton mësuesi apo një nxënës i grupit tjetër.

Vlerësohen nxënësit/et për punën në grup dhe angazhimin që treguan në ndërtimin e këtij projekti.

- **Vlerësimi** në grup.
- **Vlerësimi individual**
- **Vlerësimi** në çift.

### BUXHETI

LETRA A4	1PAKO X 3 euro=3 euro
FLIPCHART	3FLIPCHART x 4 euro=12 euro
MARKERA	1PAKO x 5 euro = 5 euro
NGJITES	6 COPË x 1 euro = 6 euro

**TOTALI 26 euro.** Shpenzimet për projekt sigurohen nga buxheti i shkollës.

## PLANI JAVOR

Klasa	Gjashtë VI	Muaji	Shtator	Java	E parë
	<b>Ditët e javës</b>	<b>Njësitë mësimore</b>		Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore	
	<b><i>E hënë</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkrimi dhe leximi i numrave natyrorë</li> </ul>	Gjuhët dhe komunikimi – shkrim dhe lexim		
	<b><i>E martë</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krahasimi i numrave natyrorë</li> </ul>	Gjuhët dhe komunikimi – mbiemra krahasues ( më i madh, më i vogël)		
	<b><i>E mërkurë</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Boshti numerik. Radhitja e numrave</li> </ul>	Shoqëria dhe mjedisi – Sipërfaqet e shteteve, vendosja në bosht e vlerave sipas rendit rritës të tyre		
	<b><i>E enjte</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrumbullakimi i numrave natyrorë</li> </ul>	Shoqëria dhe mjedisi – Numra dhe vlera të mëdha, si popullsia, sipërfaqja e shteteve. Lartësitë e maleve etj.		
	<b><i>E premte</i></b>				

## PLANI VJETOR - 2023 /2024

### Fusha e kurrikulës: Matematikë Klasa: VI (E gjashtë )

Lëndët e fushës I kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës	
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)			
	Shtator-Tëtor	Nëntor-Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars-Prill	Maj-Qershor	
Matematikë:	Numrat natyrore	Gjeometria në rrafsh	Numrat dhjetorë	Numrat e plotë	Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë	<b>I.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b> <b>I.2, 3, 4, 6.</b> <b>II.Kompetenca e të menduarit</b> <b>II. 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8.</b> <b>III.Kompetenca e të mësuarit</b> <b>III.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.</b> <b>IV.Kompetenca për punë jetë dhe mjedis</b> <b>IV.4, 5, 7.</b> <b>V.Kompetenca personale</b> <b>V. 4, 7.</b> <b>Kompetenca qytetare</b> <b>VI.1, 6, 8.</b>
	Gjeometria në rrafsh	Numrat thyesorë Figurat gjeometrike	Matje të madhësive gjeometrike	Shprehjet, ekuacionet inekuacionet  Matje madhësish të tjera (Gjatësia, masa, koha	Funksione dhe vargje numerike  Statistikë dhe probabilitet	

## PLANI DYMUJOR Shtator-Tetor

**Fusha e kurrikulës: Matematikë Lënda mësimore: Matematikë Klasa: VI (gjashtë)**

**Tema mësimore:** Numrat natyrorë, Gjeometria në rrafsh

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

I.1, I.2, I.3, I.4, I.6, II.1, II.4, II.5, II.6, II.7, II.8, III.2, III.3, III.5, III.6, III.7, VI.6.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

I.1, I.2, I.4, 2.3, 2.5, 3.1, 3.2, 3.4, 3.5, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.3, 6.3, 8.1.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat natyrorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon 10 shifrat-simbolet për paraqitjen e numrave natyrorë; në bazë të tyre dallon sistemin numerik dhjetor (me bazë 10);</li> <li>shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër;</li> <li>vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata;</li> <li>modelon radhitjen e numrave, duke zbuluar rregullën;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkrimi dhe leximi i numrave natyrorë</li> <li>Krahasimi i numrave natyrorë</li> <li>Boshti numerik. Radhitja e numrave</li> <li>Rrumbullakimi i numrave natyrorë</li> <li>Mbledhja e numrave natyrorë. Vetitë e mbledhjes</li> </ul>	24	Mësimdhënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen	Vlerësim i vazhdueshëm Vetëvlerësim Vlerësim i ndërsjell Ngjyrat e semaforit Fytyrat 😊 😞 Lista e kontrollit Detyra kontrolluese Test vlerësues	Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna Distancat e mëdha rrugore, sipërfaqet dhe popullsia e shteteve, statistika në ekonomi, ndërtimtari etj.	Matematika 6 Fletore pune 6 Geogebra Zhvillimi i shkathrësive të shekullit 21 në matematikë Burime nga interneti Revista Plusi etj.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>kryen veprimet aritmetike <i>me</i> numra natyrorë (shumën, ndryshimin);</li> <li>zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore aritmetikore <i>me</i> numra natyrorë;</li> <li>përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes;</li> <li>modelon barazi <i>duke</i> përdorur veprimet <i>me</i> numra natyrorë;</li> <li>zgjdh probleme <i>duke</i> përdorur veprimet <i>me</i> numra natyrorë.</li> <li>përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj shumëzimit;</li> <li>kryen veprimet aritmetike (shumëzim, pjesëtim) me numra natyrorë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbritja e numrave natyrorë</li> <li>Mbledhja dhe zbritja e numrave në shpyllë</li> <li>Shprehjet numerike</li> <li>Problema</li> <li>Shumëzimi i numrave natyrorë. Vëtitë e shumëzimit</li> <li>Shumëzimi i numrave natyrorë</li> <li>Pjesëtimi pa mbetje i numrave</li> <li>Radha e kryerjes së veprimeve</li> <li>Pjesëtimi me mbetje</li> <li>Shumëfisha dhe faktorë</li> </ul>		<p><b>Teknika dhe strategjitë e mësimdhënies:</b></p> <p>Ditari dypjesësh Insert Tabela T Ndërthurja I Stuhi mendimesh Di/Dua të di/ Mësova Mendo/puno në dyshe/Thuaja grupit</p> <p><b>Format e punës:</b> Bashkëbisedim Punë e pavarur Punë në dyshe Punë në grup</p>			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore aritmetikore me numra natyrorë;</li> <li>• dallon numrat</li> <li>• çift e tek, të thjeshtë e të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre;</li> <li>• përkufizon plotpjesëtueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjesëtueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10;</li> <li>• zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë;</li> <li>• njehson PMP (duke zbatuar algoritmin e Euklidit) dhe ShVP të dy e më shumë numrave;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrat e thjeshtë dhe numrat e përbërë. Numrat çift dhe tek</li> <li>• Zbërthimi në faktorë të thjeshtë</li> <li>• PMP dhe ShVP i dy numrave natyrorë</li> <li>• Algoritmi i Euklidit për gjetjen e PMP të dy numrave</li> <li>• Rregulla të plotpjesëtimit</li> </ul>					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Gjeometria në rrafsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>• modelon barazi duke përdorur veprimet me numra natyrorë;</li> <li>• zgjidh probleme duke përdorur veprimet me numra natyrorë.</li> <li>• Pëshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin si koncepte themelore gjeometrike;</li> <li>• Përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të nxjerra;</li> <li>• Mat; krahason segmentet,</li> <li>• Ndërton simetralen e segmentit;</li> <li>• Vizaton drejtëza paralele dhe pingule</li> <li>• Përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë);</li> <li>• Vizaton kënde të ngushta dhe kënde të gjera;</li> <li>• Dallon njësitë për matje të këndeve (°, ’, ’’) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pika, drejtëza dhe rrafshi</li> <li>• Segmenti.</li> <li>• Gjatësia e segmentit</li> <li>• Këndi.</li> <li>• Krahasimi i këndeve. Shuma dhe ndryshimi i këndeve</li> <li>• Lloje të tjera këndesh</li> <li>• Matja e këndeve me këndmatës</li> <li>• Përgjysmorja dhe simetralja e këndit</li> <li>• Drejtëzat normale (pingule)</li> <li>• Simetralja (përmesorja) e segmentit</li> </ul>	10				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cakton masën e këndeve duke përdorë këndmatësin</li> <li>• Ndërton simetralen e këndit;</li> <li>• Përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algebrike dhe gjeometrike;</li> <li>• Dallon llojet e këndeve sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare);</li> </ul>						

**PLANI DYMUJOR Nëntor-Dhjetor**  
**Fusha e kurrikulës: Matematikë Lënda mësimore: Matematikë Klasa: VI (gjashtë)**

**Tema mësimore:** Gjeometria në rrafsh , Numrat thyesorë , Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjellimit të temës/ve:**

**I.2 ; I.4 ; I.6 ; II.2 ; II.4 ; II.5 ; II.8 ; III.2 ; III.3 ; III.4 ; III.5 ; III.6**

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjellimit të temës/ve:**

**1.1 ; 1.2 ; 2.1 ; 2.3 ; 2.5 ; 3.2 ; 3.3 ; 3.4 ; 4.1 ; 4.2 ; 4.3 ; 5.1 ; 6.1 ; 6.2 ; 8.1**

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Gjeometria në rrafsh	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Përcakton raportet ndërmjet koncepteve themelore: pikë, drejtëz, rrafsh dhe koncepteve të nxjerrta;</i></li> <li><i>Vizatton drejtëza paralele</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Largesa e një pike nga një drejtëz</li> <li>Drejtëzat paralele</li> </ul>	5	Mësimdhënia me nxënësin në qendër dhe gjithpërfshirja	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim i ndërsjell Detyra kontrolluese Vetëvlerësim Vlerësim përmbledhës (test) Lista e kontrollit	Gjuhët dhe komunikimi Shkencate natyres Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna Edukata fizike, sportet dhe shëndeti Distanca e mëdha rrugore, sipërfaqet dhe popullsia e shteteve , statistika në ekonomi, ndërtimtari, lëmi të ndryshme jetësore eij	Matematika 6 Fletore pune 6 Zhvillimi i shkathrësive të shekullit 21 në matematikë Revista Plusi Burime nga interneti GeoGebra

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat thyesorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>* identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit;</li> <li>* paraqet thyesat si pjesë të tërësishë;</li> <li>* dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier;</li> <li>* identifikon thyesat e barabartë;</li> <li>* thjeshton thyesat;</li> <li>* shndërron thyesat e parregullta në numra të përzier dhe anasjelltas;</li> <li>* cakton pjesën e dhënë të tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa;</li> <li>* paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i thyesës</li> <li>• Vetia themelore e thyesave</li> <li>• Thjeshtimi i thyesave. Thyesat dhe numrat natyrorë</li> <li>• Sjellja e thyesave në emërues të përbashkët</li> <li>• Krahasimi i thyesave</li> <li>• Mbledhja e thyesave</li> <li>• Numrat e përzier. Kthimi i thyesave të parregullta në numra të përzier</li> <li>• Zbritja e thyesave</li> <li>• Shumëzimi i thyesave</li> <li>• Thyesat e anasjella. Pjesëtimi i thyesave</li> <li>• Gjetja e pjesës dhe e së tërës</li> </ul>	15	<b>Teknika dhe strategjitë e mësimdhënies:</b>  Ditari dy pjesësh Insert Tabela T Ndërthurja I Stuhi mendimesh Di/Dua të di/ Mësova DRTA Tryeza e rrumbullakët Minileksion Lexim me ndalesa Stilolapsat në mes Lexo/puno në dyshe/thuaja grupit Teli për tharje Gushëkuqi rrethor			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>* <i>krhason thyesat duke shfrytëzuar boshhtin numerik, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale;</i></p> <p>* <i>kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin);</i></p> <p>* <i>zgjdh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa</i></p>						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet
Figurat gjeometrike	<ul style="list-style-type: none"> <li>* përkufizon trekëndëshin, elementet dhe llojet e tyre;</li> <li>* klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve;</li> <li>* cakton shumën e këndeve të një trekëndëshi;</li> <li>* përkufizon shumëkëndëshin dhe shumëkëndëshin e rregullt;</li> <li>* përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet dhe vetitë e tyre;</li> <li>* konstruktore trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin,</li> <li>* gjastkëndëshin rregullt;</li> <li>* njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) gjeometrike;</li> <li>* përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezen, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe qarkun;</li> <li>* konstruktore rrethin kur jepet rrezja dhe diametri.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumkëndëshat</li> <li>• Trekëndëshat</li> <li>• Katërkëndëshat. Trapezi. Paralelogrami</li> <li>• Drejtkëndëshi. Rombi. Katrori</li> <li>• Rrethi dhe elementet e tij</li> <li>• Ndërtimi i disa shumëkëndëshave me vizore dhe kompast</li> </ul>	14	<b>Format e punës:</b> Bashkëbisedim Punë e pavarur Punë në dyshe Punë në grup			

## PLANI DYMUJOR Janar-Shkurt

**Klasa: VI (gjashtë)**

**Matematikë**

**Lënda mësimore:**

**Fusha e kurrikulës: Matematikë**

**Tema mësimore:** Numrat dhjetorë, Matje të madhësive gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtrjellimit të temës/ve:**  
 I.2, I.6, II.4, II.5, II.6, III.2, III.3;

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtrjellimit të temës/ve:**  
 1.1, 1.2, 1.3, 2.2, 2.3, 2.4, 3.1, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.3, 6.3, 8.1,

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat dhjetorë	* përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 10000...); * shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjelltas; * shkruan, lexon, cakton vëndvlerat e shifrave; * rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë;	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i numrit dhjetor</li> <li>• Vëndvlerat e shifrave të numrit dhjetor</li> <li>• Krahasimi i numrave dhjetorë</li> <li>• Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë</li> </ul>	15	Mësimdhënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar Mësimdhënia dhe të nxëniti në qasje të integruar Metodologjia dhe nxënia e bazuar në kompetenca	Vlerësim i vazhdueshëm Vëtvlerësim Vlerësim i ndërsjell Ngjyrat e semaforit Fytyrat 😊 😞 Vlerësim me test Lista e kontrollit	Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna Distanca e mëdha rrugore, sipërfaqet dhe popullsia e shteteve, statistika në ekonomi, ndërtimtari etj.	Matematika 6 Fletore pune 6 Fletushkat e dyqaneve Revista Plusi Burime nga interneti

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>* përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 10000 etj.;</p> <p>* zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë;</p> <p>* kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdor makinën llogaritëse;</p> <p>* identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë;</p> <p>* shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje;</p> <p>* llogarit përqindjen e numrave;</p> <p>* përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.</p> <p>* përcakton njësitë matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit;</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrumbullakimi i numrave dhjetorë</li> <li>• Shumëzimi i numrit dhjetorë</li> <li>• Pjesëtimi i numrit dhjetorë me numër natyror</li> <li>• Pjesëtimi i numrave dhjetorë</li> <li>• Kthimi i thyesës së zakonshme në thyesë dhjetore.</li> <li>• Shprehje numerike me numra dhjetorë</li> <li>• Kuprimi i përqindjes</li> <li>• Zbatime të përqindjes</li> </ul>					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Matje të madhësive gjeometrike	<ul style="list-style-type: none"> <li>* përdor njësitë dhe mjjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret;</li> <li>* shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër;</li> <li>* këmben njësitë e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;</li> <li>* kryen matje të gjatësisë në situata problemore;</li> <li>* njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit;</li> <li>* njehson perimetrin dhe syprinën e drejkëndshit;</li> <li>* vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt;</li> <li>* këmben njësitë matëse të vëllimit (litri, decilitri, etj.);</li> <li>* përdor matjet dhe përvetëson formulat për caktimin e perimetrit, syprinës së sipërfaqes së figurave dhe vëllimin e trupave, si dhe zgjidh probleme nga situata reale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për matjen. Matja e gjatësive</li> <li>• Njësi të gjatësisë. Sistemi metrik</li> <li>• Veprime me njësitë e gjatësisë</li> <li>• Perimetrat e shumëkëndëshave</li> <li>• Syprinat e figurave</li> <li>• Syprina e drejkëndshit. Syprina e katrorit</li> <li>• Veprime me njësitë e matjes së syprinës</li> <li>• Vëllimet e trupave. Njësitë e vëllimit</li> </ul>	12	<b>Teknika dhe strategjitë e mësimdhënies:</b> Ditari trepjesësh INSERT Tabela T Ndërthurja I Stuhi mendimesh  Di/Dua të di/ Mësova Gjeje titullin Turi i galerisë Stilolapsat në mes Grupet e ekspertëve II Tryeza rrumbullakët Pesëvargëshi  <b>Format e punës:</b> Bashkëbisedim Punë e pavarur Punë në dyshe Punë në grup			

## PLANI MUJOR Mars-Prill

**Fusha e kurrikulës: Matematikë Lënda mësimore: Matematikë Klasa: VI (gjashtë)**

**Tema mësimore:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet, Numrat e plotë, Matje madhësisë të tjera (gjatësia, masa, koha)

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**  
**I.2; I.4; I.6; II.4; II.5; II.6; II.7; II.8; III.2; III.3**

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**  
**1.1; 1.2; 2.1; 2.3; 2.4; 3.5; 4.1; 4.2; 4.3; 5.1; 5.3; 6.3; 7.1**

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat e plotë	<ul style="list-style-type: none"> <li>* identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike;</li> <li>* përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero;</li> <li>* rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë;</li> <li>* identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i numrit të plotë</li> <li>• Paraqitja e numrave të plotë në boshtin numerik</li> <li>• Mbledhja e dy numrave të plotë</li> <li>• Zbritja e numrave të plotë</li> <li>• Shprehje numerike me mbledhje e zbritje me numra të plotë</li> </ul>	7	Mësimdhënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar Mësimdhënia dhe të nxënit në qasje të integruar	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim i ndërsjell Detyra kontrolluese Vetëvlerësim Vlerësim përmbledhës (test) Lista e kontrollit	Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Matematika 6 Fletore pune 6 Zhvillimi i shkathësive të shekullit 21 në matematikë Revista Plusi Burime nga interneti

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Shprehjet, ekuacionet inekuacionet	<p>* <i>krabason numrat e plotë në boshtin numerik;</i></p> <p>* <i>kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik;</i></p> <p>* <i>zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.</i></p> <p>* <i>shndërton shprehjet me simbole në shprehje me sftalë dhe anasjelltas;</i></p> <p>* <i>përkeufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre;</i></p> <p>* <i>zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur;</i></p> <p>* <i>paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes;</i></p> <p>* <i>zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet</i></p> <p>* <i>shndërton valutat e monedhave që përdoren në vendim tonë dhe vendet e tjera;</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehjet shkronjore</li> <li>• Shprehjet shkronjore.</li> <li>• Thjeshtimi i tyre</li> <li>• Barazimet numerike dhe vetitë e tyre</li> <li>• Ekuacioni</li> <li>• Ekuacioni <math>x + a = b</math> dhe <math>ax = b</math></li> <li>• Problema që zgjidhen me ekuacione me një ndryshore</li> <li>• Mosbarazime numerike dhe shkronjore</li> <li>• Inekuacione me një ndryshore</li> </ul>	11	<p><b>Teknika dhe strategjitë e mësimdhënies:</b></p> <p>Ditari dypjesësh INSERT Tabela T Ndërthurja I Stuhi mendimesh Di/Dua të di/ Mësova DRTA Tryeza e rrumbullakët Minileksion Lexim me ndalesa Stilolapsat në mes Teli për tharje</p>			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Matje madhësih të tjera (gjatësia, masa, koha)	<p>* përdor njësitë dhe mjetein e përshatshëm për të kryer një matje, në një rast konkret;</p> <p>* këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;</p> <p>* zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato;</p> <p>* kryen matje të masës, kohës dhe nxënësisë;</p> <p>* lexon dhe përdor sistemin 24-orësh;</p> <p>* llogarit kohën, duke përdorur njësitë matëse (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada, shekuj, mijëvjeçarë);</p> <p>* llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24-orësh;</p> <p>* përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike;</p> <p>* zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur matjet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paratë</li> <li>• Masa e trupit. Peshimi</li> <li>• Matja e kohës</li> <li>• Veprime me njësitë e kohës</li> <li>• Nxënësit e enëve (vëllimi i lëngjeve në to)</li> </ul>	8	<p><b>Format e punës:</b>          Bashkëbisedim          Punë e pavarur          Punë në dyshe          Punë në grup</p>			

## PLANI DYMUJOR Maj-Qershor

**Fusha e kurrikulës: Matematikë Lënda mësimore: Matematikë Klasa: VI (gjashhtë)**

**Tema mësimore:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë, Funksione dhe vargje numerike, Statistikë dhe probabilitet

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

I.2; I.3 I.4; I.6; I.8; II.2; II.3; II.4; II.5; II.6; II.7; II.8; III.2; III.3; III.4; III.5; III.6.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

1.2; 1.3; 1.4; 2.1; 2.2; 2.3; 3.3; 3.4; 3.5; 4.2; 4.3; 5.1; 6.2; 6.3; 8.1.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrik	<ul style="list-style-type: none"> <li>* paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës;</li> <li>* përkufizon simetrinë boshlore;</li> <li>* cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave;</li> <li>* përkufizon trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre;</li> <li>* përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi kënddrejtë koordinativ. Koordinatat e pikës</li> <li>• Simetria sipas një drejtëze (simetria boshlore)</li> <li>• Simetria boshlore në rrafshin koordinativ</li> </ul>	9	Mësimdhënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim i ndërsjell Detyra kontrolluese Vetëvlerësim Vlerësim përmbledhës (test) Lista e kontrollit	Gjuhët dhe komunikimi Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Matematika 6 Fletore pune 6 Zhvillimi i shkathhtësive të shekullit 21 në matematikë Revista Plusi Burime nga interneti Excel

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	* * përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet); * përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit); * paraqet hapjen e kubit dhe kuboideit në rrafsh dhe i ndërton ato.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumëfaqëshat</li> <li>• Kubi</li> <li>• Kuboidi</li> <li>• Hapjet e kuboideit dhe të kubit</li> </ul>		<b>Teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies:</b>  Ditari dypjesësh Insert Tabela T Ndërthurja I Stuhi mendimesh Di/Dua të di/ Mësova Tryeza e rrumbullakët Lexim me ndalesa Strilolapsat në mes			

Tëmat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Funksione dhe vargje numerike	<p>* paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ;</p> <p>* identifikon koordinatat e pikës (dyshe së renditur) në rrjetin koordinativ;</p> <p>* vendos pikat në rrjetin koordinativ;</p> <p>* dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Kuptimi i bashkësisë dhe ndryshorja</li> <li>● Çiftimi (shoqërimi) i elementeve të dy bashkësive</li> <li>● Funksioni</li> <li>● Tabelat dhe grafiku i funksionit</li> <li>● Vargje numerike</li> <li>● Vargje numerike në situata të ndryshme</li> </ul>	8	<p><b>Format e punës:</b></p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punë e pavarur</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Punë në grup</p>			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çëshjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Statistikë dhe probabilitet	<p>* grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike, etj. ) për të nxjerrë konkluzione;</p> <p>* Ilogarit mesataren aritmetike, modën, medianën nëpërmjet të dhënave;</p> <p>* përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.);</p> <p>* përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurt dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi;</p> <p>* përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj;</p> <p>* zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledhja dhe organizimi i të dhënave.</li> <li>Piktogramet</li> <li>Tabelat statistikore</li> <li>Diagramet me shylla</li> <li>Si të realizojmë një anketë</li> <li>Mesataret</li> <li>Kuptimi i probabilitetit</li> <li>Probabiliteti për ngjarjet me rezultate njëloj të mundshme</li> <li>Probabiliteti statistikor</li> </ul>	10				

# TEMA 1

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema :</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon 10 shifrat-simbolet për paraqitjen e numrave natyrorë, në bazë të tyre dallon sistemin numerik dhjetorë (dekad - me bazë 10), (10 njësha e bëjnë dhjetëshen, 10 dhjetëshe e bëjnë qindëshen, ...);</li> <li>- Shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër</li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> <b>I.6</b> -Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. <b>III.3</b> -Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> <b>1.1</b> - Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë. <b>5.1</b> - Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.			
<b>ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Njësia mësimore: 1.1</b> Shkrimi dhe leximi i numrave natyrorë			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyrorë, shifër, klasa, rend.			
<b>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkruan numrat natyrorë duke përdorur dhjetë shifrat për sistemin decimal të numrave.</li> <li>- Lexon numrat natyrorë sipas rregullës për vendvlerën e tyre.</li> <li>- Dallon numrat duke arsyetuar pozitën sipas vendvlerës së shifrave në klasa dhe rende.</li> <li>- Zbaton leximin dhe shkrimin e numrave shumëshifrorë në shembuj nga jeta e përditshme.</li> </ul>			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Matematika 6, Fletore pune, letër A4 dhe mjete të tjera ndihmëse.			
<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Shkrimi dhe leximi i numrave të mëdhenj në situata të ndryshme jetësore p.sh. Distanca e mëdha rrugore, sipërfaqet dhe popullsia e shteteve, statistika në ekonomi etj.			
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</b>			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë në grupe me nga 4-5 nxënës për t'iu përgjigjur çështjeve të rubrikës “**Kërkoni dhe zbuloni**”.

- Cilat janë shifrat që përdorim për të shkruar numrin natyror?
  - Cili është numri më i vogël natyror? Po më i madhi?
  - A tregon të njëjtën vlerë shifra 4 në numrat: 45; 134; 45 560;? Argumentoni përgjigjen.
- Merr disa përgjigje nga nxënësit/et për pyetjet e shtruara.
- Shifrat që përdorim për të shkruar numrat natyrorë janë: 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
  - Numri më i vogël natyrorë është 1. Numrat natyrorë janë të pakufizuar, andaj nuk mund të përcaktohet më i madhi.
  - Jo. Te 45 tregon dhjetëshe, 134 tregon njëshe dhe 45 560 tregon dhjetë mijëshe.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Në bashkëbisedim me nxënësit/et, nëpërmjet shembujve të rubrikës “**Vrojtoni dhe mësoni**”, kujtohen:

- Cilat janë shifrat që përdoren për shkrimin e numrit natyror?
- Si shkruhen dhe lexohen numrat natyrorë?
- Si varet vlera e shifrës nga rendi i saj?
- Jepni ju një shembull, p.sh.: çfarë vlerë ka shifra 1 në numrat e mëposhtëm: 1 235 ,121, 41 034.
- Cilat janë klasat që njohin nxënësit/et dhe rendet për secilën klasë?

U kërkohet nxënësve të shkruajnë në tabelë numra natyrorë, ta ndajnë në klasa dhe ta lexojnë atë.

Të tregojnë vlerën për secilën shifër.

Shembull 1: Lexoni dhe shkruani me fjalë numrin që tregon sipërfaqen e shtetit në km<sup>2</sup>.

Shteti	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )
Shqipëria	28 748
Gjermania	357 021
USA	9 831 510
Kosova	10 908

Shembull 2: Plotësoni tabelën, duke shkruar shifrat e numrave të vlera përkatëse.

Numri	Njëqind mijëshe	Dhjetë mijëshe	Një mijëshe	Qindëshe	Dhjetëshe	Njëshe
354 278	3	5	4	2	7	8
277 103						
31 254						
1507						
300						

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur:** Punë në grupe dyshe

Nxënësit/et të punojnë në dyshe ushtrimet e rubrikës “**Ushtroni duke zbatuar**” dhe “**Zbatoni në praktikë**”.

1. Në shkrimet për disa numra natyrorë, të dhënë më poshtë, shifra 0 nuk duhet vendosur. Bëni korrigjimin.

2503; 0250; 1001; 0035.

2. Lexoni numrat: 253; 4279; 54923; 300420; 8450900.

3. Shkruani numrat:

Dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre; tridhjetë e pesëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një; treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind.

Përfaqësues të dysheve të nxënësve japin zgjidhjen e ushtrimeve në tabelë. Gjatë prezantimit të zgjidhjes kërkohet argumentimi i përgjigjes së ushtrimit. Bashkëbisedohet për shembullin e dhënë nga praktika. Ftohen nxënësit/et të japin shembuj të tjerë. Kërkohet nga nxënësit/et që të ndarë në grupe të punojnë ushtrimet tek teksti i nxënësit.

1. Agimi numrin pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e tetë e shkroi 58 678. Si lexohet numri që shkroi Agimi? A ka vepruar drejt? Si duhet shkruar?

2. Një shoqëri tregtare, gjatë një jave, shiti 6 makineri me vlerë 1000 euro dhe 5 pajisje me vlerë 100 euro. Sa euro arkëtoi kompania gjatë kësaj jave?

Nxënësit/et udhëzohen të kontrollojnë dhe vlerësojnë mënyrën dhe saktësinë e zgjidhjes së detyrave të shokut që ka në krahun e djathtë secili në grup, duke i vendosur në fund të fletës simbole:

\* - plotësisht saktë

+ - pjesërisht saktë

? - pasaktë

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Duke përdor teknikën e vlerësimit me ngjyrat e semaforit, nxënësit/et vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi.

Në pjesën ku nxënësit/et prezantojnë rezultatet e arritura për njëri tjetrin aplikohet vlerësim i ndërsjellë.

### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

### **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE**

### ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema :</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata;</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b></p> <p><b>II.4</b> Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p><b>III.2</b> Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.</p>			
<p><b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b></p> <p><b>1.2</b> Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.</p> <p><b>3.4</b> Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit , të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike</p> <p><b>4.2</b> Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).</p>			
<b>ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Njësia mësimore:</b> 1.2 Krahasimi i numrave natyrorë			
<b>Fjalët kyçe:</b> krahasim , renditje, më i vogël, më i madh			
<b>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahason dy e më shumë numra natyrorë në mes veti</li> <li>- Rrenditë nga më i madhi, përkatësisht më i vogli numrat natyrorë dhe zeron duke i shkruar me radhë</li> <li>- Dallon konceptet „barabartë“ , „më i madh“ dhe „më i vogël“ duke përdor simbolet = , &gt; , &lt; .</li> <li>- Vlerëson rëndësinë e krahasimit të numrave natyrorë në jetën reale duke përdor shembuj të ndryshëm.</li> </ul>			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Matematika kl.6 , Fletore pune , kube e lapsa të madhësive të ndryshme.			
<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Fusha: Shoqëria dhe mjedisi Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “më pak apo më shumë” dhe “më i vogël apo më i madh”			
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</b>			

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në dyshe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që të diskutojnë në dyshe dy shembujt e dhënë në rubrikën “**kërkoni dhe zbuloni**” që i përket **Krahasimi i numrave natyrorë**.

“Iliri qëndroi në bibliotekën e shkollës 30 min, Mira qëndroi 55 min dhe Era 40 min.”

- Cili qëndroi më shumë? Po më pak?

“Secili prej tyre mori për të lexuar nga një libër përkatësisht me 150 faqe, 90 faqe dhe 180 faqe.

- Cili nga librat kishte më shumë faqe? Po më pak?
- Si vepruat për të krahasuar numrat e mësipërm?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Nxënësit/et udhëzohen të lexojnë në librin e tyre rubrikën **vrojtoni dhe mësoni** duke u fokusuar në përkufizimin që kërkohet të mbajnë mend se si krahasohen numrat natyrorë me shumë shifra. Ata diskutojnë bashkë me mësuesin/en për shembujt të cilët do t'i sqarojnë bashkërisht duke i shkruar në tabelë :

Krahasoni numrat natyrorë:

- a) 353 dhe 53; b) 2324 dhe 324. c) 345 dhe 245; d) 2353 dhe 7353 e) 6479 dhe 6479

Renditini në rritje numrat natyrorë:

- a) 935; 743; 105; 243; 1@111.  
b) 9@435; 8@271; 9@344; 2@923.

Nxënësit/et në grupe zgjidhin detyrat e dhëna në rubrikën **ushtrohuni duke zbatuar**

1. Krahasoni 3572 me 3529;
2. Vini shenjën < apo > ndërmjet numrave 15722; 15726.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve** të arritur: Punë në grupe

Për shembullin e dhënë tek rubrika **zbatoj në praktikë** mësuesi/ja kërkon nga që të grupuar nga 4 nxënës/e ta zgjidhin dhe të përgjigjen në pyetjet e parashtruara duke argumentuar përgjigjen bazuar në tabelën ku janë dhënë diametrat e tetë planeteve të sistemit diellor.

Planeti	Diametri (km)
Mërkuri	4@840
Venusi	12@104
Toka	12@756
Marsi	6@760
Jupiteri	140@700
Saturni	120@700
Urani	50@800
Neptuni	4@950

- a) Cili planet ka diametrin më të madh? Po më të vogël?  
b) Cili planet ka diametër më të vogël se Toka, por më të madh se Marsi?

Për të kontrolluar dhe vlerësuar të nxënësit e kësaj njësie mësimore mësuesi u kërkon që secili nxënës të shkruaj një shembull ( problem ) duke përdorë krahasimin e numrave.

P.sh. ata mund të japin këtë detyrë për ta zgjidhur:

“Me shifrat 3,0,4,7 shkruani të gjithë numrat natyrorë që fitohen prej tyre dhe radhitni ata sipas radhës rritëse.”

“Fituesi i Gjysmë-maratonës së 17-të Ndërkombëtare “Prishtina 2017” është keniani, Benard Muinde Matheka, i cili shtegun prej 21 kilometra e vrapoi për 3953 sekonda. Finalistja e parë nga femrat ishte Betty Chepleting po ashtu nga Kenia, e cila shtegun prej 21 kilometra e përfundoi për 4584 sekonda. Cili/a mbërriti i pari në shteg?”

**Vlerësimi i nxënësve:**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et gjatë gjithë orës duke vëzhguar të nxënit në dyshe, angazhimin në grup dhe mënyrën e saktësinë e zgjidhjes së detyrave.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE**

**ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i radhit ata.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 6 Interpretton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:**

3. 5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Boshti numerik. Radhitja e numrave**

**FJALËT KYÇE: Drejtëz e orientuar, segment njësi, bosht numerik, radhitje e numrave.**

### Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- vizaton boshtin numerik me ndarje të sakta përmes segmentit njësi;
- cakton numrat natyrorë, të dhënë në shembuj, në boshtin numerik ;
- radhit numrat në boshtin numerik duke filluar me numrat më të vegjël në anën e majtë kah ata më të mëdhenj në anën e djathtë;
- arsyeton vendndodhjen e numrave paraardhës përkatësisht pasardhës në boshtin numerik duke i vendosur sipas radhës në boshtin numerik.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, Fletore pune, vizore, enë e shkallëzuar kuzhine.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

**Fusha:** Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

Zbatimi në jetën e përditshme i ndarjeve në njësi të barabarta. P.sh. vizorja, enët e shkallëzuara të kuzhinës, treguesi i shpejtësisë në makinë etj.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh (punë individuale dhe grupe)

Ftohen nxënësit të diskutojnë rreth situatës të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”: të vizatojnë në fletore një gjysmëdrejtëz të orientuar, të përzgjedhin njësinë ndarëse, të ndajnë gjysmëdrejtëzën në njësi të barabarta.

Çfarë kanë ndërtuar?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Me mënyrën e mësipërme u ndërtua boshti numerik. Çdo numri natyror i përket një pike në boshtin numerik.

Duke ditur vendosjen e pikave në boshtin numerik mund të radhitim numrat nga më i vogli te më i madhi ose anasjelltas.

Në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”, shembujt e dhënë konkretizojnë këtë veprim.

Bashkëbisedohet rreth këtyre shembujve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe dhe grupe

Nxënësve iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet e rubrikës “Ushtroni duke zbatuar”. Demonstron zgjidhja e ushtrimeve në tabelë duke kërkuar argumentimin e veprimeve.

Në ushtrimin 5 ku kërkohet radhitja e maleve sipas lartësisë që kanë nga më i ulëti te i larti, nxënësit do ta punojnë në dyshe duke i radhitur malet.

Ftohen nxënësit të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”, për të përforcuar njohuritë.

Nxënësit vlerësojnë punën e shokut të tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Gjatë kësaj ore mësimore, nxënësit/et vlerësohen për punën individuale, në dyshe dhe në grupe duke u bazuar në saktësinë e vizatimit të boshtit numerik, ndarjen e saktë në segmente njësi, radhitjen e numrave natyrorë sipas madhësisë.

Në argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Rrumbullakos numrat natyrorë.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I. 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

VI. 6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmer, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

5. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Rrumbullakimi i numrave natyrorë

FJALËT KYÇE: Rrumbullakim, dhjetëshe më e afërt, qindëshe më e afërt, mijëshe më të afërt.

#### Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- rrumbullakon numrat natyrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt;
- përcakton afërsinë e numrave të dhënë me numrin e fituar pas rrumbullakimit;
- arsyeton përdorimin e shenjës  $\approx$  (afërsisht) kur bëjmë rrumbullakimin e numrave natyrorë;
- vlerëson rëndësinë e përafërimit, rrumbullakimit të numrave natyrorë në shembuj nga jeta reale.

#### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, Fletore pune, fleta A4

#### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

**Fusha:** Gjuha dhe komunikimi

Nevoja për rrumbullakimin e numrave natyrorë në situata të ndryshme jetësore për të thjeshtuar llogaritjet ose për të mbajtur mend më lehtë numrat e mëdhenj me shifra të ndryshme e që nxënësit/et mund t'i arsyetojnë duke zbatuar rregullat e rrumbullakimit të numrave natyrorë.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe (Stuhi mendimesh/Di)** Ftohen nxënësit/et të diskutojnë rreth situatës së dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

- a) “Agimi është i gjatë 152 cm e 3 mm”
- b) “Largesa Prishtinë-Pejë është 72 km e 273 m”
- c) “Koncerti zgjati 2 orë e 32 sekonda”
- d) “Në stadium ishin 142259 spektatorë”

A është e nevojshme të jemi kaq të saktë në situatat e dhëna?

Si do të shpreheshit ju në këto raste?

A ia ndërron kuptimin apo saktësinë në fjalisë së dhënë, vlera që zëvendësuat?

#### Ndërtimi i njohurive të reja: Dua të di/Mësova

Nxënësit/et duke u konsultuar në grupe dhe duke dhënë secili prej tyre ide, formulojnë pyetjet:

- Në çfarë rastesh mund të bëjmë rrumbullakimin e numrave natyrorë?
- Cili është simboli që tregon rrumbullakimin e numrit natyrorë?
- Arsyetoni pse duhet zëvendësuar simbolin “=” me “ $\approx$ ” kur rrumbullakojmë numrat.
- Me cilën shifër duhet të zëvendësohen shifrat pas rrumbullakimit?
- Cila shifër përcakton kufirin e rritjes apo jo për një njësi të shifrës tek e cila bëhet rrumbullakimi?
- Si rrumbullakohet një numër natyrorë në dhjetëshen më të afërt?
- Si rrumbullakohet një numër natyrorë në qindëshen më të afërt?
- Si rrumbullakohet një numër natyrorë në mijëshen më të afërt?

Shembujt e dhënë në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” i ndihmojnë nxënësit për të dalë në përfundime të sakta për rrumbullakimin.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe (Turi i galerisë)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që të plotësojnë tabelën në fletën A4 e cila është e ndarë në katër kolona. Duke bashkëbiseduar, komentojnë rregullat e rrumbullakimit dhe plotësojnë kolonën e dytë, të tretë dhe të katërt sipas kërkesave të bëra. Në kolonën e parë janë të dhënë numrat nga mësuesi/ja.

Në fletën e dhënë A4, nxënësit /etdo të zgjidhin edhe detyrat nga libri, përkatësisht rubrika **“Ushtroni duke zbatuar”**. Në dy shembujt e parë nga kjo rubrikë, do të përdorin simbolin “ $\approx$ ” (lexohet afërsisht) për të treguar numrin e rrumbullakosur.

Secili grup, fletët A4 me detyrat e punuara do t’i vendosë në tabelën e punimeve.

Duke e vizituar tabelën dhe duke analizuar punimet e grupeve tjera, secili grup do të vlerësojë me letër ngjitëse me ngjyrë punimet.

Letra me ngjyrë të gjelbër – plotësisht saktë

Letra me ngjyrë të kaltër (blu) – pjesërisht saktë

Letra me ngjyrë të kuqe – pasaktë

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësohen për angazhimin në punën në grup, dhe përgjigjet individuale që japin. Duke përdor teknikën e vlerësimit të ndërsjellë me ngjyrat e letrave ngjitëse.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit/et udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (mbledhjen)

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

4. 3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike, në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

6. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore, duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Mbledhja e numrave natyrorë. Vetë të mbledhjes*

FJALËT KYÇE: **mbledhje, shumë, mbledhorë, plus**

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- mbledh dy a më shumë numra natyrorë duke u bazuar në rregullat e mbledhjes;
- demonstroi mbledhjen e dy numrave natyrorë në boshtin numerik;
- vërteton vetitë e mbledhjes në shembujt e dhënë duke përdorë barazitë e dhëna për to;
- zbaton në shembuj nga jeta e përditshme mbledhjen e numrave natyrorë dhe vetitë e mbledhjes.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, vizore

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Në situata jetësore, mbledhja si veprim matematikor do të përdoret pambarimisht.

Mbledhja është koncept që përdoret në të gjitha lëndët dhe fushat kurrikulare, pa dallim.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Ftohen nxënësit/et të diskutojnë rreth situatës të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

- Në parkingun pranë stadiumit janë 120 makina. Kjo sasi është 30 makina më e vogël se sasia e makinave në parkingun pranë autostradës. Cili është parkingu më i madh?

Në grupe me nga 6 nxënës, do të diskutojnë rreth detyrës dhe do të ndajnë fletën e fletores së tyre siç është dhënë më poshtë, duke shkruar formën e zgjidhjes së detyrës nga Agimi në të majtë dhe formën se si ata mendojnë se duhet zgjidhur, në të djathtë.

AGIMI	UNË
$120 - 30 = 90$ “Parkingju te stadiumi është më i madh se ai tek autostrada.”	$120 + 30 = 150$ “Parkingju tek autostrada është më i madh se ai te stadiumi.”

U kërkohet të diskutojnë dallimin mes zgjidhjes që bëri Agimi dhe asaj se si do ta zgjidhin nxënësit/et problemën.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim dhe lexim në dyshe

Duke pas parasysh se mbledhjen, si veprim me numra natyrorë, nxënësit e kanë mësuar gjatë gjithë shkollimit të tyre pesëvjeçarë, do t'i rikujtojnë elementet e mbledhjes duke lexuar dhe komentuar me ta pjesën e mësimit në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Mësuesi/ja do t'i paraqesë në tabelë boshtin numerik, ndërsa nxënësit do të demonstrojnë në fletore mbledhjen në mënyrë grafike.

Nxirren vetitë e mbledhjes duke punuar nxënësit në grupe.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Stilolapsat në mes (Punë në grupe).

Nxënësit të ndarë në grupe zgjidhin katër shembujt e dhënë në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar”.

Kur mbarojnë detyrat, nxënësit i vënë lapsat me të cilët kanë zgjidhur detyrat në mes të tavolinës dhe mësuesi/ja përmes lapsit përzgjedh nxënësin që do të zgjidhë një detyrë në tabelë. Kështu veprohet me radhë në disa grupe derisa të zgjidhin detyrat që kanë punuar së bashku.

### Vlerësimi i nxënësve:

Mësuesi/ja vlerëson punën dhe angazhimin e nxënësve në dyshe dhe në grup.

Nxënësit vlerësohen individualisht për saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe zgjidhjes së detyrave.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (zbritjen).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

6. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Zbritja e numrave natyrorë

FJALËT KYÇE: zbritje, Ndryshim, zbritës, i zbritshëm, minus.

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- zbrit dy numra natyrorë duke aplikuar rregullat e zbritjes;
- dallon zbritësin, të zbritshmin dhe ndryshimin në detyrat që zgjidh;
- demonstroi zbritjen e dy numrave natyrorë duke i përcaktuar në boshtin numerik;
- zbaton në situata të jetës së përditshme rastet ku duhet të njehsohet zbritja me numra natyrorë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, vizore dhe fletë A4

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Në situata jetësore zbritja, si veprim matematikor do të përdoret shumë shpesh.

Zbritja është veprim që përdoret në të gjitha lëndët dhe fushat kurrikulare.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe

Nxënësit/et ftohen të diskutojnë rreth situatës së dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

- Për të arritur te ne, dritës së nisur nga Ylli Polar i duhen 430 vjet. Në cilin vit është nisur drita e këtij ylli që ne shohim sot?

Cilin veprim aritmetik do të kryejnë për të zgjidhur situatën problemore?

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim dhe punë në grupe**

Zgjidhja e situatës së mësipërme kërkon kryerjen e veprimit të zbritjes:  $2018 - 430 = ?$

Nëpërmjet shembujve të dhënë në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” kujtohet si zbriten dy numra natyrorë:

a) me ndihmën e boshtit numerik;

b) duke zbritur shifrat e të njëjtit rend.

Kush quhet i zbriteshim, zbritësi, ndryshimi? Shembuj.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe dhe në dyshe**

Nxënësit/et e ndarë në grupe nga 4-5 vetë zgjidhin shembujt e dhënë në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar”. Nxiten nxënësit/et t’i zgjidhin detyrat në fletë A4 dhe pastaj ta vendosin në tabelë.

Diskutohen zgjidhjet dhe argumentimi i saj nga përfaqësues të grupeve.

Në fund vendosin për pikëzimin e detyrës së secilit grup duke u bazuar në mënyrën dhe saktësinë e zgjidhjes së detyrës.

3 pikë – nëse grupi ka kryer detyrat pa gabime.

2 pikë – nëse grupi ka ndonjë gabim në detyra.

1 pikë – nëse grupi ka shumë gabime në detyra.

0 pikë – nëse grupi nuk i ka punuar fare detyrat.

Nxënësve u jepet detyrë që për të argumentuar zbatimin në praktikë, të krijojnë nga një problem matematikor në lidhje me zbritjen e numrave natyrorë dhe ta zgjidhin atë. Në detyrë të kërkohet që të vërtetojnë veprimin e zbritjes përmes mbledhjes dhe të sqarohet lidhja (dallimet) mes këtyre dy veprimeve. Secili grup do të komentojë detyrën e zgjidhur dhe të provojë saktësinë e zgjidhjes duke e kthyer në mbledhje veprimin e zbritjes.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Mësuesi/ja vlerëson punën në grupe dhe në dyshe duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit mes nxënësve. Ecuria dhe saktësia e zgjidhjes së detyrave do të jetë kriter në vlerësimin individual të tyre.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit/et udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

<b>ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema :</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> • - Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë, (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin).	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> <b>I.6</b> Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. <b>II.7</b> Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> <b>1.1</b> Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë. <b>2.3</b> Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore. <b>4.3</b> Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.			
<b>ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Njësia mësimore:</b> 1.7 Mbledhja dhe zbritja e numrave në shtyllë			
<b>Fjalët kyçe:</b> mbledhje, zbritje, shumë, ndryshim.			
<b>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</b> - Mbledh dy e më shumë numra natyrorë në shtyllë duke caktuar shumën e tyre. - Zbret dy numra natyrorë në shtyllë duke përcaktuar ndryshimin. - Zbaton në shembuj nga jeta e përditshme mbledhjen dhe zbritjen në shtyllë, si formë më praktike për këto dy veprime.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Matematika kl.6, Fletore pune			
<b>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Në situata jetësore, mbledhja dhe zbritja me numra të mëdhenj është shumë e shpeshtë kështu që veprimet kryhen në shtyllë, si proces më praktik.			
<b>PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë individuale</b>  Mësuesi/ja u jep nxënësve për detyrë që secili të zgjidhë në fletore shembullin e dhënë në rubrikën <b>Kërkoni e zbuloni</b> :“Libri ka 325 faqe. Zana ditën e parë ka lexuar 100 faqe. Sa faqe më tepër se ditën e parë duhet të lexojë për ta mbaruar librin?”			

Ai/ajo përcjellë secilin se në ç'formë e kanë zgjidhur detyrën dhe në tabelë u kërkon të dalin dy nxënës/e. Këta të dy mësuesi/ja duhet t'i zgjedhë bazuar në mënyrën se si i kanë kryer veprimet në rresht njëri, ndërsa tjetri në shtyllë. Do të pyeten nxënësit/et se cila mënyrë është më praktike për ta. Sigurisht që kur kemi të bëjmë me numra shumëshifrorë mbledhja dhe zbritja e numrave në shtyllë është më praktike andaj edhe duhet ta analizojmë dhe diskutojmë më gjerësisht.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Duke bashkëbiseduar në grup nga 5-6 nxënës/e do t'i zgjidhin detyrat e dhëna në rubrikën **vrojtoni dhe mësoni**.

$$\begin{array}{r} (1) \\ 873 \\ +945 \\ \hline 1818 \end{array} ; \quad \begin{array}{r} (1)(1) \\ 3647 \\ +1829 \\ \hline 5476 \end{array} \cdot \quad \begin{array}{r} 6 \\ 735 \\ -492 \\ \hline 243 \end{array} ; \quad \begin{array}{r} 496 \\ 5072 \\ -784 \\ \hline 4288 \end{array} \cdot$$

Bashkëbisedimin, sugjerimet dhe komentet në grup do t'i zgjerojnë duke zgjidhur detyrat:

1. Kryeni mbledhjen në shtyllë

$$\begin{array}{r} a) \\ 1354 \\ +2513 \\ \hline \end{array} ; \quad \begin{array}{r} b) \\ 21356 \\ +73231 \\ \hline \end{array} \cdot$$

2. A janë vendosur si duhet, poshtë njëri-tjetrit, mbledhorët në rastet e mëposhtme? Në qoftë se jo, bëni ndryshimet e duhura dhe pastaj kryeni mbledhjet.

$$\begin{array}{r} a) \\ 2634 \\ +54 \\ \hline \end{array} ; \quad \begin{array}{r} b) \\ 305 \\ +4234 \\ \hline \end{array} \cdot$$

3. Kontrolloni saktësinë e veprimit të mbledhjes dhe të zbritjes.

$$\begin{array}{r} 5478 \\ +788 \\ +8057 \\ \hline 14323 \end{array} ; \quad \begin{array}{r} 8674 \\ -2381 \\ \hline 6293 \end{array} ; \quad \begin{array}{r} 8547 \\ -629 \\ \hline 7918 \end{array} \cdot$$

4. Në tabelë është treguar vlera (në euro) e prodhimit të një fabrike mobiljesh për muajt janar, shkurt, mars. Plotësoni tabelën.

Prodhimi	Janar	Shkurt	Mars	Gjithsej
Karrige	4 567	5 639	4 945	
Tryeza	1 678	2 445	359	
Gjithsej				

5. Zëvendësoni pikat me shifra që të jetë i saktë përfundimi i veprimit.

$$\begin{array}{r} 84 \bullet 6 \\ a) + \bullet 59 \bullet \\ \hline \bullet 3 \bullet 47 \end{array} \qquad \begin{array}{r} 7 \bullet 9 \bullet 5 \\ b) + \underline{54 \bullet 76} \\ \hline \bullet \bullet 718 \bullet \end{array} \qquad \begin{array}{r} 4 \bullet 8 \bullet \\ c) - \bullet 5 \bullet 1 \\ \hline 1423 \end{array}$$

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve** të arritur: Punë në grupe **me nga 4-5 nxënës/e**

Për të forcuar dhe siguruar të nxënit e këtij mësimi u jepet për detyrë që secili grup nxënësish të zgjidhin një problem matematikor në lidhje me mbledhjen dhe zbritjen e numrave të mëdhenj natyrorë pra numrave shumëshifrorë.

1. Në Oqeanin Atlantik ka 3 ishuj që janë territore franceze (Martinika, Guadalupa, Sent Pjer e Mikelon) me sipërfaqe përkatësisht  $1128 \text{ km}^2$ ,  $1703 \text{ km}^2$ ,  $242 \text{ km}^2$ . Sa është sipërfaqja e përgjithshme e territoreve franceze në Atlantik?

2. Kryeni zbritjen dhe bëni provën e saj nëpërmjet mbledhjes.

a)  $1254 - 787$

b)  $54\,273 - 37\,884$

3. Në stacionin e parë zbritën nga autobusi 5 njerëz, kurse në stacionin e dytë zbritën 11 njerëz. Në fillim në autobus ishin 49 njerëz. Sa njerëz mbetën në të?

4. Dy shufra akulli ndryshojnë me 20 cm. Ato shkurtohen çdo minutë me 10 cm. Më e shkurtra e ka gjatësinë 50 cm. Sa do të jetë ndryshimi i tyre pas 7 minutash? Argumento përgjigjen, duke treguar vetinë që zbaton.

5. Për stadiumin me 18500 vende janë shitur 15356 bileta. A mund të futim në të 1550 turistë të ardhur në çastet e fundit para fillimit të ndeshjes?

#### **Vlerësimi i nxënësve:**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et në vazhdimësi për mënyrën dhe saktësinë e zgjidhjes së detyrave.

Vlerësimi i mësuesit/es do të përqendrohet në formën e zgjidhjes së problemave të marra nga jeta reale dhe saktësisë së zgjidhjeve të dhëna.

#### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

#### **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE**

<b>ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema :</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënimit të temës:</b> - Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë, (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin). - Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore aritmetikore me numra natyrorë.	
<b>Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b> <b>II.4</b> Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. <b>III.2</b> Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b> <b>3.1</b> Demonstron zbatimin e numrave racionalë në shprehje të ndryshme numerike dhe shkronjore. <b>4.1</b> Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore. <b>5.1</b> Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.			
<b>ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</b>			
<b>Njësia mësimore: 1.8</b> Shprehjet numerike			
<b>Fjalët kyçe:</b> shprehje numerike, vlerë e shprehjes numerike, radhë e kryerjes së veprimeve.			
<b>Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore:</b> - Përkufizon kuptimin e shprehjeve numerike duke thënë rregullën. - Përcakton radhën e veprimeve (mbledhje dhe zbritje) në shprehjet numerike pa kllapa dhe me kllapa gjatë zgjidhjes së detyrave. - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes në shprehje numerike për të gjetur vlerën e shprehjes numerike. - Analizon shprehjen numerike të formuar nga një problem matematikor i cili është dhënë me tekst duke e shëndërruar të dhënat me fjalë në “gjuhën e matematikës”.			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Matematika kl.6, Fletore pune dhe fletë A4.			
<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b> Gjuhë dhe komunikim Shoqëria dhe mjedisi Në situata të jetësore, çështjet dhe problemet e ndryshme duhet t'i kthejmë në “gjuhën e matematikës”, pra në shprehje numerike për t'ua gjetur vlerën.			

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që duke e diskutuar në grup t'a zgjidhin detyrën e dhënë në rubrikën **Kërkoni e zbuloni** te mësimi **Shprehjet numerike**. Ai/ajo i përcjellë se si po e zgjidhin dhe argumentojnë zgjidhjen e saktë të detyrës dhe në tabelë i shkruan zgjidhjet e detyrës, që disa nxënës/e nga grupet japin.

“Makina udhëtoi dy orë. Orën e parë, ajo përshkoi 85 km, kurse orën e dytë 13 km më tepër.”

Nga zgjidhjet e dhëna prej nxënësve, merren përgjigje të ndryshme, kështu që mësuesi/ja bënë pyetjet në vazhdim.

- Sa km përshkoi makina për dy orë?
- Cili nga numrat,  $85 + (85 - 13)$  apo  $85 + (85 + 13)$ ?
- Tregoni sa km përshkoi makina për dy orë?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale dhe punë në grupe (Ditari dypjesësh)

Nxënësit/et lexojnë në libër rubrikën **Vrojtoni dhe mësoni** dhe mësuesi/ja udhëzon ata/ato që fletën e fletores ta ndajnë në dy pjesë në formë të shkronjës **T**. Në anën e majtë të ndarjes të shkruajnë detyrën e dhënë dhe pjesët e hijezuara në përmbajtjen e mësimit dhe në anën e djathtë zgjidhjet e detyrave. Mësuesi/ja vepron njëjtë sikur nxënësit/et, pra e ndan tabelën në formë të shkronjës **T** dhe e plotëson ndarjen e majtë të tabelës me shembujt që i thonë nxënësit/et. Ndarjen e djathtë të tabelës e plotëson duke marrë përgjigjet e nxënësve dhe duke i komentuar së bashku me ta.

Detyra (zgjidhja e saj)	Radha e kryerjes së veprimeve
$36 - 11 - 9 + 12$	- kryejmë zbritjen e parë
$25 - 9 + 12$	- kryejmë zbritjen e dytë
$16 + 12 = 28$	- kryejmë mbledhjen
$35 - (21 - 6) + 41$	- kryejmë veprimin brenda kllapës
$35 - 15 + 41$	- kryejmë zbritjen
$20 + 41 = 61$	- kryejmë mbledhjen

Mësuesi/ja jep detyrën tjetër dhe kërkon nga nxënësit/et ta zgjidhin në grupe. Ai/ajo udhëzon nxënësit/et që në detyrë të përcaktojnë se cila pjesë tregon shprehjen numerike dhe cila vlerën e shprehjes numerike.

“Agimi lexoi ditën e parë 45 faqe të një libri, kurse ditën e dytë lexoi 15 faqe më pak.”

- Sa faqe lexoi Agimi ditën e parë?
- Po ditën e dytë?
- Sa faqe të librit lexoi për dy ditët e para Agimi?

- Ditën e parë Agimi lexoi 45 faqe.
- Ditën e dytë Agimi lexoi  $(45 - 15)$  faqe.
- Për dy ditë Agimi lexoi  $45 + (45 - 15)$  faqe.

Duke zgjidhur problemën krijohet një **shprehje numerike**.

$$45 + (45 - 15)$$

Nëse kryejnë veprimet saktë, do të fitojnë numrin 75 (**vlerë e shprehjes numerike**).

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve** të arritur: Punë në grupe

Të grupuar nga 5-6 nxënës/e zgjidhin detyrat e dhëna në fletë A1.

1. Gjeni vlerën e shprehjes numerike.

a)  $354 - 113 + 253$ ;

b)  $19 + (28 - 16)$ ;

c)  $(21 - 4) + (35 - 16)$ ;

2. d)  $30 + (65 - 4) - 16 + [10 - (35 - 32)]$ ;

e)  $1 - [25 - (15 + 10)] + (26 - 13)$ .

3. Shprehni me simbole matematike fjalitë e mëposhtme.

a) Ndryshimit të numrave 35 dhe 17 i zbritet shuma e numrave 8 dhe 5.

b) Numrit 100 i zbritet ndryshimi i shumës së numrave 10 dhe 15 me numrin 20.

4. Lumi Drini i Zi e ka gjatësinë 160 km. Lumi Drini i Bardhë është më i gjatë se Drini i Zi dhe ndryshimi i gjatësive të tyre është 125 km. Sa km është i gjatë lumi Drini i Bardhë?

5. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që së bashku në grup të formulojnë një shprehje numerike dhe duke zbatuar radhën e veprimeve të gjejnë vlerën e saj.

Duke aplikuar teknikën **Një rri të tjerët ikin** grupet vlerësojnë zgjidhjen e detyrave për secilin grup duke shkruar një koment në fletë.

Fletët A1 ekspozohen në tabelën e punimeve ose në muret e klasës.

#### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit/et për punën individuale, në dyshe dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave, respektimin e radhës së veprimeve dhe idetë që japin për të formuluar shprehjet matematikore.

#### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

#### **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema:</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Modelon barazi duke përdorur veprimet me numra natyror;</li> <li>• Zgjidh probleme duke përdorur veprimet me numra natyror.</li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b>			
<p><b>I.3</b> Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.</p> <p><b>II.4</b> Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p><b>III.2</b> Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p>			
<b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b>			
<p><b>2.3</b> Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.</p> <p><b>4.3</b> Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.</p> <p><b>5.1</b> Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<b>Njësia mësimore:</b> 1.9 Problema			
<b>Fjalët kyçe:</b> problem, të dhëna, zgjidhje, provë.			
<b>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</b>			
<p>-Zgjidh problema, kur janë të dhënat e plota për të parashtruar detyrën.</p> <p>-Zbaton hapat në parashtrimin e detyrës për zgjidhjen e problemave.</p> <p>-Argumenton formën e zgjidhjes së problemave duke sqaruar hapat e ndjekur për zgjidhje.</p> <p>-Vlerëson rëndësinë e veprimeve matematikore në zgjidhjen e problemave nga jeta reale duke provuar saktësinë e zgjidhjes.</p>			
<b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> Matematika 6, Fletore pune, fletë A4.			
<b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b>			
<p>Gjuhë dhe komunikim (problemat që shtrohen në formë të fjalive të analizohen dhe “përkthehen” në shprehje matematikore).</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi (dukuritë shoqërore në shembujt e dhënë)</p>			

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe

Duke u konsultuar në grup nxënësit/et do të zgjidhin në fletore detyrën e dhënë në rubrikën **Kërkoni e zbuloni**.

“Bardhyli kishte në bankë 13 200 euro. Ai depozitoi dhe 5 000 euro. Për të blerë një mjet transporti shpenzoi 6 800 euro.”

- Sa euro i mbetën?
- Si erdhët deri te përgjigja?
- A mund t'a vërtetoni se zgjidhja është e saktë?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa dhe punë në grupe

Mësuesi/ja lexon me zë me radhë shtatë hapat për zgjidhjen e problemave të dhëna në libër në rubrikën **Vrojtoni dhe mësoni**. Pas leximit të hapit të parë bënë pyetjet:

- Çfarë na udhëzon të bëjmë për të zgjidhur problemën ky hap?
- Çka na ndihmon në zgjidhjen e problemës kjo kërkesë?
- A na mjafton kaq për të gjetur zgjidhjen?
- Cili mendoni se është hapi tjetër për të zgjidhur problemën?

Këto pyetje mësuesi/ja i bënë pas secilit hap që e lexon. Për të zgjidhur një problemë duhen ndjekur këto hapa:

1. Lexoni me vëmendje tekstin e problemës.
2. Paraqitni shkurt të dhënat dhe kërkesat.
3. Hartoni një skemë të përshtatshme, duke shprehur lidhjen midis të njohurave dhe të panjohurave.
4. Hartoni planin e zgjidhjes.
5. Shkruani njehsimet që duhen bërë.
6. Jepni përgjigjen e problemës.
7. Mund të bëni edhe provën e zgjidhjes.

Pyetje-përgjigjet dhe bashkëbisedimin pas çdo hapi nxënësit/et e argumentojnë me shembullin:

1. Lexoni me vëmendje këtë problemë.

“Nxënësit/et e shkollës shkuan në ekskursion të shoqëruar nga 10 mësues. Gjithsej në ekskursion ishin 267 vetë. Numri i nxënësve vajza ishte 141. Sa ishte numri i nxënësve djem?”

2. Paraqitni të dhënat dhe kërkesën.

Të dhëna

Gjithsej (mësues, djem, vajza) 267

Mësues 10

Vajza 141

Kërkesa

Sa djem ishin?

3. Hartoni një skemë të përshtatshme.



4. Plani i zgjidhjes.

a) Gjeni sa ishte numri i mësuesve dhe vajzave.

b) Gjeni sa është numri i djemve.

5. Njehsimet.

a)  $10 + 141 = 151$  (mësues/e dhe vajza)

b)  $267 - 151 = 116$  (djem)

6. Përgjigje: Numri i djemve ishte 116.

7. Prova:  $10 + 141 + 116 = 267$ .

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve Të Arritur: Punë Në Dyshe

Nxënësit/et në dyshe zgjidhin në fletë A4 dy shembujt e dhënë në rubrikën **ushtrohuni duke zbatuar**. Njëri zgjidh shembullin 1 dhe tjetri shembullin 2. Detyrat i diskutojnë me njëri-tjetrin duke vënë theks te hapat që kanë kaluar për të zgjidhur detyrën dhe analizojnë saktësinë e zgjidhjes duke bërë provën së bashku.

Nxënësi 1. Në qytezën e Kaçanikut, numri i nxënësve të regjistruar vitin e shkuar ishte 1289. Ky numër është 134 nxënës më i vogël se numri i të regjistruarve sivjet. Sa nxënës janë regjistruar sivjet?

Nxënësi 1. Gjyshi (babai i nënës) ka lindur në vitin 1946. Ai ishte 29 vjeç kur lindi nëna dhe nëna ishte 29 vjeçe kur lindi motra. Në ç'vit ka lindur motra?

Nxënësi 2. Në kopshtin zoologjik janë dy elefantë. Njëri prej tyre peshon 5 092 kg, kurse tjetri peshon 1@173 kg më pak. A mund t'i ngarkojnë ata në një kamion të madh, që mban pesha deri në 10 ton?

Nxënësi 2 “Një pishinë u mbush për dy orë. Në orën e parë në të u derdhën 25 600 litra ujë, kurse në orën e dytë u derdhën 10 210 litra ujë më pak se në orën e parë. Sa litra ujë ka pishina e mbushur?”

Në fletë A4 vlerësojnë njëri-tjetrin me simbolet ☺ ☹.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit/et për punën në dyshe dhe në grup.

Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave argumentimin përmes provës.

Për kreativitetin dhe shkathtësitë në ndjekjen e hapave për zgjidhjen e problemave.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

### REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat natyrorë. Mbledhja dhe zbritja e tyre

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identifikon 10 shifrat-simbole për paraqitjen e numrave natyrorë; në bazë të tyre dallon.
- Sistemin numerik dhjetor (me bazë 10).
- Shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa, si dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër.
- Vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata.
- Modelon radhitjen e numrave, duke zbuluar rregullën përkatëse.
- Kryen veprime aritmetike me numra natyrorë (mbledhjen, zbritjen).
- Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë.
- Përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes.
- Modelon barazime duke përdorur veprimet me numra natyrorë.
- Zgjidh problema duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.2** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**III.2** Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**III.3** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)**

**FJALËT KYÇE: numrat natyrorë, vendvlerat, krahasimi, boshti numerik, veprimet aritmetike me numrat natyrorë, bashkësia N.**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- identifikon 10 shifrat-simbole për paraqitjen e numrave natyrorë; në bazë të tyre dallon sistemin numerik dhjetor (me bazë 10);
- shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa, si dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër;
- vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata;
- modelon radhitjen e numrave, duke zbuluar rregullën përkatëse;
- kryen veprime aritmetike me numra natyrorë (mbledhjen, zbritjen);
- zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë;
- përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes;
- modelon barazime duke përdorur veprimet me numra natyrorë;
- zgjidh problema duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuam:	Provoni të zgjidhni.
cilat janë dhjetë shifrat për paraqitjen e numrit natyror;	1. Shkruani numrin më të vogël dhe numrin më të madh gjashtëshifror që formohet me shifrat 0, 1, 2, 3, 4, 5: a) kur nuk lejohet përsëritja e shifrave; b) kur lejohet përsëritja e shifrave.
sa njëshe formojnë një dhjetëshe, sa qindëshe formojnë një mijëshe, sa njëqind mijëshe formojnë një milion etj.;	2. Gjej shifrën a nga barazimi: $23a49 = 20000 + 3000 + 800 + 40 + 9$ .
cilat janë klasat dhe vendvlerat për secilën klasë; si vepohet për të lexuar një numër;	3. Ndani në klasa numrat e dhënë. Lexoni dhe tregoni vendvlerat e secilës shifër: 12003; 139007; 2900034; 2004563; 34900000; 500034342; 10000234
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe** Udhëzohen nxënësit/et të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit. Ju jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet. Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit/et për saktësinë në përgjigjet e leximin dhe shkrimin e numrit natyror, në gjetjen e vendvlerave, në krahasimin e numrave natyrorë, në vendosjen e numrit në boshtin numerik, në kryerjen e veprimeve aritmetike, në gjetjen e vlerës së shprehjes aritmetike me numra natyrorë, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të përsërisin njohuritë e temës.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

Situatat e ndryshme dhe problemat në jetën e përditshme mund të paraqiten në forma të ndryshme dhe si të tilla shpesh zgjidhjen e gjejnë në matematikë.

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat natyrorë. Mbledhja dhe zbritja e tyre

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identifikon 10 shifrat-simbole për paraqitjen e numrave natyrorë; në bazë të tyre dallon.
- Sistemin numerik dhjetor (me bazë 10).
- Shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa, si dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër.
- Vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata.
- Modelon radhitjen e numrave, duke zbuluar rregullën përkatëse.
- Kryen veprime aritmetike me numra natyrorë (mbledhjen, zbritjen).
- Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë.

- Përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes.
- Modelon barazime duke përdorur veprimet me numra natyrorë.
- Zgjidh problema duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.2** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**III.2** Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**III.3** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Vlerësim

**FJALËT KYÇE:** numrat natyrorë, vendvlerat, krahasimi, boshti numerik, veprimet aritmetike me numrat natyrorë, bashkësia  $N$ .

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- identifikon 10 shifrat-simbole për paraqitjen e numrave natyrorë; në bazë të tyre dallon sistemin numerik dhjetor (me bazë 10);
- shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa, si dhe përcakton vendvlerën e secilës shifër;
- vendos numrat natyrorë në boshtin numerik dhe i krahason ata;
- modelon radhitjen e numrave, duke zbuluar rregullën përkatëse;
- kryen veprime aritmetike me numra natyrorë (mbledhjen, zbritjen);
- zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë;
- përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes;
- modelon barazime duke përdorur veprimet me numra natyrorë;
- zgjidh problema duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për saktësinë e zgjidhjes së ushtrimeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e leximin dhe shkrimin e numrit natyror, në gjetjen e vendvlerave, në krahasimin e numrave natyrorë, në vendosjen e numrit në boshtin numerik, në kryerjen e veprimeve aritmetike, në gjetjen e vlerës së shprehjes aritmetike me numra natyrorë, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

Situatat e ndryshme dhe problemat në jetën e përditshme mund të paraqiten në forma të ndryshme dhe si të tilla shpesh zgjidhjen e gjejnë në matematikë.

# ▽TEMA 2

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (shumëzimin)

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II. 1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati në shkollë ose të publikuar në media.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1. 1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

6. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore, duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave natyrorë. Vetitë e shumëzimit*

**FJALËT KYÇE:** Shumëzim, prodhim, herë, vetitë e shumëzimit.

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- shumëzon dy numra natyrorë duke u bazuar në rregullat e shumëzimit;

- dallon faktorët dhe prodhimin duke zgjidhur detyrat me veprimin e shumëzimit;

- vërteton vetitë e shumëzimit duke zbatuar barazitë e dhëna për to;

- zbaton shumëzimin e numrave natyrorë dhe vetitë e shumëzimit në shembuj nga jeta e përditshme.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave. Për kreativitetin dhe shkathhtësitë në grupet e ekspertëve.

Në veçanti do të vlerësohen në listën e kontrollit nxënësit që do të zgjidhin në tabelë detyrat e dhëna në fazën e fundit të orës.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (shumëzimin)

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I. 4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. 8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. 6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijës.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.
4. 1 Demonstron zbatimin e numrave racionalë në shprehje të ndryshme numerike dhe shkronjore.
8. 1 Përdor teknologjinë për hulumtime, llogaritje dhe matje, në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave natyrorë**

FJALËT KYÇE: **shumëzim, prodhim, herë, faktorë**

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- shumëzon numra natyrorë me dy e më shumë shifra duke llogaritur me mendje dhe shkrim;
- analizon shumëzimin e numrave duke komentuar rregullat e shkrimit të shifrave gjatë shumëzimit në detyrë;
- përdorë makinën llogaritëse në llogaritjen e shumëzimit në detyrë;
- zbaton shumëzimin e numrave natyrorë në shembuj nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar mënyra sa më praktike për llogaritje.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune dhe tabela e shumëzimit

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhë dhe komunikim

Shumëzimi është veprim matematikorë që paraqitet në situata të shumta jetësore dhe shpesh llogaritjet bëhen me mendje dhe duhet të jenë të shpejta.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për shembullin e dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni” dhe në dyshe, me shokun e bankës diskutojnë zgjidhjet e dhëna nga Zana dhe Mira.

Vajzat bënë këto njehsime:

$$\text{Zana: } 2 \cdot 60 = 120 \text{ cent}$$

$$2 \cdot 100 = 200 \text{ cent}$$

$$120 + 200 + 80 = 400 \text{ cent}$$

$$\text{Mira: } 2 \cdot 60 + 100 + 80 = 120 + 100 + 80 = 300 \text{ cent}$$

Mësuesi/ja bën pyetjet:

- Cila ka vepruar drejt për të zgjidhur detyrën?
- Kush ka gabuar dhe pse?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe nga 5 nxënës**

Tregoni si veproni për të shumëzuar dy numra natyrorë:

- a) kur njëri nga faktorët është numër njëshifror;

b) kur të dy faktorët janë numra dy ose më shumë shifrorë.

Shumëzoni në shtyllë numrin 437 me numrin dyshifror 35, për të argumentuar përgjigjet e dhëna për mënyrën e shumëzimit të numrave.

Shumëzohet në fillim numrin 437 me shifrën e njësheve (5) të faktorit të dytë:

$$437 \cdot 5 = 2185.$$

Shumëzohet pastaj numrin 437 me shifrën e dhjetësheve (3) të faktorit të dytë:

$$437 \cdot 3 = 1311.$$

Prodhimet e gjetura i vendosim njëri nën tjetrit, dhe i mbledhim.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe dhe në dyshe (Munde makinën llogaritëse)**

Mësuesi/ja shpërndan nga një makinë llogaritëse në grupe me nga 6 nxënës (nxënësit/es mund të kenë makinë llogaritëse me vete) dhe një fletë me nga 6 detyra. Tri detyra do të jenë shumëzim i dy numrave njëshifrorë dhe tri detyra shumëzim i numrave dy-tre shifrorë.

Grupi i parë:  $8 \cdot 7$ ;  $5 \cdot 3$ ;  $4 \cdot 6$ ;  $78 \cdot 86$ ;  $234 \cdot 9$ ;  $358 \cdot 24$

Grupi i dytë:  $6 \cdot 4$ ;  $2 \cdot 4$ ;  $5 \cdot 5$ ;  $38 \cdot 57$ ;  $307 \cdot 5$ ;  $741 \cdot 59$

Grupi i tretë:  $7 \cdot 3$ ;  $5 \cdot 8$ ;  $3 \cdot 9$ ;  $46 \cdot 82$ ;  $168 \cdot 7$ ;  $608 \cdot 43$

Grupi i katërt:  $9 \cdot 5$ ;  $7 \cdot 2$ ;  $4 \cdot 8$ ;  $65 \cdot 34$ ;  $568 \cdot 9$ ;  $814 \cdot 35$

Grupi i pestë:  $3 \cdot 8$ ;  $4 \cdot 7$ ;  $9 \cdot 2$ ;  $82 \cdot 16$ ;  $780 \cdot 8$ ;  $264 \cdot 49$

Duke luajtur lojën **Munde makinën llogaritëse**, nxënësit/et i zgjidhin me radhë detyrat dy nga dy. Njëri me makinë llogaritëse e tjetri me mendje. Në fund do të vijmë në përfundim se në rastet kur kemi shumëzim të numrave natyrorë njëshifrorë më e shpejt është mendja se sa puna makinën llogaritëse, në të kundërtën kur kemi detyra me numra dy a më shumë shifrorë, makinë llogaritëse na e lehtëson punën.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësohen për punën në dyshe dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave. Për kreativitetin dhe shkathtësitë në përdorimin e makinës llogaritëse.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (pjesëtimin).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

6. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Pjesëtimi pa mbetje i numrave

**FJALËT KYÇE:** Pjesëtim, pjesëtues, i pjesëtueshëm, herës

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- pjesëton dy numra natyrorë duke zbatuar rregullat e pjesëtimit;
- dallon rastet kur duhet shumëfishuar dhe kur duhet pjesëtuar duke kryer veprimet në shembuj nga situata jetësore;
- përcakton të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin duke zgjidhur detyrat me pjesëtim;
- gjykon rëndësinë e përdorimit të shpeshtë të pjesëtimit në situata jetësore duke analizuar dhe zgjidhur shembujt e dhënë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletë A1, markera

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, situata jetësore ku bëhen ndarje të elementeve.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinatë e drejtuar**

Mësuesi/ja paraqet para nxënësve një situatë imagjinare “Linda do të ndajë 3600 gr. arra në 12 qese me sasi të barabartë. Sa gram arra do të ketë secila qese?”


Nxënësve u lihet kohë për të diskutuar në grup rreth zgjidhjes së problemës. Më pas, problema diskutohet me gjithë klasën në tabelë. Gjatë diskutimit të problemës shtrohen pyetjet:

- Çfarë veprimi kryet për të gjetur sa gram do të ketë secila qese?
- A patët ndonjë vështirësi gjatë kryerjes së veprimit?
- Cilët janë hapat që ndoqët për të kryer pjesëtimin?

Zgjidhja e problemës shkruhet në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit/et që të lexojnë në librin e nxënësit, rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Sqarimet dhe shembujt e dhënë në këtë rubrikë t’i diskutojnë në grup.



Gjatë diskutimit me nxënësit rreth rubrikës që lexuan do të vëmë theksin në dy rregulla për t’u mbajtur mend:

- Pjesëtimi pa mbetje i numrave është veprim i kundërt i shumëzimit.
- **Pjesëtimi** është **veprim** që kryhet. **Herësi** është **numër** që gjendet.

Kërkohet nga nxënësit që të punojnë në grupe për të dhënë nga një shembull për vetitë e pjesëtimin.

Mësuesi/ja përgatitë një fletë A1 në të cilën më herët janë shkruar fjalët që korrespondojnë me veprimet mbledhje, zbritje dhe shumëzim dhe tani në të kërkon nga secili grup të shkruajnë nga një fjalë apo shprehje që lidhet me veprimin e pjesëtimin pa mbetje.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkëmbe një problem**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur problemat e dhëna në libër:

- Fabrika duhet të prodhonte 2100 makina për 25 ditë. Çdo ditë u prodhuan 21 makina më shumë se sasia e planifikuar. Për sa ditë u realizua prodhimi i planifikuar i makinave?
- Mollët që ndodhen në dy thasë, me masë 36 kg dhe 44 kg, do të ndahen në mënyrë të barabartë në arka, që mbajnë nga 10 kg. Sa arka duhen?

Pas përfundimit të zgjidhjes së detyrës, nxënësit e kontrollojnë zhvillimin e saj me shokun/shoqen pranë. Më pas, secili nxënës duhet të krijojë vetë një problemë, e cila zgjidhet nëpërmjet pjesëtimin të dy numrave. Problemat e krijuara i jepen për t’u zgjidhur shokut/shoqes pranë.

Disa problema diskutohen me klasën.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën në dyshe dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave. Për kreativitetin dhe shkathtësitë në përdorimin e makinës llogaritëse.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore aritmetikore me numra natyrorë.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.
4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Radha e kryerjes së veprimeve

**FJALËT KYÇE:** veprime e veprimeve

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përcakton radhën e veprimeve aritmetikore në shprehjet numerike pa kllapa dhe me kllapa;
- argumenton formën e zgjidhjes së problemave duke sqaruar hapat e ndjekur për zgjidhje;
- gjykon zgjidhjen që ndryshon nga llogaritja me makinën llogaritëse dhe me mendje të së njëjtës detyrë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune dhe makina llogaritëse

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhë dhe komunikim

Shoqëria dhe mjedisi (edukatë qytetare)

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim në grup**Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të zgjidhin në grup detyrën e dhënë në rubrikën “**Kërkoni dhe zbuloni**”.

- Gjatë muajit shtator një librari shiti 12 libra artistikë me çmim 25 euro, 5 albume me kafshë me çmim 20 euro dhe 4 fjalorë me çmim 40 euro secili.

Shkruani një shprehje për të gjetur sa euro arkëtoi libraria për këtë muaj. Njehsoni vlerën e shprehjes. Nxënësit në grupe duhet të kenë dhe kalkulatorë dhe të shkruajnë në fletore edhe vlerën e shprehjes së njëjtë që do të fitohet në makinën llogaritëse.

Kjo shprehje dhe zgjidhja e saj janë mënyra e saktë e rrugës që duhet ndjekur për të zgjidhur problema në të cilat ka më shumë se një veprim aritmetikor.

$$12 \cdot 25 + 5 \cdot 20 + 4 \cdot 40 = 300 + 100 + 160 = 560$$

Kur nxënësit ta llogarisin me makinën llogaritëse do të marrin zgjidhjen 244160.

Nxënësit do të reagojnë se pse ndodhi kjo.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Mendo/puno në dyshe/thuaja grupit**

Nxënësit e ndarë në grupe nga 4 nxënës (në këtë rast numri i nxënësve në grup duhet të jetë numër çift mund të jenë dhe gjashtë nxënës në grup) lexojnë në libër rubrikën “**vrojtoni dhe mësoni**”. Dy (tre) nxënës/e do të përgatisin dhe do të shpjegojnë për grupin rastin e parë kur shprehja nuk ka kllapa.

Këtë do ta ilustronë me një shembull duke dhënë shpjegime për radhën e veprimeve.

Dy (tre) të tjerët do të përgatisin dhe shpjegojnë rastin e dytë kur shprehja ka kllapa.

Shpjegimet e dhëna do t'i pasurojnë me një shembull ku do të paraqesin radhën e veprimeve.

Tani do t'i kthehen rezultatit të detyrës në fillim pse ndodhi që zgjidhja me makinën llogaritëse është e ndryshme nga ajo me mendje. Mësuesi/ja sqaron nxënësit se makina llogaritëse kryen veprimet ashtu siç i jepen me radhë, pa zbatuar rregullat e radhës së veprimeve.

Për ta mbajtur nxënësit më lehtë në mendje radhën e veprimeve, mësuesi/ja mund të përdorë si shembull zëvendësimin e katër veprimeve matematikore me anëtarët e një familje.

Shumëzimi dhe pjesëtimi – prindërit dhe mbledhja dhe zbritja – fëmijët.

“Kur në familje bisedohet për një çështje të përbashkët kush duhet të flasë i pari?” - pyet mësuesi/ja.

“Prindërit.” – thonë nxënësit.

“Cili nga prindërit?” – pyet mësuesi/ja.

Zakonisht nxënësit përmendin njërin nga ata (babain apo mamanë).

“Jo, do të flasë ai/ajo që është më i/e afërt me çështjen që po diskutohet, e pastaj do të vazhdojë tjetri” – thotë mësuesi/ja.

“Po pas prindërve, cili do të flasë? – pyet mësuesi/ja.

“Fëmijët” – përgjigjen ata.

“Cili nga fëmijët?”

“Ai që është më i/e afërt me temën për të cilën po flitet.”

Në vazhdim, nxënësit pyesin “Po kllapat çfarë tregojnë?”

“Kllapat paraqesin urgjencë. Duhet të respektohet radha e atyre që e kanë me urgjencë një punë.”

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja fton nxënësit që të punojnë në dyshe detyrat e dhëna për ushtrime duke zbatuar radhën e kryerjes së veprimeve aritmetikore në shprehje.

1. Kryeni veprimet në të dyja anët e barazimit. Kontrolloni nëse barazimi është i vërtetë ose jo.

a)  $8 : 8 + 0 : 5 + 4 \cdot 4 - 33 : 3 = 9 \cdot 6 - 1 \cdot 6 \cdot 40 : 5;$

b)  $55 : 5 \cdot 4 \cdot 1 : 11 = 7 \cdot 5 - 8 \cdot 4 + 56 : 7 - 42 : 6.$

2. Një paketë me 12 biskota peshon gjithsej 150 g kur është plot dhe 18 g kur është bosh (pa biskota). Sa është pesha e një biskote?

Mësuesi/ja aktivizon në tabelë tre nxënës nga grupe të ndryshme për të zgjidhur detyrat.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën në dyshe dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave. Në veçanti do të vlerësohen në listën e kontrollit nxënësit që do të zgjidhin në tabelë detyrat e dhëna në fazën e fundit të orës.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë (pjesëtimin).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte, duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III. 5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

- 2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
- 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Pjesëtimi me mbetje**

**FJALËT KYÇE: Pjesëtim, pjesëtues, i pjesëtueshëm, herës, mbetje**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- njehson herësin dhe mbetjen duke pjesëtuar dy numra natyrorë;
- dallon pjesëtimin pa mbetje nga ai me mbetje përmes shembujve që zgjidh;
- zbaton pjesëtimin me mbetje në shembujt nga situatat jetësore kur ndarja nuk mund të jetë e plotë (pas ndarjes së barabartë ka mbetje).

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune dhe fletë A1, markera

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**


Gjuhë dhe komunikim, situata jetësore ku bëhen ndarje të elementeve.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendjes (kllaster)**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën Pjesëtim dhe u kërkon nxënësve që të shkruajnë sa më shumë

fjalë që u bien në mend për pjesëtimin. Idetë e tyre dëgjohen dhe shënohen në tabelë.



### Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe dhe bashkëbisedim

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në mënyrë të pavarur detyrën.

- Si mund të veprojmë, nëse kemi 12 libra dhe duam t'i ndajmë midis:

a) 3 shokëve?

b) 5 shokëve?

Në cilin rast do të na mbeteshin libra? Argumentoni përgjigjen.

Diskutojnë në dyshe për të analizuar ndarjen e librave mes shokëve, në shembullin a dhe b.

Dëgjohen dhe shkruhen në tabelë përgjigjet e nxënësve dhe diskutohen dy rezultatet e fituara, për të dyja rastet. Mësuesi/ja kërkon që diskutimi të fokusohet në dallimin mes pjesëtimit pa mbetje dhe atij me mbetje.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Mësuesi/ja i shpërndanë secilit grup nga një fletë A4 me nga një detyrë të dhënë në fletë dhe i udhëzon ta zgjidhin. Detyrat duhet të jenë problema nga jeta reale që zgjidhen duke pjesëtuar dhe zgjidhja të jetë pa mbetje në ndonjë grup dhe me mbetje në ndonjë grup tjetër.

P.sh. “Një kanal prej 31 metrash duhet të hapet gjatë një jave, duke gërmuar të njëjtën gjatësi çdo ditë. Pas 7 ditësh kanali nuk mbaroi. Sa m kanal mbetën pa u hapur?”

“Mollët që ndodhen në dy thasë, me masë 36 kg dhe 44 kg, do të ndahen në mënyrë të barabartë në arka, që mbajnë nga 10 kg. Sa arka duhen?”

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit të përgjigjes, saktësisë së zgjidhjes së detyrave.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

6. 3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Shumëfisha dhe faktorë

FJALËT KYÇE: shumëfisha, faktorë, plotpjesëtim

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- gjen së paku 4-5 shumëfisha të disa numrave duke u bazuar në plot pjesëtueshmërinë e numrave;
- gjen së paku 4 faktorë të numrave duke u bazuar në plote pjesëtueshmërinë e numrave;
- dallon shumëfishat e numrave nga faktorët e tyre duke dhënë përkufizimet për to;
- analizon shumëfishat e disa numrave pasi i ka hijezuar në tabelën 10 x 10.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune dhe tabela 10 x 10.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Loja “Një, dy, tre, hop”

Mësuesi/ja formon një rreth me nxënësit dhe luajnë lojën një-dy-tre, hop (shih sqarimet për lojën)

tek udhëzimet). Kështu do të përmendin shumëfishat e numrit që do të zgjedhin për të luajtur.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe duke ndarë role**

Nxënësit në mënyrë të pavarur do të lexojnë rubrikën “vrojtoni dhe mësoni”.

Nxënësit udhëzohen që pas leximit të punojnë në dyshe duke ndarë rolet. Njëri do të jetë shumëfishi dhe tjetri faktori. Kështu do të prezantohen para njëri-tjetrit duke përshkruar “vetveten”. Shumëfishi thotë: “Unë jam numri 2. Shumëfishat e mi janë numrat 2, 4, 6, 8, 10... Këta numra gjenden duke e shumëzuar numrin 2 me numra natyrorë.”

Faktori thotë: “Unë jam numri 6. Faktorët e mi janë 1, 2, 3, 6. Këta numra gjenden duke e pjesëtuar numrin 6 me numrat me të cilët plotpjesëtohet (pjesëtim pa mbetje).

Diskutohen me të gjithë nxënësit përkufizimi dhe karakteristikat e shumëfishave dhe faktorëve, duke përmend dhe shembuj të tjerë nga mësuesi/ja dhe nxënësit.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës dhe në secilin grup mësuesi/ja vendos nga një tabelë 10 x 10.

Në tabelat e vendosura në grupe ata do të hijezojnë:

Grupi i parë hijezon shumëfishat e numrit 3, grupi i dytë hijezon shumëfishat e numrit 4, grupi i tretë hijezon shumëfishat e numrit 5, grupi i katërt hijezon shumëfishat e numrit 6, grupi i pestë hijezon shumëfishat e numrit 8 dhe grupi i gjashtë hijezon shumëfishat e numrit 9.

Tabelat e punuara vendosën në tabelën e punimeve, analizohen dhe diskutohen me gjithë klasën.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur, në dyshe dhe në grup. Për mënyrën e argumentimit dhe saktësisë së përgjigjes dhe bashkëpunimit në grup.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Dallon numrat çift e tek, të thjeshtë e të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecure/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 4 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.
- 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat e thjeshtë e numrat e përbërë. Numrat çift dhe tek

**FJALËT KYÇE:** numër i thjeshtë, numër i përbërë, çift dhe tek

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- cakton numrat e thjeshtë dhe numrat e përbërë deri në 100 duke ndjekur hapat sipas sitës së Eratostenit;
- dallon numrat çift nga ata tek dhe anasjelltas duke përmendur shifrat që i dallojnë ata;
- analizon veçoritë që karakterizojnë numrat e thjeshtë, të përbërë, çift dhe tek duke u bazuar në përkufizimet e tyre.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune dhe tabela 10 x 10.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shkenca të natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe

Mësuesi/ja fton nxënësit që në grupe nga 4-5 veta të punojnë për të gjetur faktorët e numrave

nga 1 deri në 20. Kërkohe të analizohen numrat të cilëve iu gjetën faktorët dhe të ndahen në dy grupe: numra që kanë faktorë vetëm numrin 1 dhe vetveten dhe numra që kanë më shumë se këta dy faktorë.

- Sa faktorë (pjesëtues) ka secili prej tyre?
- Cili nga numrat ka si faktor numrin 2?

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Nxënësit në mënyrë të pavarur do të lexojnë rubrikën “**vrojtoni dhe mësoni**”.

Mësuesi/ja fillon diskutimin duke bërë pyetje për të cilat nxënësit u informuan në pjesën që lexuan.

- Cila është vetia që i karakterizon numrat e thjeshtë?
- Po numrat e përbërë?
- Cilit lloj i takon numri 1, numrave të thjeshtë apo të përbërë? Argumento pse është i veçantë?
- Cilët numra quhen numra çift? Po numra tek?

Në tabelën 10x10 që i jepet secilit grup dhe një që do ta përdorë mësuesi/ja, gjejnë numrat e thjeshtë nga 1 deri në 100 duke ndjekur radhën e veprimeve të përcaktuara me **Sitën e Eratostenit**.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Mësuesi/ja fton nxënësit që duke diskutuar në grupe t’u përgjigjen pyetjeve të dhëna në rubrikën “ushtrime” të libri i nxënësit. Pasi të kenë përfunduar punën në grupe, do të merren përgjigjet e tyre për të analizuar saktësinë e dhënë duke i prezantuar para klasës.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur dhe punën në grup. Përgjigjet që japin pas leximit dhe bashkëpunimit mes njëri-tjetrit.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
<b>Tema :</b> Numrat		<b>Rezultati i të nxënit të temës:</b> Zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</b></p> <p><b>II.5</b> Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.</p> <p><b>III.3</b> Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p>			
<p><b>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</b></p> <p><b>2.3</b> Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.</p> <p><b>4.1</b> Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.</p>			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<b>Njësia mësimore:</b> 2.8 Zbërthimi në faktorë të thjeshtë			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër i thjeshtë, numër i përbërë, faktorë.			
<p><b>Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:</b></p> <p>Në fund të orës mësimore, nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cakton faktorët e thjeshtë për numra të ndryshëm natyrorë.</li> <li>- Shpreh si prodhim i faktorëve të thjeshtë numrat e dhënë duke përdorur pemën e faktorëve ose pjesëtimet e njëpasnjëshme.</li> <li>- Vlerëson lehtësitë që ofrojnë këto dy mënyra për të shprehur si prodhim të faktorëve të thjeshtë edhe numra të mëdhenjtë siç është viti i tyre i lindjes.</li> </ul>			
<p><b>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b></p> <p>Matematika kl.6, Fletore pune dhe zarfe.</p>			
<p><b>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</b></p> <p>Gjuhët dhe komunikimi</p>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
<p><b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Gjeni numrin shenjë</b></p> <p>Mësuesi/ja në secilin grup vendos nga një zarf ku janë të vendosur disa numra Njëri nga ata numra është i shkruar me ngjyrë ndryshe nga të tjerët dhe quhet <i>numri shenjë</i>. Kërkohet që të gjenden numrat-faktorë të numrit shenjë, në mënyrë që kur të shumëzohen faktorët mes tyre të japin numrin shenjë. Detyrat e grupeve janë të ndryshme dhe nga një përfaqësues nga grupi do ta zgjidh detyrën e grupit të tij në tabelë.</p>			

### Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe

Nxënësit në mënyrë të pavarur do të lexojnë rubrikën vrojtoni dhe mësoni. Mësuesi/ja secilës dyshe u jep nga një numër të cilin kanë për ta shkruar si prodhim i faktorëve të thjeshtë. Njëri nxënës do ta zgjidh detyrën duke përdorur *pemën e faktorëve* dhe tjetri *pjesëtimet e njëpasnjëshme* për zberthimin në faktorë të thjeshtë të një numri.

#### Mënyra e parë (Pema e faktorëve)

Vëreni pemën e faktorëve të paraqitur në figurën 2.6. Nëpërmjet saj janë paraqitur të gjithë faktorët e numrit 126. Rrethojmë të gjithë numrat e thjeshtë që ndodhen në fund të degëve të pemës. Faktorë të thjeshtë të 126 janë numrat 2, 7, 3, 3



#### Mënyra e dytë

Faktorët e thjeshtë të një numri mund të gjenden duke e pjesëtuar atë në mënyrë të përsëritur me numrat e thjeshtë, të marrë në radhë rritëse: 2, 3, 5, 7, 11, 13,...

(Pjesëtimi bëhet me ata numra të thjeshtë që e plotpjesëtojnë numrin tonë, pra janë faktorë të tij).

Pjesëtimi fillohet me numrin e thjeshtë më të vogël, pastaj me pasuesin më të vogël të thjeshtë etj.

Vëreni skemën

$$126 : 2 = 63$$

$$63 : 3 = 21$$

$$21 : 3 = 7$$

$$7 : 7 = 1$$

$$\text{Pra, } 126 = 2 \cdot 3 \cdot 3 \cdot 7$$

Nxënësit/et do ta diskutojnë me njëri tjetrin mënyrën e zgjidhjes së detyrës dhe do ta konfirmojnë zgjidhjen e njëjtë pavarësisht rrugëve të ndryshme të ndjekura për ta zberthyer numrin në faktorë.

#### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe

Mësuesi/ja fton nxënësit/et që të punojnë në grupe dhe të zberthejnë në faktorë të thjeshtë numrin që tregon vitin e lindjes së tyre p.sh. nëse janë të lindur në vitin 2008 do ta zberthejnë si prodhim të faktorëve këtë numër. Nxënësit/et do të vendosin vet për mënyrën që do ta përdorin në zberthimin e numrit si prodhim i faktorëve.

Në tabelë e paraqesin detyrën e punuar dy nxënës/e nga dy grupe që kanë përdorë njëri *pemën e faktorëve* dhe tjetri *pjesëtimet e njëpasnjëshme*.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit/et për punën e pavarur punën në dyshe dhe punën në grup. Vlerësimi do të jetë i vazhdueshëm në çdo fazë të orës.

#### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzohen nxënësit/et për detyrat e shtëpisë në **Fletore pune** dhe u jepen sqarime për to.

#### REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Njehson PMP dhe ShVP të dy e më shumë numrave.
- Modelon radhitjen e numrave duke zbuluar rregullën.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I. 6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
- III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
- 3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike, në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pjesëtuesi më i madh i përbashkët dhe shumëfishi më i vogël i përbashkët i dy numrave natyrorë (PMP dhe ShVP).

**FJALËT KYÇE:** Pjesëtues, shumëfish, i përbashkët

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton pjesëtuesin më të madh të përbashkët për dy e më shumë numra duke gjetur faktorët për secilin numër.
- përcakton shumëfishin më të vogël të përbashkët për dy a më shumë numra duke përcaktuar disa nga shumëfishat e numrave veç e veç.
- argumenton emërtimet e *pmp* dhe *shvp* duke u bazuar në vetitë e faktorëve dhe shumëfishave të numrave.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:


Matematika, fletore pune dhe shkumës me ngjyrë.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Diagrami i Venit (punë në grupe)

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në grup për të paraqitur përmes Diagramit të Venit faktorët e numrave 20 dhe 30. U sqaron se në anën e majtë do të shkruajnë faktorët që i takojnë vetëm numrit 20, në të djathtë faktorët që i takojnë vetëm numrit 30 dhe në pjesën e përbashkët (në mes) faktorët e përbashkët të të dy numrave.



### Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i avancuar

- Cili është faktori më i madh i përbashkët i tyre?

Me përgjigjen që do të japin nxënësit në pyetjen e dhënë, do të gjejnë PMP për numrat 20 dhe 30 të cilën do ta shënojmë:

$$\text{PMP}(20,30) = 10$$

Do të diskutohet se si mund ta gjejnë më lehtë PMP-në për dy a më shumë numra natyrorë, duke u bazuar në zbërthimin në faktorë të thjeshtë të numrave.

Mësuesi/ja u jep detyrë në grupe që të gjejnë disa shumëfisha të numrave. Numrat janë të ndryshëm për secilin grup. P.sh. numrat 6, 8, 12, 24, 48.

Për secilin numër shënohen në tabelë përgjigjet e dhëna nga grupet.

- Cili është shumëfishi më i vogël i përbashkët për këta numra?

Përgjigjen (numrin), mësuesi/ja e gjen në vargjet e dhëna dhe e qarkon. Sqaron se:

$$\text{Shvp}(6, 8, 12, 24, 48) = 48$$

Për ta zgjidhur më thjeshtë veprojmë në këtë mënyrë:

PMP (30,45)	Shvp (30,45)
$\begin{array}{r l} 30,45 & 3 \\ 10,15 & 5 \\ \hline 2,3 & 3 \cdot 5 = 15 \end{array}$	$\begin{array}{r l} 30,45 & 3 \\ 10,15 & 5 \\ 2,3 & 2 \\ 1,3 & 3 \\ \hline 1,1 & 2 \cdot 3 \cdot 3 \cdot 5 = 90 \end{array}$
Pra PMP (30,45)=15	Pra Shvp (30,45) = 90

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe

Mësuesi/ja fton nxënësit që të punojnë në grupe për të zgjidhur tri detyra të dhëna në rubrikën “Ushtrim” dhe zgjedh tre nxënës nga grupe të ndryshme për t’i paraqitur zgjidhjet në tabelë. Nxënësit e tjerë kontrollojnë saktësinë e zgjidhjes së detyrave përmes vetëvlerësimit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur, punën në dyshe dhe punën në grup. Në fazën e fundit të orës, mësuesi/ja vëzhgon nxënësit se si po e zbatojnë vetëvlerësimin.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Njehson PMP (duke zbatuar algoritmin e Euklidit) të dy e më shumë numrave.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik apo shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Algoritmi i Euklidit për gjetjen e PMP të dy numrave.

**FJALËT KYÇE:** algoritëm, PMP, herës, mbetje

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- cakton *pmp* për dy a më shumë numra natyrorë duke përdorë algoritmin e Euklidit;
- dallon mënyrat e veprimit për gjetjen e *pmp* me këtë metodë nga gjetja me anë të faktorëve të thjeshtë;
- arsyeton pse algoritmi i Euklidit është metodë më praktike për të gjetur *pmp* e numrave natyrorë të mëdhenj.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune dhe fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës dhe arte

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në grup për të caktuar PMP (12,16). Një nxënës jep në tabelë zgjidhjen. Kur të kenë përcaktuar  $PMP(12,16) = 4$ , atëherë mësuesi/ja pyet:

- A do të jetë po kaq e lehtë të gjejmë  $PMP(260,400)$ ? Argumentoni përgjigjen.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë për Algoritmin e Euklidit në rubrikën “**vrojtoni dhe mësoni**” dhe të sqarojnë përmes ditarit dypjesësh se si gjendet PMP-ja, përmes këtij algoritmi.

Detyra	Komenti
PMP (18,84) $84 : 18 = 4 (12)$ $18 : 12 = 1 (6)$ $12 : 6 = 2 (0)$	Pjesëtojmë 84 me 18 fitojmë herësin 4 dhe mbetjen 12. Pjesëtojmë 18 me mbetjen 12 fitojmë herësin 1 dhe mbetjen 6. Pjesëtojmë 12 me mbetjen 6 fitojmë herësin 2 dhe mbetjen 0. Mbetja e fundit e ndryshme nga 0 është prandaj $PMP(18,84) = 2$ .
PMP(136,256) $256 : 136 = 1 (120)$ $136 : 120 = 1 (16)$ $120 : 16 = 7 (8)$ $16 : 8 = 2 (0)$	Pjesëtojmë 256 me 136 fitojmë herësin 1 dhe mbetjen 120. Pjesëtojmë 136 me mbetjen 120 fitojmë herësin 1 dhe mbetjen 16. Pjesëtojmë 120 me mbetjen 16 fitojmë herësin 7 dhe mbetjen 8. Mbetja e fundit e ndryshme nga 0 është 8, prandaj $PMP (136,256) = 8$ .

Mësuesi/ja bën këto pyetje:

- Si do ta gjenit PMP (136,256) ndryshe?
- A mendoni se në rastet më të shpeshta kjo formë e gjetjes së PMP është më e lehtë? Pse?

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit në fletët A4 që mësuesi/ja ka shpërndarë në grupe, do të zgjidhin detyrën “Luleshitësi kërkon të bëjë buqeta me lule me zambakë të bardhë dhe të kuq. Ai ka në dispozicion 40 zambakë të bardhë dhe 35 zambakë të kuq. Sa buqeta mund të bëjë ai, nëse në çdo buqetë ka të njëjtën numër lulesh?” Kur të kenë përfunduar detyrën do të shkëmbejnë fletët me grupin fqinjë për të vlerësuar njëri-tjetrin.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur, punën dhe punën në grup. Në fazën e fundit të orës kemi vlerësim të ndërsjellë mes grupesh.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat

### **Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon plotpjestueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjestueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I. 6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1. 2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Rregulla të plotpjesëtimit**

FJALËT KYÇE: Plotpjesëtues, rregull

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon rregullat e plotpjesëshmërisë për numrat 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10 duke i lidhur numrin me rregullën përkatëse;
- zbaton rregullat e plotpjesëshmërisë në detyrat e dhëna duke i zgjidhur ato;
- vlerëson përdorimin e rregullave në shembuj nga jeta e përditshme përmes dy problemave të dhëna.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune dhe fletë A1

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, situata jetësore ku duhet të përdoret plotpjesëshmëria për të bërë ndarje të plota pa mbetje.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja ka shkruar në tetë fletë nga një detyrë ku kërkohet pjesëtim i një numri me njërin nga numrat: 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9 dhe 10. Nga një nxënës nga secili grup tërheq një fletë ku janë të shkruara detyrat. Nxënësit i zgjidhin ato në grup.

Mësuesi/ja i kontrollon në grupe saktësinë e zgjidhjes së detyrës dhe diskuton me ta për mënyrën e zgjidhjes së saj.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa**

Mësuesi/ja i njofton nxënësit se ka disa rregulla që na ndihmojnë për të përcaktuar se a plotpjesëtohet një numër me ndonjërin nga numrat 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10.


Udhëzohen nxënësit që të lexojnë rregullën e parë për plotpjesëshmërinë me 2.

Mësuesi/ja bën pyetjet:

- Cilët numra mund të plotpjesëtohen me numrin 2?
- Pse nuk mund të jetë ndryshe kjo rregull?
- Thoni një numër pesëshifrorë që plotpjesëtohet me 2.

Do të vazhdojnë nxënësit t'i lexojnë me radhë rregullat dhe mësuesi/ja do të bëjë afërsisht pyetje të ngjashme pas çdo rregulle.

Mësuesi/ja ka përgatitur në një fletë A1 bashkësitë e dhëna me diagram dhe udhëzon nxënësit në secilin grup të lidhin me shigjetë përgjigjet e sakta përkatëse për njërin nga numrat. Fletën e vendosin në tabelë.



### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit punojnë në dyshë shembujt 5 dhe 6 të dhënë në libër te rubrika “**Ushtrime**”. Detyrat do t’i zgjidhin dy nxënës edhe në tabelë duke diskutuar me të tjerët se cilat rregulla kanë përdorur dhe si i kanë zbatuar ato për të gjetur zgjidhjen.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për punën e pavarur dhe punën në grup. Mësuesi/ja do t’i vlerësojë nxënësit që kanë prezantuar grupet, në listën e kontrollit për prezantim dhe përgjigje të sakta.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave natyrorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj shumëzimit.
- Kryen veprimet aritmetike (shumëzim, pjesëtim) me numra natyrorë.
- Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë.
- Dallon numrat çift dhe tek, të thjeshtë dhe të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre.
- Përkufizon plotpjesëtueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjesëtueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10.
- Zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë.
- Njehson *pmp* (duke zbatuar algoritmin e euklidit) dhe *shvp* të dy e më shumë numrave.
- Modelon barazime, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.
- Zgjidh problema, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.
- 3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Çfarë mësuam (përsëritje)*

**FJALËT KYÇE:** numrat natyrorë, veprimet e shumëzimit dhe të pjesëtimit me numrat natyrorë, numrat çift, tek, të thjeshtë dhe të përbërë, kriteret e plotpjesëtueshmërisë, *pmp* dhe *shvp*, zbërthimi në prodhim faktorësh të thjeshtë.

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj shumëzimit;
- kryen veprimet aritmetike (shumëzim, pjesëtim) me numra natyrorë;
- zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë;
- dallon numrat çift dhe tek, të thjeshtë dhe të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre;

- përkufizon plotpjesëtueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjesëtueshmërisë së numrave
- natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10;
- zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë;
- njehson PMP (duke zbatuar algoritmin e Euklidit) dhe ShVP të dy e më shumë numrave;
- modelon barazime, duke përdorur veprimet me numra natyrorë;
- zgjidh problema, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**  
Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuar:	Provoni të zgjidhni.
si veprohet për të shumëzuar dy numra natyrorë;	1. Gjeni prodhimin: a) $24 \cdot 20$ ; b) $203 \cdot 25$ .
vetitë e shumëzimit që na ndihmojnë për të kryer më shpejt veprimet;	3. Gjeni, duke përdorur vetinë e shoqërimit. a) $(26 \cdot 5) \cdot 20$ ; b) $(3 \cdot 4) \cdot 250$ ; c) $(17 \cdot 125) \cdot 8$ .
si veprohet për të pjesëtuar dy numra natyrorë;	4. Gjeni vlerën e ndryshores: a) $27 \cdot x = 135$ ; b) $315 : y = 21$ .  5. Gjeni herësin dhe mbetjen: a) $546 : 5$ ; b) $234 : 4$ . c) Shprehni të pjesëtueshmin në varësi të herësit dhe mbetjes.
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Ju jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e kryerjen e saktë të veprimit të shumëzimit dhe të pjesëtimit me numrat natyrorë, vetitë e veprimeve, kriteret e plotpjesëtueshmërisë, zbërthimi në prodhim faktorësh të thjeshtë, gjetja e shvp dhe pmp, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave natyrorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj shumëzimit.
- Kryen veprimet aritmetike (shumëzim, pjesëtim) me numra natyrorë.
- Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë.
- Dallon numrat çift dhe tek, të thjeshtë dhe të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre.
- Përkufizon plotpjesëtueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjesëtueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10.
- Zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë.
- Njehson pmp (duke zbatuar algoritmin e euklidit) dhe shvp të dy e më shumë numrave.
- Modelon barazime, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.
- Zgjidh problema, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Vlerësim*

**FJALËT KYÇE: numrat natyrorë, vendvlerat, krahasimi, boshti numerik, veprimet aritmetike me numrat natyrorë, bashkësia N.**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përcakton bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj shumëzimit;
- kryen veprimet aritmetike (shumëzim, pjesëtim) me numra natyrorë;
- zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore matematikore me numra natyrorë;
- dallon numrat çift dhe tek, të thjeshtë dhe të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre;
- përkufizon plotpjesëtueshmërinë dhe zbaton kriteret e plotpjesëtueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10;
- zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë;
- njehson PMP (duke zbatuar algoritmin e Euklidit) dhe ShVP të dy e më shumë numrave;
- modelon barazime, duke përdorur veprimet me numra natyrorë;
- zgjidh problema, duke përdorur veprimet me numra natyrorë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e kryerjen e saktë të veprimit të shumëzimit dhe të pjesëtimit me numrat natyrorë, vetitë e veprimeve, kriteret e plotpjesëtueshmërisë, zbërthimi në prodhim faktorësh të thjeshtë, gjetja e shvp dhe pmp, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ▼TEMA 3

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITTË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin, si koncepte themelore gjeometrike.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.  
II. 8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.  
3. 4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITTË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pika, drejtëza dhe rrafshi

FJALËT KYÇE: pikë, drejtëz, rrafsh

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan pikën, drejtëzën, rrafshin si përfytyrime dhe si përshkrime në fletë;
- përkufizon gjysmëdrejtëzën dhe gjysmërrafshin duke i përshkruar si kuptime të nxjerra nga ato themelore të gjeometrisë;
- tregon kuptimet themelore të gjeometrisë në objekte të ndryshme të jetës reale.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, artet

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mini leksion

Mësuesi/ja njofton nxënësit për temën në të cilën do të futen nga kjo njësi mësimore duke përmendur tri konceptet themelore të gjeometrisë: pikën, drejtëzën dhe rrafshin. Ai/ajo u sqaron se si të tilla, pika, drejtëza dhe rrafshi nuk kanë përkufizim. Nga kuptimet themelore do të njihen me kuptime të tjera të nxjerra siç është gjysmëdrejtëza, segmenti dhe gjysmërrafshi.

### Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e re të mësimin në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Gjatë leximit, ata do të vendosin në fund të çdo informate nga një simbol që tregon se si e kanë kuptuar atë informatë.

$\sqrt{\quad}$   $\Rightarrow$  nëse informacioni është i njohur për ju.

$+$   $\Rightarrow$  nëse informacioni është i ri.

$?$   $\Rightarrow$  nëse informacioni është i paqartë.

$-$   $\Rightarrow$  nëse informacioni që lexuat është ndryshe nga ai që dinit më parë.

Nxënësit në fletore do të vizatojnë tabelën në të cilën do të shkruajnë informacionet sipas simboleve që kanë vendosur.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela e INSERT-it

Në tabelën e klasës, mësuesi/ja plotëson tabelën e INSERT-it duke marrë mendimet e nxënësve dhe duke u ndalë më gjatë te kolona me shenjën “?” për të dhëna sqarimet e informacioneve që nxënësit nuk i kanë kuptuar.

*Psh:*

$\sqrt{\quad}$	$+$	$-$	$?$
Vija është një bashkësi pikash.	Gjysmëdrejtëzat [OA) dhe [OB) quhen plotësuese (të kundërta) të njëra-tjetrës.	.....	Nëpër dy pika mund të kalojë një dhe vetëm një drejtëz.

Nxënësit në grupe në një fletë A4 punojnë detyrën 1 te rubrika “**Ushtrime**” dhe punimet i vendosin në tabelë për t’i komentuar dhe vlerësuar bashkë me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për plotësimin e tabelës tabelën e INSERT-it, dje për vizatimin e koncepteve gjeometrike të mësuara.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

Përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të nxjerra.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

IV. 6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

8. 1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Segmenti. Gjatësia e segmentit

**FJALËT KYÇE:** segment, vijë e thyer, njësi e matjes

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon segmentin si pjesë të drejtëzës;
- vizaton segmentin dhe vijën e thyer duke përdor vizoren e shkallëzuar;
- krahason segmentet duke matur gjatësitë e tyre.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, edukimi figurativ

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë e pavarur**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të caktojnë në fletore dy pika të ndryshme a dhe b. Me anë të vizores bashkoni këto dy pika. Çfarë fituat?

Duke përdorur vizoren e shkallëzuar mateni distancën në mes pikave a dhe b. Sa është ajo?

**Ndërtimi i njohurive të reja**

Mësuesi/ja lexon pjesën e re të mësimimit në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” të cilën më parë e ka ndarë në disa pjesë. Në çdo ndalesë, ai/ajo bën pyetje në të cilat nxënësit përgjigjen.

Pyetje për ndalesën e parë:

- Çfarë quajmë segment?
- Si shënohet simbolikisht ai?
- Vizato në fletore një segment dhe emëroni atë.

Pyetje për ndalesën e dytë:

- Çfarë është vija e thyer?
- Si quhen skajet e segmenteve te vija e thyer? Po vet segmentet e vijës së thyer?
- Vizato një vijë të thyer dhe emërto kulmet e saj.

Pyetje për ndalesën e tretë:

- Ç’është gjatësia e segmentit?
- Çfarë duhet të caktosh për të matur një segment?
- Cakto njësinë matëse dhe mate segmentin e vizatuar më lartë.
- Sa është gjatësia e tij?
- Vizato segmentet  $[ab] = 6 \text{ cm}$  dhe  $[cd] = 8 \text{ cm}$ . Krahasoji ato.

Pyetje për ndalesën e katërt:

- Çfarë quajmë largesë të dy pikave?
- Ç’është mesi i segmentit?
- Cakto mesin e segmentit të vizatuar më parë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit duke diskutuar në grupe punojnë detyrat 4 dhe 5 te rubrika “Ushtrime”. Kur të kenë përfunduar punën, mësuesi/ja cakton nxënësit që do të dalin në tabelë për të vizatuar dhe diskutuar me klasën ato detyra.

Këto detyra nxënësit do t’i punojnë edhe përmes programit geogebra duke u drejtuar nga mësuesi/ja.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna. Nxënësit vlerësohen për vizatimet që bëjnë duke vënë theksin në saktësinë e përcaktimit të elementeve të mësuara në teori dhe zbatimin e njohurive të marra në programin geogebra.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë).
- Përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë gjeometrike.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III. 7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë, dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. 6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.
8. 1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje, në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

2. 5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: këndi, krahasimi i këndeve, shuma dhe ndryshimi i këndeve**

FJALËT KYÇE: kënd, krahë, kulm, lloje të këndeve

### Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon këndin dhe elementet e tij duke iu përgjigjur pyetjeve;
- vizaton llojet e këndeve duke përdor trekëndëshin e vizatimit dhe i emërton ato;
- krahason këndet sipas madhësive të tyre;
- cakton këndet që fitohen si shumë apo si ndryshim i dy këndeve duke i vizatuar;
- zbaton përmes programit geogebra vizatimin e llojeve të ndryshme të këndeve.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4, veglat për gjeometri, lap-top projektor

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim

Mësuesi/ja merr një orë muri në dorë dhe bashkë me nxënësit fillojnë të diskutojnë pozitën e akrepave të orës. Duke ia ndërruar pozitën akrepave do të formohen kënde të ndryshme dhe do t'i analizojnë këndet që fitohen në të gjitha rastet e ndryshimit të akrepave.

Mësuesi/ja pyet “Shikoni rreth e qark në klasë, ku shihni kënde?”

### Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e mësimit në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Çdo pjesë që ata mendojnë se është e rëndësishme të diskutohet me klasën, duhet ta nënvizojnë. Pas leximit, mësuesi/ja iu kërkon të plotësojnë ditarin dypjesësh. Ai/ajo vizaton ditarin dypjesësh në tabelë dhe duke diskutuar dhe komentuar bashkë me nxënësit e plotëson atë. Pyetjet dhe përgjigjet i merr nga nxënësit.

<i>Pyetje</i>	<i>Përgjigje</i>
Kush quhet kënd?	Bashkimi i dy gjysmëdrejtëzave që dalin nga e njëjta pikë quhet kënd.
.	.
.	.
.	.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Detyrat 1 dhe 2 në rubrikën “Ushtrime”, nxënësit do t'i punojnë në grupe në një fletë A4 dhe punimet do t'i vendosin në tabelë. Njëri nga grupet do t'i punojë detyrat në lap-top përmes geogebres. Bashkë me mësuesin/en do t'i diskutojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë punimet në fleta dhe atë të punuar në program kompjuterik.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përgjigjet e dhëna. Gjithashtu ata do të vlerësohen për saktësinë e vizatimeve të punuar dhe shkathhtësitë në përdorimin e programit geogebra.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Dallon llojet e këndeve sipas pozicionit të krahëve (brinjëve). dhe masave të tyre (suplementare, komplementare)

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I. 6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III. 5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 5 Konstruktin dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Lloje të tjera këndesh**

FJALËT KYÇE: **kënd, pozicion i krahëve, lloje të këndeve**

### Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon llojet e këndeve sipas pozitës së krahëve;
- konstruktin kënde fqinje, kënde të përbrinjëshëm (të bashkëmbështetur) dhe kënde kryqëzuese (të kundërt në kulm);
- dallon disa lloje të këndeve duke i konkretizuar me anë të shkopinjve ose lapsave.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri, shkopinj

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Di/Dua të di/Mësova

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë tabelën me tri kolona dhe në kolonën e parë të shkruajnë dy-tri gjëra që ata dinë për këndet dhe llojet e këndeve.

Të gjitha ato ide që nxënësit i kanë shkruar ata i lexojnë dhe mësuesi/ja i shkruan në tabelë në kolonën Di.

Nxënësit do të plotësojnë kolonën e dytë duke shtruar pyetje në lidhje me njësinë e re mësimore. Pyetjet i shkruan edhe mësuesi/ja në tabelë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësova

Nxënësit lexojnë mësimin në libër te rubrika “Vrojtoni dhe mësoni” dhe plotësojnë kolonën e fundit “Mësova” duke iu përgjigjur pyetjeve. Këtë kolonë do ta plotësojnë me informacione të reja edhe në qoftë se nuk është bërë pyetje për to.

Mësuesi/ja plotëson kolonën e tretë duke marrë përgjigjet nga nxënësit dhe duke i diskutuar bashkë me ta. Nëse ka mbetur ndonjë pyetje pa përgjigje nga kolona e dytë, mësuesi/ja do të përgjigjet ose i mbetet nxënësve të hulumtojnë dhe të gjejnë përgjigjen.

Di	Dua të di	Mësova
- Llojet e këndeve përcaktohen në bazë të madhësisë së këndeve.	- A mund të ketë lloje të tjera të këndeve përveç atyre që kemi mësuar një orë më parë?	- Lloje të tjera të këndeve përcaktohen në bazë të pozicionit të krahëve të tyre.
.	.	.
.	.	.
.	.	.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe**

Konstruktoni dy kënde fqinje, dy kënde të përbrinjshëm (të bashkëmbështetur) dhe dy kënde kryqëzuese (të kundërt në kulm). Shkëmbeni fletoret me shokun/shoqen afër për të vlerësuar vizatimet e njëri-tjetrit. Këndet që keni vizatuar konkretizojini duke përdorur shkopinjtë ose lapsa. Shkopi ose lapsi paraqet krahun e këndit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përgjigjet e dhëna. Gjithashtu ata do të vlerësohen për saktësinë në vizatime nga mësuesi/ja dhe nga njëri-tjetri.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Dallon njësitë për matje të këndeve ( °, ’ ’’) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën.
- Cakton masën e këndeve duke përdorur këndmatësin (suplementare, komplementare).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik apo shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: matja e këndeve me këndmatës*

FJALËT KYÇE: **kënd, këndmatës, shkallë, minuta dhe sekonda këndore**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- mat kënde të ndryshme duke përdorur këndmatësin, bazuar në rregullat për përdorimin e tij;
- cakton masën e këndeve të ngushtë, të drejtë dhe të gjerë të shprehur me njësi këndore;
- shndërron njësitë matëse të këndeve; shkallë, minuta dhe sekondë këndore;
- konstrukton këndet komplementare dhe suplementare duke i paraqitur si shumë e dy këndeve.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë një diskutim rreth njohurive që ata kanë për llojet e këndeve.

- Si emërtohen ato?
- Cilat janë masat e tyre përkatëse?

Diskutimi i nxënësve paraqitet në tabelë duke shkruar emrat dhe masat e llojeve të këndeve që ata përmendin.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa drta**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”, deri te ndalesa e parë. Ai/ajo shtron pyetjet për këtë pjesë.

- Si krahasohen këndet?
- Cila është njësia matëse e këndeve?
- Sa është kjo masë krahasuar me këndin e shtrirë?
- Si shënohet shkalla këndore?

Nxënësit vazhdojnë të lexojnë pjesën e dytë pas së cilës, mësuesi/ja bën këto pyetje:


- Cilat janë nënfishat e shkallës këndore?
- Sa është masa e minutës këndore?
- Sa është masa e sekondës këndore?

• Shprehni  $1^\circ$  në minuta dhe sekonda këndore.

Kur nxënësit të përfundojnë me leximin e pjesës së tretë mësuesi/ja bën pyetjet:

- Sa është masa e këndit të ngushtë, këndit të drejtë dhe këndit të gjerë?

- Si quhen këndet, shuma e masave të të cilëve është  $180^\circ$ ?
- Sa duhet të jetë shuma e masave të dy këndeve për të qenë kënde komplementare?
- Si quhet vegla me të cilën matim këndet (fig 3.37)?



**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

**Punë e pavarur dhe në grup**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat te rubrika “**Ushtrime**”, duke i ndihmuar në përdorimin e këndmatësit për matjen e këndeve. Detyrat ku kërkohen njehsime të këndeve të shprehura me njësi matëse dhe shndërrime nga shkallë në minuta dhe sekonda këndore, nxënësit do t’i punojnë në grup.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përgjigjet e dhëna, shndërrime të njësive këndore dhe në përdorimin e saktë të këndmatësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

**ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**  
- Konstrukton simetralen e këndit

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**  
 II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik apo shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.  
 III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 5 Konstruktore dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.
4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Përgjysmorja dhe simetrikja e këndit**

FJALËT KYÇE: kënd, përgjysmore, simetrike

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- ndërton përgjysmoren e këndit duke përdorur këndmatësin;
- ndërton përgjysmoren dhe simetralen e këndit duke përdorur kompasin dhe vizoren;
- arsyeton dallimet në përdorimin e këndmatësit apo kompasit dhe vizores për të konstruktuar.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, edukimi figurativ

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë një kënd të ngushtë, një kënd të drejtë dhe një kënd të gjerë. Pasi t'i caktojnë masat e tyre, me ndihmën e këndmatësit t'i ndajnë këndet në dy pjesë të barabarta.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja njofton nxënësit se gjysmëdrejtëza e tërhequr për të ndarë këndin në dy pjesë të barabarta quhet përgjysmore e këndit. Ajo ndërtohet edhe me anë të kompasit dhe vizores.

Ndërtimi i përgjysmores së këndit me anë të kompasit dhe vizores do ta paraqes mësuesi/ja përmes hapave duke iu lënë hapësirë nxënësve që pas tij/saj edhe nxënësit të punojnë të njëjtën në fletoret e tyre. Këta tre hapa të ndërtimit të përgjysmores së këndit, nxënësit mund t'i shohin edhe në figurat e dhëna në libër te rubrika “Vrojtoni dhe mësoni”.

Mësuesi/ja kërkon prej nxënësve që të tërheqin drejtëzën e cila e përmban përgjysmoren e këndit. Kjo drejtëz quhet përmesore (simetrale) e këndit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur (Turi i galerisë)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrën 1 te rubrika “Ushtrime” duke i ndihmuar në përdorimin e kompasit dhe vizores për të konstruktuar përgjysmoren dhe simetrikën e këndeve. Nxënësit zgjedhin punimin më të saktë dhe më të mirë brenda grupit për ta ekspozuar në Turin e galerisë. 5-6 punimet e ekspozuara do të diskutohen me të gjithë nxënësit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përgjigjet e dhëna, saktësinë dhe pedanterinë në konstruktive.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Vizaton drejtëza paralele dhe normale.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Drejtëzat normale (pingule)*

**FJALËT KYÇE:** drejtëza normale (pingule), kënde kryqëzore, kënde të drejta

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- vizaton dy drejtëza prerëse në pozita të ndryshme;
- përkufizon drejtëzat normale (pingule) duke analizuar në rastet specifike të drejtëzave prerëse;
- vizaton dy drejtëza normale pingule duke përdorë saktë vizoren dhe trekëndëshin e vizatimit.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

Shembuj të ndërtimit të objekteve në ndërtimtari

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë e pavarur**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë me anë të trekëndëshit të vizatimit një kënd i drejtë me kulm o. Pastaj zgjatni secilin nga krahët e tij përtej o, duke marrë drejtëza të plota. Kontrolloni me anë të trekëndëshit të vizatimit (ose me këndmatës) nëse janë të drejta tri këndet e tjera. Shpjegoni pse ndodh kjo.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të vizatojnë nga dy drejtëza prerëse si në fig. 3.46. Ata bashkëbisedojnë në grupe duke analizuar rastet e paraqitura në figurë. Mësuesi/ja për të diskutuar shtron pyetjet:

- Sa kënde formojnë dy drejtëza prerëse?
- Si quhen këndet e formuara?
- A mund të ndodhë që këto katër kënde të jenë të barabarta?

Nxënësit dhe mësuesi/ja vizatojnë fig. 3.47 dhe vazhdojnë bashkëbisedimin duke u përgjigjur në pyetjet:

- Sa është masa e secilit prej katër këndeve në këtë rast?
- Si quhen këto drejtëza?
- Si shënohen simbolikisht dy drejtëza normale (pingule)?
- Gjeni në mjedisin e klasës drejtëza normale.

Mësuesi/ja fton nxënësit të vizatojnë dy drejtëza normale duke u bazuar në udhëzimet e dhëna në libër (fig. 3.51).

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në grupe detyrat nga 1 deri 6 te rubrika “Ushtrime” nga një detyrë secili grup në fletë A4. Detyrat prezantohen para klasës dhe diskutohet zgjidhja e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna, saktësinë dhe pedanterinë në konstruktive.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Konstrukton simetralen e segmentit.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik apo shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III. 6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2. 5 konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

8. 1 përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Simetralja (përmesorja) e segmentit*

**FJALËT KYÇE:** simetralja, segment, pikë e mesit

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon simetrikën e segmentit;
- ndërton simetrikën e segmentit të dhënë me trekëndësh vizatimi;
- ndërton simetrikën e segmentit të dhënë me kompas dhe vizore të shkallëzuar;

- ndërton simetralen e segmentit duke përdorur programin geogebra;
- zbaton në situata jetësore simetrikën e segmentit duke përcaktuar një pikë muri në raport me brinjën (segmentin) e dyshemesë së një dhome.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri, fletë A4, lap-top

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna

Shembuj të ndërtimit të objekteve në ndërtimtari

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë e pavarur

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë një segment  $[ab] = 4$  cm. Me anë të vizores së shkallëzuar gjeni mesin  $m$  të segmentit të dhënë. Vizatoni pastaj, me ndihmën e trekëndëshit të vizatimit, drejtëzën që kalon nga pika  $m$  dhe që është normale me drejtëzën  $ab$ . Emërtojeni drejtëzën me shkronjën  $p$ . Në drejtëzën  $e$  dhënë  $p$  caktoni dy pika të çfarëdoshme  $c$  dhe  $d$  dhe gjeni, me vizore të shkallëzuar, largesat e pikës  $c$  nga pika  $a$  dhe nga pika  $b$ . Njejtë veproni edhe nga pika  $d$  matni largesat  $da$  dhe  $db$ . Çfarë vini re? A mund të nxirrni një përfundim?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësine e re mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” dhe secilit grup i jep detyrën në një fletë A4 ku kërkohet të ndërtohet simetralja e segmentit të dhënë. Nxënësit diskutojnë në grup për pjesën që lexuan, ndërtojnë në fletoret e tyre simetralen e një segmenti të dhënë. Ndërtimin duhet ta bëjnë në dy mënyrat e dhëna në libër.

a) Ndërtojnë simetrikën e segmentit duke caktuar mesin e segmentit me trekëndëshin e vizatimit ose me anë të këndmatësit duke caktuar këndin  $90^\circ$  dhe tërheqin normalen në segment.

b) Ndërtojnë simetrikën e segmentit duke përdorur vizoren dhe kompasin dhe ndjekin udhëzimet e dhëna me hapat e vizatimit në libër (fig 3.56).

Nxënësit bashkëpunojnë në grup dhe konstruktojnë simetralen e segmentit të dhënë në detyrën e përcaktuar për grupin në fletën A4 që mësuesi/ja u dha në fillim.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grup

Nxënësit zgjidhin detyrën 4 të rubrikës “Ushtroni duke zbatuar” dhe diskutojnë rreth detyrës “për të vendosur një pikturë. Arbri gjeti një pikë  $c$  në murin e dhomës të tillë që  $[ab] = 3$  m,  $[bc] = 2,2$  m,  $[ca] = 2$  m. A ndodhet pika  $c$  në simetrikën e segmentit  $[ab]$ , ku  $ab$  është brinja e poshtme e faqes së murit?”

Shembujt e dhënë në rubrikën “Ushtrime”, nxënësit në grupe i zgjidhin përmes programit geogebra.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna, saktësinë dhe pedanterinë në konstruktive.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përcakton raportet ndërmjet koncepteve themelore: pikë, drejtëz, rrafsh dhe koncepteve të nxjerra.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Largesa e një pike nga një drejtëz*
**FJALËT KYÇE:** pikë, drejtëz, largesë e pikës

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- gjen distancën më të vogël të një drejtëze nga një pikë që nuk i takon asaj;
- përkufizon largesën e një pike nga një drejtëz duke dhënë definicionin;
- analizon largësinë e pikës që nuk i takon drejtëzës nga disa pika të caktuara në drejtëz duke matur distancat e pikave.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri, fletë A4, lap-top

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

Shembuj të ndërtimit të objekteve në ndërtimtari

Distancat e objekteve në natyrë

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga një fletë A4 ku është vizatuar një pejzash shkretëtire dhe në të një njeri që është shënuar me N. Diku larg pikës N shihet një rrëke uji. Kërkohet që nxënësit të përcaktojnë rrugën më të shkurtër të personit N për të arritur tek uji. Punimet e nxënësve vendosen në tabelën e punimeve.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**” dhe të punojnë duke bashkëbiseduar në grup, shembullin e dhënë në figurën 3.63. Bashkëbisedimin e vazhdojnë bashkë me mësuesin/en duke analizuar figurën dhe duke u përgjigjur pyetjeve:

- Matni segmentet AM, AN, AP, AO, AR.
- Cili segment ka gjatësinë më të vogël?
- Si quhet ky segment?

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që t'i kthehen e ta analizojnë detyrën e dhënë në fillim të orës ku u kërkua të gjejnë rrugën më të shkurtër të personit N për të rrëkeja e ujit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza e rumbullakët**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe fletën A4 me nga tri detyra në të. Fleta duhet të pasohet brenda grupit në mënyrë sistematike. Nxënësi i parë fillon detyrën dhe e përcjellë fletën te shoku në krahun e majtë. Ky vazhdon detyrën dhe e përcjellë fletën te tjetri. Kështu fleta do të qarkullojë në grup, derisa të përfundojnë detyrat e dhëna.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna, saktësinë në konstruktime. Vlerësohet edhe bashkëpunimi në grup dhe kontributi i secilit nxënësi në detyrat e përbashkëta.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Kuptimet themelore të gjeometrisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Vizaton drejtëza paralele dhe normale

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.5 Konstruktin dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

## ASPEKTET SPECIFIKË TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Drejtëzat paralele**

FJALËT KYÇE: drejtëza paralele, largësi e pikave

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon drejtëzat paralele përmes definicionit të drejtëzave joprerëse;
- konstruktin drejtëzat paralele me vizore dhe me trekëndësh dhe vizore;
- përcakton vetinë dalluese dhe largësinë e drejtëzave duke mat largësinë e pikave të njëjës drejtëz ndaj drejtëzës tjetër.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat për gjeometri

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë në fletë dy drejtëza që nuk priten. Punimet e nxënësve diskutohen në grup duke i kujtuar pozitat reciproke të drejtëzave.

Një nxënës vizaton në tabelë dhe drejtëzat që nuk priten dhe e komenton pozitën e tyre duke

marrë ide dhe mendime për pozitën reciproke të dy drejtëzave edhe nga nxënësit tjerë të klasës.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” dhe secilit grup i jep detyrën në një fletë A4 ku kërkohet të vizatohen drejtëza paralele. Nxënësit diskutojnë në grup për pjesën që lexuan, vizatojnë në fletoret e tyre drejtëza paralele. Vizatimin duhet ta bëjnë në dy mënyrat e dhëna në libër.

- Mund të përdoren të dyja anët e vizores së sheshtë.
- Mund të përdoren vizorja dhe trekëndëshi i vizatimit (fig. 3.68 a, b).

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që në grupe të komentojnë mënyrat e vizatimit të drejtëzave paralele dhe vazhdon me pyetjet për klasën:

- Kur dy drejtëza janë paralele?
- A mund të gjykojmë saktë me sy të lirë për dy drejtëza se janë paralele? Argumento.
- Cila është vetia dalluese e drejtëzave paralele?
- Përshkruani mënyrat e vizatimit të dy drejtëzave paralele (vetëm me vizore dhe me vizore e trekëndësh vizatimi).
- Si shkruhen simbolikisht dy drejtëza që janë paralele?

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur**

Nxënësit zgjidhin detyrat e rubrikës “Ushtrohi duke zbatuar” duke bashkëpunuar në grup. Kur të mbarojnë zgjidhjen e detyrave, shkëmbejnë fletoret me grupin fqinjë për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna, saktësinë dhe pedantërinë në vizatime. Vlerësimi në fund të orës që bëhet në mes grupeve (vlerësim i ndërsjellët), ka efekt mjaft të mirë për fëmijët që kanë nevojë për ndihmën e shokëve të tyre, në të nxënit e mësimëve.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për detyrat e shtëpisë në Fletore pune dhe u jepen sqarime për to. Kërkon që të punojnë dy nga detyrat e Fletores së punës me programin Geogebra.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Gjeometria në rrafsh

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin si koncepte themelore gjeometrike.
- Përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të përfuara prej tyre.
- Mat; krahason segmentet.
- Konstrukton simetrikën e segmentit.
- Vizaton drejtëza paralele dhe pingule.
- Përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë).
- Vizaton kënde të ngushta dhe kënde të gjera.
- Dallon njësitë për matjen e këndeve ( $^{\circ}$ ,  $'$ ,  $''$ ) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën.
- Cakton masën e këndeve duke përdorur këndmatësin.
- Konstrukton simetrikën e këndit.
- Përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algjebrike dhe gjeometrike.
- Dallon llojet e këndeve, sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)*

**FJALËT KYÇE:** rrafsh, pikë, drejtës, gjysmëdrejtëz, segment, gjysmërrafshin, simetrike, kënd, llojet e këndit, njësia matëse e këndit, drejtëza paralele, pingule.

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin si koncepte themelore gjeometrike;
- përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të përfuara prej tyre;
- mat; krahason segmentet;

- konstrukton simetrikën e segmentit e këndit;
- vizaton drejtëza paralele dhe pingule;
- përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë);
- vizaton kënde të ngushta dhe kënde të gjera;
- dallon njësitë për matjen e këndeve ( $^{\circ}$ ,  $'$ ,  $''$ ) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën;
- cakton masën e këndeve duke përdorur këndmatësin;
- përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algjebrike dhe gjeometrike;
- dallon llojet e këndeve, sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare).

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuam:	Provoni të zgjidhni.
të përfytyrojmë rrafshin, pikën dhe drejtëzën;	1. Tregojini shokut/shoqes si e përfytyroni rrafshin, pikën dhe drejtëzën.
- në sa pjesë e ndan pika një drejtëz të dhënë dhe si quhen ato; - në sa pjesë e ndan drejtëza një rrafsh dhe si quhen ato?	2. Në fig. 3.78, konstruktoni drejtëzën OU. Ku gjenden pikat E dhe F? Tregoni gjysmëdrejtëzat me origjinë pikën O.  Konstruktoni gjysmëdrejtëzat me origjinë pikën E.
- ç'është këndi; - të tregojmë llojet e këndeve sipas masës së tyre;	3. Vizatoni një kënd të ngushtë, të gjerë, të shtrirë, të drejtë, të hapur, të plotë. 4. Kërkojini shokut/shoqes të masë këndet duke përdorur kënd matësin.
- njësinë e matjes së masës së këndit dhe nënfishat e saj;	5. Tregoni sa minuta dhe sa sekonda këndore ka: $10^{\circ} = \dots\dots\dots' = \dots\dots\dots''$ $90^{\circ} = \dots\dots\dots' = \dots\dots\dots''$ 6. Plotësoni barazimin: $500' = \dots\dots\dots'$ $4000'' = \dots\dots\dots' \dots\dots''$
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Ju jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.  
Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në konstruktimin e drejtëzës, gjysmëdrejtëzës, segmentit, këndit, simetrikes së segmentit dhe këndit, të drejtëzave paralele dhe pingule, në klasifikimin e llojeve të këndeve sipas masës dhe sipas brinjëve të përbashkëta që ato kanë, matja e këndit duke përdorur këndmatësin, kalimi i njësive të matjes së këndit nga një njësi në tjetrën, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Gjeometria në rrafsh

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin si koncepte themelore gjeometrike.
- Përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të përfuara prej tyre.
- Mat; krahason segmentet.
- Konstrukton simetriken e segmentit.
- Vizaton drejtëza paralele dhe pingule.
- Përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë).
- Vizaton kënde të ngushta dhe kënde të gjera.
- Dallon njësitë për matjen e këndeve ( $^{\circ}$ ,  $'$ ,  $''$ ) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën.
- Cakton masën e këndeve duke përdorur këndmatësin.
- Konstrukton simetriken e këndit.
- Përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algjebrike dhe gjeometrike.
- Dallon llojet e këndeve, sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.5 Konstruktore dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Vlerësim**

**FJALËT KYÇE: rrafsh, pikë, drejtës, gjysmëdrejtëz, segment, gjysmërrafshin, simetrike, kënd, llojet e këndit, njësia matëse e këndit, drejtëza paralele, pingule.**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin si koncepte themelore gjeometrike;
- përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të përfutuara prej tyre;
- mat; krahason segmentet;
- ndërton simetrikën e segmentit e këndit;
- vizaton drejtëza paralele dhe pingule;
- përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë);
- vizaton kënde të ngushta dhe kënde të gjera;
- dallon njësitet për matjen e këndeve ( $^{\circ}$ ,  $'$ ,  $''$ ) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën;
- cakton masën e këndeve duke përdorur këndmatësin;
- përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algjebrike dhe gjeometrike;
- dallon llojet e këndeve, sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare).

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Ju jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

Realizohet vlerësim i shokut nga shoku.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në konstruktimin e drejtëzës, gjysmëdrejtëzës, segmentit, këndit, simetrikes së segmentit dhe këndit, të drejtëzave paralele dhe pingule, në klasifikimin e llojeve të këndeve sipas masës dhe sipas brinjëve të përbashkëta që ato kanë, matja e këndit duke përdorur këndmatësin, kalimi i njësive të matjes së këndit nga një njësi në tjetrën, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

# TEMA 4

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2. 1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3. 4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Kuptimi i thyesës*

**FJALËT KYÇE:** emërues, numërues, vijë thyesore, thyes

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon thyesën duke specifikuar pjesët e saj;
- cakton thyesat në drejtëzën numerike duke ndarë në pjesë të barabarta tërësinë;
- dallon llojet e thyesave sipas vlerës së numëruesit dhe emëruesit;
- zbaton thyesat duke marr shembuj të ndryshëm nga jeta reale.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fotografi

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme duke sqaruar që jo gjithmonë mund të kryejmë punë me numra të plotë.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mini leksion

Mësuesi/ja fillon leksionin duke prezantuar para nxënësve fotografi të një buke.

“Të themi se keni filluar të hani një bukë dhe nuk keni arritur të hani të tërën. Sa bukë keni ngrënë?”

Sigurisht, nuk keni ngrënë 1 bukë, por as 0 jo!

Pra, kemi nevojë për disa numra të tjerë për të treguar se sa bukë keni ngrënë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”, të cilën e ka ndarë në tri pjesë. Nxënësit do të lexojnë vetëm pjesën e parë dhe në ndalesë, mësuesi/ja bënë pyetjet:

- Si quhen numrat e dhënë  $\frac{1}{3}$ ,  $\frac{5}{8}$ ,  $\frac{6}{7}$ ?
- Analizoni thyesën  $\frac{5}{7}$ .

• Si quhet numri 7 dhe çfarë paraqet ai te thyesa e dhënë?

• Po numri 5 si quhet? Çfarë paraqet te kjo thyesë numri 5?

Lexojnë edhe pjesën e dytë dhe mësuesi/ja bën pyetjet në vazhdim.

• A mund t'i paraqesim thyesat si numrat e tjerë në bosht numerik?

• Paraqitni në segmentin OE thyesat  $\frac{1}{6}$ ,  $\frac{2}{6}$ ,  $\frac{3}{6}$ ,  $\frac{4}{6}$ ,  $\frac{5}{6}$ .

• Vizatoni drejtëzën numerike dhe paraqitni në të thyesën  $\frac{3}{5}$ .

Nxënësit lexojnë pjesën e fundit dhe iu përgjigjen pyetjeve në vazhdim.

• Çfarë quajmë thyesa të rregullta? Shkruani tri thyesa të tilla.

• Çfarë quajmë thyesa të parregullta? Shkruani tri thyesa të tilla.

• Paraqitni në drejtëzën numerike thyesat  $\frac{10}{9}$ ,  $\frac{15}{8}$ .

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grup

Nxënësit të organizuar në grupe do të zgjidhin detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrime”, duke i komentuar me njëri-tjetrin. Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna gjatë ndërtimit të njohurive të reja.

Duke përdorur tri ngjyrat e semaforit në fund të punës në grupe, do të bëhet vlerësimi i nxënësve për të nxënësit e kësaj njësie mësimore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

#### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identi ikon thyesat e barabarta, zgjeron dhe thjeshton thyesat.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecure/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III. 6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijës.

#### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1. 2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
8. 1 Përdor teknologjinë për hulumtime, llogaritje dhe matje, në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetia themelore e thyesave

**FJALËT KYÇE:** thyesa të barabarta, zgjerim i thyesës

#### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon thyesat e barabarta duke i zgjeruar ato;
- përkufizon vetinë themelore të thyesave të barabarta;
- zbaton thyesat e barabarta duke i aplikuar në shembuj nga jeta e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, muri thyesorë, sahati, lap-top-i

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Shprehja e orës si thyesë në raste të veçanta.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**


**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim nga interneti**

Mësuesi/ja prezanton para nxënësve një video nga interneti “*Fractions everywhere*” (thyesat kudo).

<http://www.youtube.com/watch?v=h3YxTagTgQ4>

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja prezanton para nxënësve murin thyesor, në të cilin në mënyrë vizuale paraqiten thyesat e barabarta. Ata analizojnë së bashku thyesat e shkruara në forma të ndryshme dhe ato që paraqesin pjesë të barabarta të një tërësie.



Nxënësit përmes murit thyesorë dallojnë thyesa të barabarta dhe i shpjegojnë duke i paraqitur si zgjerim i thyesave duke shumëzuar numëruesin dhe emëruesin me të njëjtin numër. Për të konkretizuar thyesat e barabarta dhe vetinë e zgjerimit të thyesave, mësuesi/ja mund të përdorë dhe sahatin.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Stilolapsat në mes**

Nxënësit punojnë në grupe detyrat e rubrikës “Ushtrime” dhe mësuesi/ja i nxjerrë me radhë në tabelë për të zgjidhur detyrat. Nxënësi/pronarë i lapsit të zgjedhur do të dalë në tabelë për të zgjidhur një detyrë. Mësuesi/ja do të veprojë kështu në secilin grup derisa të zgjidhin të gjitha detyrat që kishin.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin, punën në grupe dhe për shembujt nga jeta e përditshme ku ata do të konkretizojnë me mësimin e njësisë mësimore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Identifikon thyesat e barabarta, zgjeron dhe thjeshton thyesat.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III. 2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

- 2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
- 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Thjeshtimi i thyesave. Thyesat dhe numrat natyrorë*

**FJALËT KYÇE:** thyesa të barabarta, thjeshtim i thyesës, pjesëtim i numrave natyrorë

### **Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon thyesat e barabarta duke i thjeshtuar ato;
- përkufizon veprimin e pjesëtimit duke e shprehur si thyesë dhe anasjelltas;
- zbaton thyesat e barabarta duke i thjeshtuar ato përmes shembujve nga jeta e përditshme.

### **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, muri thyesorë, fletë A4

### **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Ndarjet e tërësive (thyesat) mësuesi/ja i konkretizon me ushqime të ndryshme, p.sh. buka, torta, pica etj.

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja fton nxënësit që të bashkëpunojnë në grupe dhe të analizojnë murin thyesorë, i cili është vendosur në muret e klasës. Ata do të përmendin disa thyesa të barabarta të cilat janë shprehur me anë të thjeshtimit të thyesave.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Lexo/puno në dyshe/thuaja grupit**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e re të mësimin në rubrikën “vrojtoni dhe mësoni”. Nxënësit do të ndahen në dyshe dhe do të fillojnë diskutimin për pjesën që lexuan.

Nxënësi i parë do të jetë në rolin e “mësuesit” për pjesën e parë “Thjeshtimi i thyesës”.

Nxënësi i dytë do të jetë në rolin e “mësuesit” për pjesën e dytë “Thyesa si pjesëtim i dy numrave natyrorë”.

Mësuesi/ja iu shpërndan grupeve nga një fletë pune me nga dy detyra më thjeshtimin e thyesave dhe dy detyra ku nxënësit do të shprehin thyesën si pjesëtim të numrave natyrorë.

Shembujt e dhënë do t'i diskutojnë dhe zgjidhin në kuadër të grupit dhe do të përsërisin dhe përforcojnë përkufizimet dhe rregullat për thjeshtimin e thyesës dhe të shprehurit e saj si pjesëtim i dy numrave natyrorë.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Nxënësit punojnë në grupe detyrat nga rubrika “ushtrimë”. Zgjidhjet e detyrave do t'i shkruajnë në një fletë A4. Fletën do ta përcjellin në grupin fqinjë në cikël. Grupet do të diskutojnë dhe analizojnë detyrat e zgjidhura nga grupi tjetër dhe në fund do ta vlerësojnë duke përdorur fytyrat 😊 ☹.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në pjesën e fundit do të ketë vlerësim të ndërsjellë ku nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Identifikon thyesat e barabarta, zgjeron dhe thjeshton thyesat.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Sjellja e thyesave në emërues të përbashkët*

**FJALËT KYÇE:** thyesa të barabarta, thjeshtim i thyesës, pjesëtim i numrave natyrorë

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- kthen dy a më shumë thyesa në thyesa me emërues të përbashkët duke gjetur shvp të emëruesve;
- zgjidh problema të shprehura me thyesa duke i kthyer në thyesa me emërues të përbashkët;
- zbaton kthimin e thyesave në thyesa me emërues të përbashkët në shembuj nga jeta e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, muri thyesorë, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Analizohen distanca rrugore, ndarje të tërësive etj.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja shpërndan në çdo grup një fletë pune me nga dy detyra. Për dy shembujt e dhënë nxënësit do të punojnë në dyshe dhe pastaj do të diskutojnë dhe do t'u përgjigjen pyetjeve duke i koordinuar idetë e tyre në grup.

Mësuesi/ja merr përgjigje nga disa nxënës dhe nuk i diskuton përgjigjet e dhëna.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Lexo/puno në dyshe/thuaja grupit**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e re të mësimin në rubrikën “vrojtoni dhe mësoni”. Ata do të vazhdojnë diskutimin në dyshe dhe pastaj në grupe për të punuar shembujt e dhënë në libër duke i kthyer dy e më shumë thyesa në thyesa me emërues të përbashkët.

Do të kthehen te detyrat e dhëna në fillim dhe do të vlerësojnë zgjidhjen e saktë apo jo të problemave.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargëshi**

Nxënësit punojnë në grupe nga një pesëvargësh me emrin THYESË. Punimet do t'i prezantojë një nxënës nga grupi para klasës.

Një pesëvargësh mund të jetë:

THYESË  
E RREGULLT E PARREGULLT  
THJESHTOHET ZGJEROHET BARAZOHET  
THYESAT KANË NUMËRUES DHE EMËRUES  
PJESËTIM

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe në kthimin e thyesave me emërues të përbashkët. Shkrimi i një pesëvargëshi do të vlerësohet si përkufizim i thyesës dhe të shprehurit e saktë dhe pa gabime.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Krahason thyesat duke shfrytëzuar drejtëzën numerike, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1. 2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Krahasimi i thyesave

FJALËT KYÇE: thyesë më e madhe, thyes më e vogël, krahasim i thyesave

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- krahason dy a më shumë thyesa me emërues të njëjtë, numërues të njëjtë dhe numërues dhe emërues të ndryshëm;

- krahason thyesat duke përdorur metodën e shumëzimit në diagonale;

- radhitë thyesat nga më e vogla te më e madhja dhe anasjelltas duke përdorë rregullat e krahasimit;

- zbaton krahasimin e thyesave në shembuj nga jeta e përditshme.

### **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, muri thyesorë, fletë A4

### **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës

Krahasohen dukuri të ndryshme të përditshmërisë që mund të shprehen si pjesë të ndara të një të plote.

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që duke diskutuar në grupe dhe bazuar në murin thyesor të përgjigjen në pyetjet:

- Çështë më e madhe:  $1/3$  apo  $2/8$ ? Për sa?
- Çështë më e vogël:  $5/6$  apo  $3/4$
- Sa është ndryshimi në mes të  $5/6$  dhe  $1/3$ ?

Merren mendimet e disa nxënësve dhe shkruhen në tabelë.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Ndërthurja 1**

Nxënësit ndahen në grupe me nga 5 nxënës. Secilit i caktohet nga një numër nga 1-5. Mësuesi/ja u kërkon atyre të rigrupohen sipas numrave. Nxënësve që i takon numri 1 bëjnë në një grup. Kështu veprohet edhe me numrat e tjerë. U caktohen pjesët për të cilën ata do të jenë “ekspert”.

Grupi i nxënësve me numrin 1 do të kenë për të përgatitur pjesën ”Krahasimi i thyesave me emërues të njëjtë”; grupi i nxënësve me numrin 2 “Krahasimin e thyesave me numërues të njëjtë”; grupi i nxënësve me numrin 3 “Krahasimin e thyesave me numërues dhe emërues të ndryshëm”, grupi i nxënësve me numrin 4 “Krahasimi i thyesave me numrin 1” dhe grupi i nxënësve me numrin 5 “Metoda e shumëzimit në diagonale për krahasimin e thyesave.”

Pasi secili grup ekspertësh të ketë diskutuar dhe përgatitur mirë pjesën e vet do të kthehen në grupet fillestare dhe do t’u shpjegojnë të tjerëve secili pjesën e vet. Ata do t’i zgjidhin secili nga dy detyra për grupin.

Tani që kanë marrë njohuritë e duhura për krahasimin e thyesave do t’i kthehen pyetjeve në fillim për të vërtetuar nëse janë përgjigje saktë.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Teli për tharje**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga 10 fletë A6 ku është e shkruar një thyes. Kërkon që të diskutojnë në grup dhe të dalin t’i vendosin në “Telin për tharje” (shih në udhëzime) duke filluar nga thyesa më e vogël tek ajo më e madhe. Secili grup prezanton radhitjen e bërë në telin e tharjes.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe në kthimin e krahasimin e thyesave. Do të vlerësohen edhe për problemën e shtruar dhe mënyrën e zgjidhjes së saj.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1. 1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e thyesave

**FJALËT KYÇE:** mbledhje e thyesave, emërues të njëjtë, emërues të ndryshëm

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- mbledh dy a më shumë thyesa me emërues të njëjtë duke i zgjidhur shembujt e dhënë;
- mbledh dy a më shumë thyesa me emërues të ndryshëm duke i kthyer në emërues të njëjtë;
- zbaton mbledhjen e thyesave në problema duke i formuluar ato në formë tekstuale dhe duke i zgjidhur.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, muri thyesorë, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës

Krahasohen dukuri të ndryshme të përditshmërisë që mund të shprehen si pjesë të ndara të një të plote.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja u shpërndanë nga një fletë pune nxënësve ku janë të dhëna nga dy detyra me figura. Aty janë të dhëna dy figura të cilat janë të ndara në pjesë të barabarta. Disa nga ato pjesë janë të ngjyrosura me ngjyrë të kuqe dhe ca të tjera me ngjyrë të blertë. Mësuesi/ja pyet:

- Ç'pjesë e figurës është ngjyrosur me të blertë?
- Ç'pjesë e figurës është ngjyrosur me të kuqe?
- Ç'pjesë e figurës është ngjyrosur?
- Çfarë vini re për thyesat e mësipërme?

Të njëjtat do t'i paraqesin me anë të harqeve në drejtëzën numerike dhe do ta diskutojnë me klasën duke u përgjigjur në pyetjet:

- Ç'pjesë e njësisë së boshtit numerik është shënuar:
  - a) me harqe të kuqe? b) me harqe të blerta? c) me harqe?

**Ndërtimi i njohurive të reja:**

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në libër rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Shembujt e dhënë për sqarim në këtë rubrikë t'i diskutojnë në dyshe dhe në grup duke dhënë përfundimin se si mblidhen dy thyesa me emërues të njëjtën dhe si mblidhen thyesat me emërues të ndryshëm. Mësuesi/ja zgjedh dy nxënës që të zgjidhin nga një detyrë në tabelë për ta diskutuar me klasën se si veprohet në të dyja rastet.

$$\frac{a}{c} + \frac{b}{c} = \frac{a+b}{c}, \text{ ku } a, b, c \text{ janë numra natyrorë.}$$

Dhe rastin kur thyesat kanë emërues të ndryshëm ku ato do t'i kthejmë në emërues të njëjtë duke gjetur *shvp* të emëruesve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të formulojnë nga dy problema matematikore që kanë të bëjnë me mbledhjen e thyesave. Njëra detyrë duhet të jetë e formuluar në mënyrë që të mblidhen thyesa me emërues të njëjtë, ndërsa tjetra thyesa me emërues të ndryshëm. Detyrat punohen në fletë A4 dhe vendosen në tabelë. Nga secili grup një nxënës shkon dhe vlerëson secilin punim nga grupet me nga një letër ngjitëse me ngjyrë. Mësuesi/ja verifikon saktësinë e tyre duke i prezantuar para klasës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe në mbledhjen e thyesave. Do të vlerësohen edhe për problemat e shtruar dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Shndërron thyesat e parregullta në numra të përzier dhe anasjelltas.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1. 2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

2. 1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat e përzier. *Kthimi i thyesave të parregullta në numra të përzier*

**FJALËT KYÇE:** numra të përzier, thyesa të parregullta

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon numrat e përzier duke dalluar pjesën e plotë dhe pjesën thyesore;
- kthen thyesat e parregullta në numra të përzier dhe anasjelltas përmes veprimeve të caktuara për shndërrimin e tyre;
- argumenton me shembuj nga jeta reale rëndësinë e përdorimit të thyesave të parregullta edhe si numra të përzier.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës

Krahasohen dukuri të ndryshme të përditshmërisë që mund të shprehen si pjesë të ndara të një të plote.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja u shpërndanë nga një fletë pune nxënësve ku janë dhënë figurat. Aty janë dhënë dy rathë të njëjtë, të cilat janë të ndarë në pjesë të barabarta. Të gjitha ndarjet e njërit rreth janë të ngjyrosura, ndërsa të rrethit tjetër janë ngjyrosur disa prej tyre (të gjitha pjesët e ngjyrosura duhet të jenë më gjyryrë të njëjtë). Mësuesi/ja pyet:

- Ç'pjesë e rrethit të parë është ngjyrosur? Shpreheni si thyesë dhe si numër të plotë.
- Ç'pjesë e rrethit të dytë është ngjyrosur?
- Mblidhni thyesat që tregojnë pjesët e ngjyrosura të të dy rathëve.
- Çfarë lloj thyese fituat? A mund ta shprehni ndryshe këtë thyesë?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela T**

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në libër rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Duke diskutuar shembujt me shokët/shoqet e grupit, do të plotësojnë tabelën.

Thyesat	Përshkrimi
$\frac{6}{5}, \frac{8}{3}, \frac{23}{4}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thyesa të parregullta</li> <li>-Numëruesi më i madh se emëruesi <math>6 &gt; 5, 8 &gt; 3, 23 &gt; 4</math></li> </ul>
$1\frac{2}{3}, 3\frac{1}{6}, 5\frac{4}{7} \quad \mathbf{a^b}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numra të përzier</li> <li>-Pjesa e plotë dhe pjesa thyesore (thyes e rregullt)</li> </ul>
$\frac{41}{8} = 5\frac{1}{8}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>a- pjesa e plotë <math>\frac{b}{c}</math> - pjesa thyesore ku <math>c &gt; b</math> dhe <math>c \neq 0</math></li> </ul>
$7\frac{2}{5} = 7 + \frac{2}{5}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kthejmë thyesën e parregullt në numër të përzier</li> <li>-Pjesëtojmë numëruesin me emëruesin</li> </ul>
$7\frac{2}{5} = \frac{7 \cdot 5 + 2}{5} = \frac{35 + 2}{5} = \frac{37}{5}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>5 – herësi (pjesa e plotë)</li> <li>1 – mbetja</li> <li>8 – emëruesi</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kthejmë numrin e përzier në thyes të parregullt</li> <li>-Shumëzojmë të plotën me emëruesin dhe e mbledhim me numëruesin.</li> </ul>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Gushëkuqi rrethor**

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës “**Ushtrime**” duke bartur fletën e detyrave në qark brenda grupit. Detyrën e parë e zgjidh nxënësi i parë dhe fletën e përcjellin te njëri-tjetri, derisa të përfundojnë të gjitha detyrat.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në fund, nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin duke komentuar detyrat e zgjidhura nga secili brenda grupit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin)

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II. 4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1. 1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.
5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Zbritja e thyesave**

FJALËT KYÇE: zbritje e thyesave, ndryshim

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- zbrit dy thyesa me emërues të njëjtë duke u bazuar në rregullën e zbritjes së tyre;
- zbrit thyesat me emërues të ndryshëm duke i kthyer në emërues të njëjtë dhe përdor rregullat e zbritjes;
- aplikon në shembuj nga jeta reale zbritjen e thyesave duke gjetur ndryshimin.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës

Zbret pjesë të tërësisë të dhënë në formë thyesë në shembuj nga përditshmëria.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja ndanë fletën në tetë pjesë dhe shtatë prej tyre ua jep në grup. Kështu vepron në secilin grup. Mësuesi/ja pyet:

- Ç'pjesë të fletës keni përpara? Shkruani thyesën që paraqet ajo.
- Nga këto pjesë, katër prej tyre ngjyrosni.
- Sa nga pjesët e ndara në fillim ju mbetën në tryezë të pangjyrosura?
- Cila është kjo thyesë?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i avancuar**

Për të gjetur zgjidhjen në shembullin e dhënë në fillim, në fakt ju keni zbritur.

Kështu mësuesi/ja fillon leksionin duke vazhduar më tutje me diskutimet me nxënësit. Kujtojnë mbledhjen e thyesave me emërues të njëjtë dhe të njëjtën rregull e zbatojnë te zbritja.

Komentojnë shembujt e dhënë të zgjidhur në libër te rubrika **“Vrojtoni dhe mësoni”** duke u bazuar në barazimin.

$$\frac{a}{c} + \frac{b}{c} = \frac{a+b}{c} \text{ ku } a, b, c \text{ janë numra natyrorë dhe } a > b.$$

Nxënësit në grupe zgjidhin detyrën “Turisti përshkoi  $\frac{2}{3}$  e rrugës” dhe u përgjigjen pyetjeve të mësuesit/es.

- Ç'pjesë e rrugës mbeti për t'u përshkuar?
- Cila pjesë është më e madhe, ajo që u përshkua apo ajo që mbeti?
- Sa më e madhe?

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të kujtojnë rregullën se si mblidhen thyesat me emërues të ndryshëm. Ai/ajo sqaron se në të njëjtën mënyrë kryhet edhe zbritja e thyesave me emërues të ndryshëm. Nxënësve u jep detyrën për të zgjidhur “Në një dyqan  $\frac{1}{4}$  e frutave ishin mollë, ndërsa  $\frac{2}{5}$  portokaj.” Gjeni ndryshimin.

- Cili është ndryshimi në sasi mes mollëve dhe portokajve?
- Çfarë kishte më shumë mollë apo portokaj?
- Si e gjetët zgjidhjen?

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/thuaja grupit**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të zgjidhin detyrat e rubrikës “**Ushtime**”. Ata do të zgjidhin detyrat duke menduar dhe koordinuar zgjidhjet me shokun/shoqen pranë dhe duke diskutuar rreth zgjidhjeve me grupin. Mësuesi/ja kontrollon grupet se si po i zgjidhin detyrat, vlerëson nxënësit gjatë vëzhgimit dhe ndihmon ata që kanë ngecje në të nxënë në këtë njësi.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në pjesën e fundit të orës, mësuesi/ja vlerëson nxënësit duke i vëzhguar.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

### Rezultati i të nxënit të temës:

-Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3. 3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

4. 2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Shumëzimi i thyesave*

FJALËT KYÇE: **shumëzim i thyesave, prodhim**

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- shumëzon dy thyesa duke u bazuar në rregullën e shumëzimit të tyre;
- gjen prodhimin e dy llojeve të ndryshme të thyesave;
- aplikon në shembuj nga jeta reale shumëzimin e thyesave p.sh., njehson syprina, mat kohën etj.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna/ Shumëzon pjesë të tërësisë të dhënë në formë thyese në shembuj nga përditshmëria.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Gjej titullin

Mësuesi/ja shpërndan në grupe fletët e punës ku është dhënë detyra “Piktura ka përmasat 80 cm gjatësi dhe 60 cm gjerësi.” Nxënësit mundohen t’u përgjigjen pyetjeve të dhëna dhe pastaj i diskutojnë me mësuesi/en dhe klasën. Mësuesi/ja pyet:

- Si e llogarisni syprinën e pikturës me përmasat e dhëna?
- Po nëse këto përmasa janë të shprehura me thyesa?
- Nëse gjatësia do të jetë  $\frac{4}{5}$  m dhe gjerësia  $\frac{3}{5}$  m, a mund ta njehsoni syprinën e pikturës?

Dy pyetjet e fundit çojnë te titulli i mësimit.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Nxënësit udhëzohen të lexojnë rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Kur nxënësit të kenë mbaruar leximin, fillojnë diskutimin në grup për pjesën e lexuar. Detyrën e dhënë në fillim të orës tanimë mund ta zgjidhin sepse e kanë të qartë se si shumëzohen thyesat. Për të vërtetuar të nxënët e kësaj njësie mësimore, mësuesi/ja bën pyetjet:

- Si shumëzohen dy thyesa?
- Si vepruat për të njehsuar syprinën e pikturës (fig.4.19)?
- Shkruani rregullën e shumëzimit të thyesave me anë të shkronjave.
- Përshkruani shumëzimin e një numri natyrorë me një thyesë.
- Jepni një shembull të shumëzimit të një thyese me një numër të përzier. Përshkruani zgjidhjen.
- Zmadhohet apo zvogëlohet numri, nëse e shumëzoni me një thyesë më të vogël se 1? Argumentoni përgjigjen.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Zgjidhjet e detyrave të dhëna do t’i japin para klasës duke e caktuar një nxënës nga grupi për të dalë në tabelë. Gjatë zgjidhjes së detyrave nxënësit japin sqarime.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në pjesën e fundit të orës, mësuesi/ja vlerëson nxënësit në veçanti ata që ka nxjerrë në tabelë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin)..

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3. 3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

4. 1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Thyesat e anasjella. Pjesëtimi i thyesave*

FJALËT KYÇE: **thyesa të anasjella, pjesëtim i thyesave, herës**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- kthen thyesat e dhëna në thyesa të anasjella duke ua ndërruar vendin emëruesit me numëruesin;
- pjesëton dy thyesa duke u bazuar në rregullën e shumëzimit të tyre;
- zbaton në shembuj nga jeta reale duke i zgjidhur përmes pjesëtimit të thyesave.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna/ Pjesëton pjesë të tërësisë të dhënë në formë thyese në shembuj nga përditshmëria.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të përgjigjen në detyrën e dhënë: “Një sasi mollësh me masë  $1\frac{1}{2}$  kg duhen ndarë në mënyrë të barabartë midis 3 shokëve. Si do t’i ndanit ju? Argumentoni. Merren mendimet e grupeve dhe argumentet që ata japin për zgjidhjen e dhënë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari dypjesësh

Nxënësit lexojnë njësinë mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni” dhe fillojnë të plotësojnë dy rubrikat e ditarit duke diskutuar dhe zgjidhur detyrat me shokët e grupit.

Detyra	Zgjidhja
1. Caktoni thyesat e anasjella të thyesave të dhëna: $\frac{4}{5}, \frac{7}{9}, \frac{3}{2}$	$\frac{4}{5}$ thyesa e anasjellë e saj është $\frac{5}{4}$ $\frac{7}{9}$ thyesa e anasjellë e saj është $\frac{9}{7}$ , $\frac{3}{2}$ thyesa e anasjellë e saj është $\frac{2}{3}$
2. Sa është prodhimi i thyesave të anasjella? Argumento.	$\frac{a}{b} \cdot \frac{b}{a} = \frac{a \cdot b}{a \cdot b} = 1$
3. Si njehsohet herësi i dy thyesave?	$\frac{4}{5} \cdot \frac{5}{4} = \frac{4 \cdot 5}{5 \cdot 4} = \frac{20}{20} = 1$
4. Njehsoni $\frac{4}{27} : \frac{2}{9}$	$\frac{a}{b} : \frac{c}{d} = \frac{a}{b} \cdot \frac{d}{c}$ $\frac{4}{27} : \frac{2}{9} = \frac{4}{27} \cdot \frac{9}{2} = \frac{4 \cdot 9}{27 \cdot 2} = \frac{2}{3}$

Tani i kthehen detyrës së dhënë në fillim të orës dhe gjejnë përgjigjen e saktë.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës “Ushtrime”. Zgjidhjet e detyrave të dhëna do t’i japin para klasës duke e caktuar një nxënës nga grupi për të dal në tabelë. Gjatë zgjidhjes së detyrave nxënësit japin sqarime.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në pjesën e fundit të orës, mësuesi/ja i vlerëson nxënësit, në veçanti ata që ka nxjerrë në tabelë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Cakton pjesën e dhënë te tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3. 3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Gjetja e pjesës dhe e së tërës

**FJALËT KYÇE:** pjesë, tërësi, thyesë

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- cakton pjesën në formë thyese kur në detyrë është dhënë e tëra;
- gjen të tërën (tërësinë) kur në detyrë është dhënë pjesa në formë thyese;
- zbaton në shembuj nga jeta reale duke gjetur pjesët nga tërësia dhe tërësinë nga pjesa.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Gjetja e pjesës dhe e të tërës jepet të shumtën e rasteve përmes shembujve nga përditshmëria.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të përgjigjen në detyrën e dhënë: “Mielli përbën mesatarisht  $\frac{3}{5}$  e masës së bukës. Pra, për 1 kg bukë, duhen mesatarisht 600 gr. miell. A mund të gjeni sa miell duhet për 2 kg bukë? Po, për 5 kg bukë?

Merren mendimet e grupeve dhe argumentet që ata japin për zgjidhjen e dhënë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim në dyshe**

Nxënësit udhëzohen të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**” duke bashkëpunuar në dyshe me shokun pranë.

Njëri nga dyshja e nxënësve lexon mënyrën e parë të gjetjes së pjesës kur njohim tërësinë, ndërsa tjetri lexon mënyrën e dytë.

Kur mbarojnë leximin, fillojnë të shpjegojnë dhe të argumentojnë përmes shembujve atë që lexuan. Për të qenë më bashkëpunues, ata duhet t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe të marrin sa më shumë informacione nga shoku/shoqja për pjesën e lexuar.

Në të njëjtën mënyrë veprojnë për të mësuar dy mënyrat e gjetjes së tërësisë kur njohin pjesën.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe**

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Detyrat do t'i zgjidhin në fletë A4 dhe do t'i ekspozojnë në Turin e galerisë ku edhe do të vlerësohen nga grupet e tjera.

Mësuesi/ja kontrollon detyrat e zgjidhura dhe mënyrën e vlerësimit të njëri-tjetrit nga grupet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Në pjesën e fundit të orës, nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin në grupe dhe mësuesi/ja konfirmon këtë vlerësim.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat thyesorë (racionalë)

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Zgjidh detyra me fjalë (në situatë praktike) duke përdorur veprimet me thyesa.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.4 Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4. 3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

5. 1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Problema**

**FJALËT KYÇE:** pjesë, tërësi, thyes, veprime me thyesa

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- aplikon hapat për zgjidhjen e problemave të dhëna me fjalë ku përdoren thyesa;
- njehson duke kryer veprimet e mësuara më parë me thyesat;

- zbaton në shembuj nga jeta reale duke llogaritur me thyesat për të gjetur zgjidhjen e problemave;
- vlerëson rëndësinë e njohjes së veprimeve me thyesa për të zgjidhur problema të ndryshme nga përditshmëria përmes shembujve që zgjidhë.

### **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

### **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës

Shumë situata jetësore na paraqiten si problema që duhet t'i zgjidhim përmes thyesave.

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pyetje/përgjigje**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të kujtojnë hapat e zgjidhjes së problemave që kanë përmendur te numrat natyrorë.

Merren mendimet e grupeve duke u dhënë mundësinë që secili prej tyre të përmendin së paku nga një hap.

Mësuesi/ja kujton se në zgjidhjen e problemave me thyesa duhet aplikuar të njëjtët hapa.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa**

Mësuesi/ja në fillim sqaron se hapat mund të jenë më të thjeshtë në zgjidhjen e problemave, pra kalojmë nëpër tre-katër hap.

Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën "Arlindi shtrydhi 3 portokaj dhe 3 qitro. Prej secilit portokall ai nxori  $\frac{2}{10}$  litra lëng; prej secilës qitro ai nxori  $\frac{3}{10}$  litra lëng. Arriti Arlindi të mbushë një shishe prej 1 litër e gjysmë me lëngun e portokajve dhe qitrove?"

**Hapi i parë:** Lexoni me vëmendje problemën.

**Hapi i dytë:** Planifikoni zgjidhjen (bëni një skemë).

**Hapi i tretë:** Zgjidhni problemën (bëni njehsimet).

**Hapi i katërt:** Kontrolloni rezultatin (provoni saktësinë).

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës e zgjedhura nga ai/ajo e të cilat ua shpërndanë në grupe në fletë A4. Detyrat janë të ndryshme për secilin grup dhe duhet të jenë problema të marra nga situata të ndryshme jetësore në mënyrë që para nxënësve të jepen sa më shumë shembuj të tillë.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në çdo përgjigje që ata japin dhe për punën në grupe. Vlerësohen në format që përdorin për zgjidhjen e problemave që iu ndihmojnë nxënësve në zbatimin e matematikës në jetën reale.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Thyesat

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit. Paraqet thyesat si pjesë të tërësisë.
- Dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzierë.
- Identifikon thyesat e barabarta.
- Thjeshton thyesat.
- Shndërron thyesat e parregullta në numra të përzierë dhe anasjelltas.
- Cakton pjesën e dhënë të tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa.
- Paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik).
- Krahason thyesat duke shfrytëzuar boshtin numerik, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale.
- Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin).
- Zgjidh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.4 Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)**

**FJALËT KYÇE: thyesa, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier, të barabarta, të anasjella, të thjeshtueshme, të pathjeshtueshme, bosht numerik, masë, veprimet aritmetike me thyesat.**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit;
- paraqet thyesat si pjesë të tërësisë;
- dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier;
- identifikon thyesat e barabarta;
- thjeshton thyesat;
- shndërron thyesat e parregullta në numra të përzierë dhe anasjelltas;
- cakton pjesën e dhënë të tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa;
- paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik);
- krahason thyesat duke shfrytëzuar boshtin numerik, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale;
- kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin);
- zgjidh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa.


**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**  
Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj, teme duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuam:	Provoni të zgjidhni.
që thyesa është herës i numëruesit me emëruesin;	1. Shkruani si thyesë: $2 : 3 =$ $12 : 5 =$ 2. Shkruani si herës thyesat: $\frac{2}{6} = \dots\dots\dots$ ; $\frac{11}{3} =$
çfarë tregon numëruesi dhe emëruesi i thyesës;	3. Në sa pjesë është ndarë drejtkëndëshi? - Ç'pjesë është ngjyrosur me të kuqe? - Ç'pjesë është ngjyrosur me blu? - Ç'pjesë ka mbetur pa ngjyrosur? 
si duhet të jetë numëruesi krahasuar me emëruesin që thyesa të jetë: a) e rregullt; b) e parregullt; c) e barabartë me numër natyror.	4. Shkruani 5 thyesa: a) të rregullta; b) të parregullta; c) të barabarta me numër natyrorë.
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shprehjen e thyesës si herës të dy madhësive, në dallimin e thyesave të rregullta dhe jo të rregullta, kthimin e thyesa jo të rregullta në numra të përzierë, thyesat e anasjella, vendosja e thyesës në boshtin numerik, thjeshtimin e thyesës, kryerjen e veprimit të mbledhjes, zbritje, shumëzimit dhe pjesëtimit me numrat thyesor, thjeshtimin e thyesës, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Thyestat**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit. Paraqet thyestat si pjesë të tërësisë.
- Dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzierë.
- Identifikon thyestat e barabarta.
- Thjeshton thyestat.
- Shndërron thyestat e parregullta në numra të përzierë dhe anasjelltas.
- Cakton pjesën e dhënë të tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa.
- Paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik).
- Krahason thyestat duke shfrytëzuar boshtin numerik, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale.
- Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimit).
- Zgjidh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Vlerësim**

FJALËT KYÇE: **thyesa, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier, të barabarta, të anasjella, të thjeshtueshme, të pathjeshtueshme, bosht numerik, masë, veprimet aritmetike me thyesat.**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit;
- paraqet thyesat si pjesë të tërësisë;
- dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier;
- identifikon thyesat e barabarta;
- thjeshton thyesat;
- shndërron thyesat e parregullta në numra të përzierë dhe anasjelltas;
- cakton pjesën e dhënë të tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa;
- paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik);
- krahason thyesat duke shfrytëzuar boshtin numerik, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale;
- kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin);
- zgjidh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku.**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.  
Realizohet vlerësim i shokut nga shoku.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shprehjen e thyesës si herës të dy madhësive, në dallimin e thyesave të rregullta dhe jo të rregullta, kthimin e thyesa jo të rregullta në numra të përzierë, thyesat e anasjella, vendosja e thyesës në boshtin numerik, thjeshtimin e thyesës, kryerjen e veprimit të mbledhjes, zbritje, shumëzimit dhe pjesëtimit me numrat thyesor, thjeshtimin e thyesës, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

# ▼TEMA 5

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Figurat gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon shumëkëndëshin, sipërfaqen shumëkëndëshe, shumëkëndëshin e rregullt.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijës.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Shumëkëndëshat

FJALËT KYÇE: brinjë, kënde, kulme, diagonale, shumëkëndësh

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon shumëkëndëshat duke i komentuar vizatimet e tyre;
- dallon llojet e shumëkëndëshave duke u bazuar në numrin e brinjëve;
- emërton elementet e shumëkëndëshave duke i vizatuar ata;
- argumenton se këto forma kanë shumë zbatim në jetën reale duke përmendur objekte të ndryshme që i rrethojnë e që kanë formë shumëkëndëshe.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4, litar, lap-top

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma shumëkëndëshe.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grup

Mësuesi/ja fton pesë nxënës të dalin te tabela. U jep një litar, fijen e të cilit do ta kalojnë te njëri-tjetri duke formuar një vijë të thyer të mbyllur. Me gishtat e tyre formojnë kulmet e shumëkëndëshit. Mësuesi/ja pyet:

- Cila figurë gjeometrike u formua?
- Nëse shtojmë dhe një nxënës në vijën e thyer të mbyllur që kanë formuar, cila figurë do të fitohet?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela T

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore përkatësisht rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Duke lexuar, ata do të nënvizojnë konceptet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me shumëkëndëshat. Në grup do të bashkëbisedojnë për pjesën që lexuan dhe do të plotësojnë tabelën.

<i>Pyetje</i>	<i>Përgjigje</i>
1. Ç'është shumëkëndëshi?	
2. Cili është lloji më i thjeshtë i shumëkëndëshave?	
3. Si emërtohen shumëkëndëshat?	
4. Çka quajmë shumëkëndësh të rregullt?	
5. ....	
6. ....	
7. ....	

Një nxënës vizaton në tabelë, dhe një tjetër përmes programit GEOGEBRA, disa lloje të shumëkëndëshave. Përgjigjet që nxënësit japin nga tabela e plotësuar paraprakisht, i konkretizojnë me figurat e vizatuara.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga një fletë A4 ku janë të vizatuar shumëkëndësha të ndryshëm. Nxënësit udhëzohen të gjejnë elementet e shumëkëndëshave të dhënë, të vizatojnë diagonalet e t'i emërtojnë shumëkëndëshat. Kërkohet që duke i matur brinjët të njehsojnë perimetrin e figurave të dhëna dhe në fund, për secilin shumëkëndësh të gjejnë një shembull në klasë apo në ambientin ku jetojnë me formë përkatëse.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për çdo pyetje që bëjnë, për çdo përgjigje që japin dhe punën në grupe. Do të vlerësohen edhe për shembujt me të cilët do të konkretizojnë shumëkëndëshat.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon trekëndëshin, sipërfaqen trekëndëshe, elementet dhe llojet;

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.1 Identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme, klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Trekëndëshat*

**FJALËT KYÇE:** brinjë, kënde, kulme, trekëndësh

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon trekëndëshat duke i komentuar vizatimet dhe punimet e tyre me shufra;
- dallon llojet e trekëndëshave bazuar në gjatësinë e brinjëve dhe masës së këndeve;
- analizon vetitë e trekëndëshave duke i konkretizuar me shembuj të formave trekëndëshe në ambientet që i rrethojnë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4, shufra të punuara nga letra

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma trekëndëshe.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grupe**

Mësuesi/ja shpërndanë në secilin grup nga dy shufra (mund të jenë nga letra, druri, plastike ose materiale të tjera ricikluese p.sh. shkopinj akulloresh).

- A mund të krijoni një vijë të thyer të mbyllur me dy brinjë me dy shufra? Pse ?  
Shton në secilin grup edhe nga një shufër.
- Po tani a mund të krijoni një vijë të thyer të mbyllur me këto tri shufra?
- Çfarë shumëkëndëshi formuat?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Ndërthurja II**

Mësuesi/ja formon grupet me nga 5 nxënës dhe secilit i cakton një numër nga 1 deri në 5. Formohen grupe të reja sipas numrave përkatës të nxënësve. Njëshat në një grup, dyshat në grup tjetër e kështu me radhë. Mësuesi/ja shpërndanë në secilin grup tiketat me pyetje.

**Gr. I**

- Përkufizo trekëndëshin.
- Vizato një trekëndësh.
- Emërto elementet e trekëndëshit.
- Çështë sipërfaqja e trekëndëshit.
- Konkretizoni karakteristikat me ndonjë formë trekëndëshe në ambientin që ju rrethon.

**Gr. II**

- Numëroni llojet e trekëndëshave sipas gjatësive të brinjëve.
- Përshkruani karakteristikat e tyre.
- Vizatoni të tria llojet e trekëndëshave sipas gjatësive të brinjëve.
- Konkretizoni karakteristikat me ndonjë formë trekëndëshe në ambientin që ju rrethon.

**Gr. III**

- Numëroni llojet e trekëndëshave sipas masës së këndeve.
- Përshkruani karakteristikat e tyre.
- Vizatoni të tria llojet e trekëndëshave sipas masës së këndeve.
- Konkretizoni karakteristikat me ndonjë formë trekëndëshe në ambientin që ju rrethon.

**Gr. IV**

- Vizato një trekëndësh kënddrejtë.
- Përshkruani veçoritë e tij.
- Konkretizoni karakteristikat me ndonjë formë trekëndëshe në ambientin që ju rrethon.

**Gr. V**

- Numëro vetitë e trekëndëshave.

- Analizo secilën veç e veç.
- Konkretizoni karakteristikat me ndonjë formë trekëndëshe në ambientin që ju rrethon.

Nxënësit në grupet e ekspertëve u përgjigjen pyetjeve dhe detyrave përkatëse dhe kthehen në grupet amë. Në grupet amë, ata kanë për detyrë që të përgjigjen para shokëve/shoqeve në pyetjet për të cilat u përgjigjen në grupet e ekspertëve.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që duke komentuar dhe bashkëbiseduar në grup të zgjidhin detyrat e rubrikës “Ushtrime”. Disa nxënës nga grupe të ndryshme prezantojnë para klasës përgjigjet dhe zgjidhjet e detyrave.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe. Do të vlerësohen për përgjigjet në pyetjet e grupeve të ekspertëve dhe për shembujt me të cilat do të konkretizojnë trekëndëshat.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

### **Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet, vetitë e tyre.

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.1 Identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme, klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Katërkëndëshi. Trapezi. Paralelogrami*

FJALËT KYÇE: brinjë, kënde, kulme, katërkëndësh

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon katërkëndëshin, paralelogramin dhe trapezin;
- dallon veçoritë dhe të përbashkëtat e figurave të mësuara përmes diagramit të Venit;
- analizon vetitë e katërkëndëshave; trapezit dhe paralelogramit duke bërë pyetje dhe përgjigjur me saktësi.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat e gjeometrisë

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma katërkëndëshe.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: DI/DUA TË DI/MËSOVA**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të vizitojnë nga një katërkëndësh të çfarëdoshëm dhe të shkruajnë në kolonën DI, çfarë dinë për katërkëndëshat.

Pasi plotësojnë kolonën DI dhe të lexojnë mendimet që kanë dhënë u kërkohet të plotësojnë kolonën DUA TË DI duke shtruar pyetje se çfarë duan të dinë më shumë për katërkëndëshat.

Të dy kolonat e para i plotëson në tabelë edhe mësuesi/ja, duke marrë mendimet dhe pyetjet nga nxënësit/et.

**Ndërtimi i njohurive të reja: DI/DUA TË DI/MËSOVA**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Gjatë leximit, ata do të gjejnë përgjigjet për pyetjet që kanë bërë në rubrikën DUA TË DI.


Ata plotësojnë kolonën e fundit MËSOVA duke iu përgjigjur pyetjeve. Këtë kolonë do ta plotësojnë me informacione të reja edhe në qoftë se nuk është bërë pyetje për to.

Mësuesi/ja plotëson kolonën e tretë duke marrë përgjigjet nga nxënësit dhe duke i diskutuar bashkë me ta. Nëse ka mbetur ndonjë pyetje pa përgjigje nga kolona e dytë, ai/ajo do të përgjigjet ose i mbetet nxënësve të hulumtojnë dhe të gjejnë përgjigjen.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Katërkëndëshi ka katër brinjë. . . .	Çfarë quajmë katërkëndësh? . . .	Shumëkëndëshi që ka katër brinjë quhet katërkëndësh. . . .

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që duke komentuar dhe bashkëbiseduar në grup të gjejnë të përbashkëtat dhe veçoritë e paralelogramit dhe trapezit.



### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe. Do të vlerësohen për pyetjet e shtruar dhe përgjigjet e dhëna, analizën që u bëjnë figurave të mësuara.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet, vetitë e tyre.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.2 Kryen matje për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.1 Identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme, klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Drejtkëndëshi, rombi, katrori

**FJALËT KYÇE:** brinjë, kënde, kulme, diagonale

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon drejtkëndëshin, rombin, katrorin dhe romboidin;
- numëron karakteristikat për secilën nga figurat duke i krahasuar ato;
- analizon vetitë e drejtkëndëshit, rombit, katrorit dhe romboidit duke i kategorizuar ato.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat e vizatimit

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**


Jeta dhe puna

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma drejtkëndëshe, katrore...

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Kllaster

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shkruajnë në mes të fletës fjalën katërkëndësh dhe të degëzojnë njohuritë që kanë për të.



### Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Rubrika është ndarë në tri pjesë dhe pas çdo pjese, nxënësit do të ndalojnë së lexuari e mësuesi/ja do të bëjë pyetje.

Pyetjet për ndalesën e parë:

- Cili paralelogram quhet drejtkëndësh?
- Cilat janë vetitë e veçanta të drejtkëndëshit?
- Vizatoni në fletore një drejtkëndësh.

Pyetjet për ndalesën e dytë:

- Çfarë quajmë romb?
- Cilat janë vetitë e veçanta të rombit?
- Vizatoni në fletore një romb.

Pyetjet për ndalesën e tretë:

- Cili paralelogram quhet katror?
- Cilat janë vetitë që e dallojnë katrorin nga rombi?
- Po vetitë që e dallojnë nga drejtkëndëshi?
- Vizatoni në fletore një katror.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtimi kategorizues

Nxënësit do të udhëzohen të plotësojnë tabelën në mënyrë të pavarur e mandej t'i koordinojnë përgjigjet në grup.

	Trapezi	Drejtkëndëshi	Rombi	Katrori
Këndet				
Brinjët				
Diagonalet				

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe. Do të vlerësohen për përgjigjet e dhëna dhe analizën që u bëjnë figurave të mësuara.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezen, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe sipërfaqen rrethore.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

6.1 Identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme, klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrethi dhe elementet e tij

FJALËT KYÇE: qendër, rreze, rreth

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon rrethin duke vizatuar atë sipas të dhënave;
- dallon elementet e rrethit duke i emërtuar secilën në rreth;
- analizon rrethin përmes pyetjeve të shtruara në kub;
- vlerëson rrethin si një ndër figurat më të përdorshme në jetën reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, kubi, veglat e gjeometrisë

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma rrethore.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Bashkëbisedim

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vizatojnë me kompas një rreth në fletoren e tyre. Ai/ajo vizaton

gjithashtu një rreth në tabelë duke bashkëbiseduar me nxënësit.

- Ç'ju duhej të dinit për të vizatuar rrethin?
- Provo të emërtosh brinjët, këndet dhe kulmet e rrethit, nëse mund t'i identifikosh.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në rubrikën **“Vrojtoni dhe mësoni”** dhe të gjitha elementet e rrethit të sqaruara në tekst t'i përcaktojnë te rrethi i vizatuar më parë duke i diskutuar në grup.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kubimi**

Mësuesi/ja merr në dorë një kub në faqet e të cilit ka shkruar nga një kërkesë. Ai/ajo udhëzon nxënësit që në grupe duke iu përgjigjur gjashtë kërkesave të faqeve të kubit të përmbledhin njohuritë që morën për rrethin.

Gjashtë kërkesat e kubit (në rastin tonë për rrethin) janë:

- ✓ Përshkruaje atë (cila është forma, elementet e rrethit?)
- ✓ Krahasoje atë (me kë ngjason, nga se ndryshon?)
- ✓ Shoqëroje atë (çfarë ju bën të mendoni, çfarë ju vjen në mendje?)
- ✓ Analizojë atë (si është ndërtuar? Vizatojeni atë)
- ✓ Zbatoje atë (ç'mund të bëni me të, si mund të përdoret?)
- ✓ Arsyeto pro ose kundër (merr një qëndrim, ia vlen ta mësoni, ta përdorni, iu pëlqen etj.)

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe. Ata do të vlerësohen për vizatimin e saktë të rrethit dhe analizës që do t'i bëjnë atij.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Konstrukton: trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtëkëndëshin e rregullt.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.5 Konstrukton dhe ndërton figura gjeometrike mbi bazën e elementeve të dhëna.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Ndërtimi i disa shumëkëndëshave me vizore dhe kompas*

**FJALËT KYÇE:** konstruktiv, vizore, kompas, programi Geogebra

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- ndërton figurat gjeometrike duke përdorur vizore dhe kompas;
- analizon format e ndërtimit me vizore dhe kompas dhe me Geogebra;
- analizon të dhënat algjebrike që duhet futur në programin Geogebra për të konstruktuar secilën nga figurat gjeometrike të mësuara.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, veglat e gjeometrisë, lap-top, tangram

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna, Përdorimi i teknologjisë për të konstruktuar figurat duke kombinuar të dhënat algjebrike me pjesën gjeometrike në programin GEOGEBRA

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Aktivitet në grup (Tangram)

Mësuesi/ja shpërndanë pjesët e tangramit (forma shumëkëndëshe) në secilin grup dhe udhëzon nxënësit që nga pjesët shumëkëndëshe të formojnë një katror.



### Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Mësuesi/ja ndanë nxënësit në grupe me nga katër vetë. Cakton numrat për secilin në grupe nga 1 deri 4 dhe i udhëzon të lexojnë pjesën përkatëse në njësinë mësimore në rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Ata nxënës që kanë numrin 1 do të lexojnë dhe do të kenë përgjegjësinë t’ju shpjegojnë tre të tjerëve në grup ndërtimin e **rombit**. Nxënësit me numrin 2 do të shpjegojnë ndërtimin e **deltoidit**. Nxënësit me numrat 3 do të shpjegojnë ndërtimin e **trekëndëshit barabrinjës**, ndërsa ata me numër 4 ndërtimin e **gjashtëkëndëshit të rregullt**.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Konstruktive duke përdorur Teknologjinë

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të konstruktojnë figurat e mësuara duke përdorur programin GEOGEBRA. Ata do të ndërtojnë duke bashkëpunuar në grup trekëndëshin barabrinjës, rombin, deltoidin, gjashtëkëndëshin e rregullt duke futur të dhënat algjebrike që duhen për secilën figurë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe. Ata do të vlerësohen për konstruktimin e figurave duke përdorur teknologjinë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon trekëndëshin, elementet dhe llojet e tyre.
- Klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve.
- Cakton shumën e këndeve të një trekëndëshi.
- Përkufizon shumëkëndëshin dhe shumëkëndëshin e rregullt.
- Përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet dhe vetitë e tyre.
- Ndërton trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtëkëndëshin e rregullt.
- Njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) gjeometrike.
- Përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezen, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe qarkun.
- Vizaton rrethin kur jepet rrezja dhe diametri.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Çfarë mësuam (përsëritje)

**FJALËT KYÇE:** shumëkëndëshat, të rregullt, trekëndëshi, llojet e trekëndëshit sipas këndeve dhe brinjëve, shuma e këndeve të trekëndëshit, paralelogrami, drejtkëndëshi, katrori, rombi, vetitë e tyre, perimetër, rreth, qendër, rreze, diametër, sekante, tangjente, sipërfaqe shumëkëndëshe, sipërfaqe rrethore

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon trekëndëshin, elementet dhe llojet e tyre;

- klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve;
- cakton shumën e këndeve të një trekëndëshi;
- përkufizon shumëkëndëshin dhe shumëkëndëshin e rregullt;
- përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet dhe vetitë e tyre;
- ndërton trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtëkëndëshin e rregullt;
- njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) gjeometrike;
- përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezen, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe qarkun;
- vizaton rrethin kur jepet rrezja dhe diametri.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**

Nxiten nxënësit/et të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuam:	Provoni të zgjidhni.
se kur një figurë gjeometrike quhet shumëkëndësh; kur një shumëkëndësh është i rregullt;	1. Vizatoni një pesëkëndësh. Emërtoni kulmet. Tregoni brinjët, këndet dhe diagonalet e tij. Bëni matjet e nevojshme për të njehsuar perimetrin e tij.
kur një shumëkëndësh është trekëndëshi; cilat janë veti e tij.	2. Sa është numri më i vogël i brinjëve që mund të ketë një shumëkëndësh? Argumentoni përgjigjen 3. Vizatoni një trekëndësh. Emërtoni kulmet. Tregoni brinjët dhe këndet e tij.
si klasifikohen trekëndëshat sipas a) llojit të këndeve; b) llojit të brinjëve.	4. A mund të ketë trekëndësh: a) me brinjë 3 cm; 4 cm; 8 cm. b) me një kënd të gjerë e një kënd të drejtë
.....	.....
.....	.....

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Udhëzohen nxënësit/et të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në tregimin e elementeve të një shumëkëndëshi, klasifikimin e trekëndëshave sipas këndeve dhe brinjëve, listimin e vetive të paralelogramit, drejtkëndëshit,

rombit dhe katrorit, konstruktimin e tyre, përcaktimin e saktë të elementeve të rrethit, konstruktimi i tij, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Figurat gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon trekëndëshin, elementet dhe llojet e tyre.
- Klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve.
- Cakton shumën e këndeve të një trekëndëshi.
- Përkufizon shumëkëndëshin dhe shumëkëndëshin e rregullt.
- Përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet dhe vetitë e tyre.
- Ndërton trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtëkëndëshin e rregullt.
- Njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) gjeometrike.
- Përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezën, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe qarkun.
- Vizaton rrethin kur jepet rrezja dhe diametri.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Vlerësim

**FJALËT KYÇE:** shumëkëndëshat, të rregullt, trekëndëshi, llojet e trekëndëshit sipas këndeve dhe brinjëve, shuma e këndeve të trekëndëshit, paralelogrami, drejtkëndëshi, katrori, rombi, vetitë e tyre, perimetër, rreth, qendër, rreze, diametër, sekante, tangjente, sipërfaqe shumëkëndëshe, sipërfaqe rrethore.

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon trekëndëshin, elementet dhe llojet e tyre;
- klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve;
- cakton shumën e këndeve të një trekëndëshi;
- përkufizon shumëkëndëshin dhe shumëkëndëshin e rregullt;
- përkufizon paralelogramet dhe identifikon llojet dhe vetitë e tyre;
- ndërton trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtëkëndëshin e rregullt;
- njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) gjeometrike;
- përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezen, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe qarkun;
- vizaton rrethin kur jepet rrezja dhe diametri.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

Realizohet vlerësim i shokut nga shoku.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në tregimin e elementeve të një shumëkëndëshi, klasifikimin e trekëndëshave sipas këndeve dhe brinjëve, listimin e vetive të paralelogramit, drejtkëndëshit,

rombit dhe katrorit, konstruktimin e tyre, përcaktimin e saktë të elementeve të rrethit, konstruktimi i tij, në zgjidhjen e situatave problemore me shembuj nga veprimtaria e përditshme praktike. Argumentimin e veprimeve të kryera.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ◃TEMA 6

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1000 ...).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Kuptimi i numrit dhjetorë*

**FJALËT KYÇE:** numër dhjetorë, thyesë dhjetore, presje dhjetore

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- kthen thyesat e dhëna në thyesa me emërues 10, 100, ...;
- përkufizon numrin dhjetorë duke thënë rregullën;
- cakton numrat dhjetorë në drejtëzën numerike;
- zbaton numrat dhjetorë në situata jetësore duke dhënë shembuj.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shembuj nga jeta e përditshme

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që në grupe të punojnë për të zgjidhur detyrën e dhënë në rubrikën e parë të mësimit:

Janë dhënë thyesat:  $\frac{7}{2}$ ;  $\frac{4}{25}$ ;  $\frac{3}{4}$

- A mund t'i ktheni këto thyesa në emërues 10 ose 100? Si?

Nxënësit/et nga secili grup japin zgjidhjet dhe arsyetimin si e kanë gjetur zgjidhjen dhe mësuesi/ja i shkruan zgjidhjet në tabelë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i avancuar

Mësuesi/ja njofton nxënësit me njësinë e re dhe jep shembullin për të diskutuar.

Në kampionatin evropian të atletikës (Barcelonë, 2010), tri atletet që zunë vendet e para në garën e vrapimit 400 m shënuan këto kohë:

49 sekonda e  $\frac{89}{100}$  sek; 49 sek e  $\frac{92}{100}$  sek; 50 sek e  $\frac{10}{100}$  sek.

Në tabelën elektronike, ku jepeshin rezultatet, dolën këto shënime:

E para: 49,89 sek; E dyta: 49,92 sek; E treta: 50,10 sek.

Mësuesi/ja ju jep shkurt një leksion rreth numrave me presje dhe u kërkon nxënësve të punojnë në grupe tre shembujt e parë të rubrika “**Mbani mend**”. Shembujt do të diskutohen me klasën duke bërë pyetjet:

- Cilët numra quhen numra dhjetorë?
- Përshkruani lidhjen në mes numrave dhjetorë dhe atyre thyesorë.
- Ktheni thyesat dhjetore  $\frac{12}{10}$ ,  $\frac{247}{100}$ ,  $4\frac{21}{1000}$  në numra dhjetorë.

- Shpjegoni:

$$\begin{array}{ccc} \frac{4}{10} = 0,4 & & \frac{325}{100} = 3,25 \\ \uparrow \quad \uparrow & & \uparrow \quad \uparrow \end{array}$$

1 zero 1 shifër      2 zero 2 shifra

- Vendosni në drejtëzën numerike numrat 0,4 dhe 3,7.
- Jepni disa shembuj nga jeta e përditshme ka do t'i përdorni numrat dhjetorë.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zgjidhin në grupe detyrat e rubrikës “**Ushtrohuni duke zbatuar**”. Detyrat e zgjidhura do t'i shkëmbejnë me grupin fqinj për të vlerësuar. Vlerësimin do ta bëjnë duke përdorë simbolet ☺ ☹.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënimit në bashkëpunim në grupe, për saktësinë në përgjigjet që japin. Në fund të orës mësimore kemi vlerësim të ndërsjellë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Shkruan, lexon, cakton vend-vlerat e shifrave, rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

3.3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vendvlerat e shifrave të numri dhjetor

**FJALËT KYÇE:** numër dhjetorë, vendvlerë, pjesë e plotë, pjesë dhjetore

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon pjesët e një numri natyrorë duke shkruar dhe lexuar atë;
- emërton vendvlerën e secilës shifër të një numri dhjetorë duke u bazuar në pjesën e plotë dhe atë dhjetore të numrit;
- arsyeton rëndësinë e vendvlerës së zeros të një numër dhjetorë duke dhënë sqarimin përmes shembujve 5,0; 4,30; 4,03;
- zbaton numrat dhjetorë në situata jetësore duke dhënë shembuj.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shembuj nga jeta e përditshme

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikim me termat paraprakë**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që duke përdorur katër termat numër dhjetorë, presje, pjesë e plotë dhe pjesë dhjetore, të shkruajnë një apo dy fjali që përkufizojnë numrat dhjetorë.

Disa nxënës lexojnë fjalitë që kanë shkruar.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa**

Mësuesi/j udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin të rubrika “Vrojtoni dhe mësoni”, të cilën paraprakisht e ka ndarë në tri pjesë. Në secilën ndalesë ai/ajo bënë pyetje për pjesën e lexuar.

Pyetjet për pjesën e parë:

- Si ndahen pjesët e një numri dhjetorë?
- Dallo këto pjesë të numri 24, 35?
- Emërto vendvlerën e secilës shifër.

Pyetjet për pjesën e dytë:

Pjesa e plotë		Pjesa dhjetore	
Dhjetëshe	Njëshe	Të dhjeta $\left(\frac{1}{10}\right)$	Të qindta $\left(\frac{1}{100}\right)$
2	4	3	5

- Si lexohet numri i dhënë në tabelë? Komentoni shembullin.

Pyetjet për pjesën e tretë:

- Si shkruhet ndryshe numri i dhënë, sipas vendvlerave të tij?
- Shpjegoni rëndësinë e zeros pavarësisht nga vendvlera.
- Jepni sqarimin përmes shembujve 5,0; 4,30; 4,03.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zgjidhin në grupe detyrat e rubrikës “Ushtrohuni duke zbatuar”. Detyrat e zgjidhura do t’i zgjidhin me radhë disa nxënës në tabelë dhe do t’i komentojnë me klasën.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, për saktësinë në përgjigjet që japin. Në fund të orës, mësuesi/ja kërkon që nxënësit përmes shenjave të semaforit të vlerësojnë të nxënësit e njësisë mësimore.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjellas

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

2.1 Klasifikoi numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Krahasimi i numrave dhjetorë*

FJALËT KYÇE: **numër dhjetorë, vendvlerë, më i madh, më i vogël**

### Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- krahason numrat dhjetorë duke i shkruar ata si thyesa dhjetore;
- radhit numrat dhjetorë sipas radhës rritëse ose zvogëluese duke i krahasuar shifrat e të njëjtit rend;
- zbaton krahasimin e numrave dhjetorë në situata jetësore duke marr shembuj nga përditshmëria (p.sh. paratë, peshat, temperaturën, kohën etj.).

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A6

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme sidomos puna me para (euro, cent)

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të punojnë për të zgjidhur detyrën e dhënë në libër. Gjatësia e një gjinkalle është midis 1 cm dhe 2 cm.

- Jepni 5 numra që mund të shprehin gjatësinë e një gjinkalle.
- Radhitini ata nga më i vogli te më i madhi.

Përgjigjet e nxënësve, ai/ajo i shkruan në tabelë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe

Mësuesi/ja njofton nxënësit me njësinë e re dhe jep shembullin për të diskutuar.

- Krahasoni numrat dhjetorë 2,34 me 2,4 dhe 4,31 dhe 4,37.

Kërkon nga nxënësit që në dyshe të punojnë për të zgjidhur detyrën në dy mënyra. Njëri nga nxënësit do ta lexojë dhe zgjidhë mënyrën e parë, e tjetri mënyrën e dytë. Pasi të kenë lexuar, do t'i shpjegojnë njëri-tjetrit.

- Krahasimi duke i shkruar numrat dhjetorë si thyesa dhjetore.

$$2,34 = \frac{234}{100} \text{ dhe } 2,40 = \frac{240}{100} .$$

- Krahasimi duke krahasuar shifrat e të njëjtit rend.

4,31 dhe 4,37 kemi  $4 = 4$  dhe  $3 = 3$ , por  $1 < 7$ . Prandaj  $4,31 < 4,37$

Disa nxënës do të zgjidhin në tabelë detyrat duke zbatuar dy mënyrat për krahasimin e numrave dhjetorë.

Krahasoni numrat dhjetorë: a) 1,5 ... 1,8; b) 12,43 ... 12,4; c) 15,23 ... 15,3; d) 85,6 ... 85,06.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Teli për tharje

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga 10 fletë A6 ku në secilën fletë është shkruar nga një numër dhjetorë. Kërkon që të diskutojnë në grup dhe të dalin t'i radhisin numrat e dhënë

në “Telin për tharje” duke filluar nga numri më i vogël te më i madhi. Secili grup prezanton radhitjen e bërë në telin e tharjes.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, për saktësinë në përgjigjet që japin dhe kreativitetin e prezantuar në telin për tharje.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësist udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave dhjetorë.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë

**FJALËT KYÇE: numër dhjetorë, mbledhje, zbritje, presja dhjetore****Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- mbledh dhe zbret numrat dhjetorë duke i shkruar ata si thyesa dhjetore;
- mbledh dhe zbret numrat dhjetorë duke zbatuar rregullat e duhura për të gjetur shumën dhe ndryshimin;
- zbaton mbledhjen dhe zbritjen e numrave dhjetorë në situata jetësore duke marr shembuj nga përditshmëria (p.sh. paratë, peshat, temperaturën, kohën etj.).

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, Fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme sidomos puna me para(euro, cent)

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të punojnë për të zgjidhur detyrën e dhënë në libër.

Gjatë shetitjes me biçikletë, Era bëri  $5\frac{3}{10}$  km, pushoi 10 minuta, dhe më pas përshkoi  $4\frac{5}{10}$  km.

- Sa km bëri Era?
- Si do të veproni për të zgjidhur problemin?
- Po nëse të dhënat e mësipërme do t'i kthenit në numra dhjetorë, a do ta kishit më të lehtë?

Mësuesi/ja merr përgjigjet nga disa nxënës dhe i shkruan në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe, Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja njofton nxënësit me njësinë e re dhe jep shembullin për të diskutuar.

Gjeni shumën  $3,7 + 2,65$  dhe ndryshimin  $3,7 - 2,65$ 

Për të gjetur shumën apo ndryshimin e dy numrave dhjetorë mund të veprojmë në dy mënyra:

- Mënyra e parë: Shkruajini numrat dhjetorë si numra të përzier dhe më pas mbledhni ose zbritni ato.

$$3,7 + 2,65 = 3\frac{70}{100} + 2\frac{65}{100} = 5 + \left(\frac{70}{100} + \frac{65}{100}\right) = 5\frac{135}{100} = 6\frac{35}{100} = 6,35$$

- Mënyra e dytë: Në fillim, barazoni numrin e shifrave pas presjes dhjetore (duke shtuar zero djathtas, nëse është e nevojshme). Pastaj, mbledhni ose zbritni numrat dhjetorë në shtyllë.

Për të gjetur shumën  $3,7 + 2,65$  shkruani:

$$\begin{array}{r} 3,70 \\ + 2,65 \\ \hline 6,35 \end{array}$$

Për të gjetur ndryshimin  $3,7 - 2,65$  shkruani:

$$\begin{array}{r} 3,70 \\ - 2,65 \\ \hline 1,05 \end{array}$$

Nxënësit udhëzohen të lexojnë rubrikën “Mbani mend” ku do të kenë sqarimet mbi rregullat që duhet ndjekur për të gjetur shumën apo ndryshimin e dy numrave dhjetorë.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Gushëkuqi rrethor**

Mësuesi/ja kërkon nga secili grup që të zgjidhin detyrat e rubrikës “Ushtrime” duke bartë fletën e detyrave në qark brenda grupit. Detyrën e parë e zgjidhë nxënësi i parë dhe fletën e kalon te tjetri, derisa të përfundojnë të gjitha detyrat. Disa nga detyrat nxënësit do t'i zgjidhin në tabelë.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin duke i komentuar detyrat e zgjidhura nga secili brenda grupit.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë.

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Rrumbullakimi i numrave dhjetorë**

FJALËT KYÇE: numër dhjetorë, pjesë e plotë, pjesë dhjetore, rrumbullakim

**Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- rrumbullakon numrat dhjetorë në të plotën, të dhjetën dhe të qindtën më të afërt;
- përcakton afërsinë e numrave të dhënë dhjetorë me numrin e fituar pas rrumbullakimit;
- vlerëson rëndësinë e përafritimit, rrumbullakimit të numrave dhjetorë në shembuj nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme sidomos puna me para (euro, cent)

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të punojnë për të diskutuar shembullin e dhënë në libër.

A është e nevojshme të jemi kaq të saktë si në situatat e mëposhtme?

a) Syprina e një dhome është  $21,213 \text{ m}^2$ .

b) Shtatlartësia e Arbenit është  $145,4 \text{ cm}$ .

c) Rruga shtëpi-shkollë është  $354,7 \text{ m}$ .

Çfarë do të ishte më e përshtatshme të thuhej në këto raste? Diskutoni.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të diskutojnë në grup kërkesat në shembullin e dhënë në libër për të diskutuar më pas se si vepron për të rrumbullakuar numrat dhjetorë.

*Shembull*

Rrumbullakoni numrin  $3,827$ .

*Zgjidhje*

a) Rrumbullakimi në pjesën e plotë më të afërt:  $3,827 \approx 4$ .

b) Rrumbullakimi në të dhjetat më të afërta:  $3,827 \approx 3,8$ .

c) Rrumbullakimi në të qindtat më të afërta:  $3,827 \approx 3,83$ .

Nxënësit udhëzohen të lexojnë rubrikën “**Mbani mend**” ku do të kenë sqarimet mbi rregullat që duhet

ndjekur për të rrumbullakuar numrat dhjetorë varësisht nga vendvlera e kërkuar për rrumbullakim.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Stilolapsat në mes

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime” dhe mësuesi/ja nxjerrë në tabelë për të zgjidhur detyrat me radhë. Secili nxënës do të dalë në tabelë, varet se cilin laps do të përzgjedh mësuesi/ja. Nxënësi “pronarë” i lapsit të zgjedhur do të dalë në tabelë për të zgjidhur një detyrë. Mësuesi/ja do të veprojë kështu në secilin grup derisa të zgjidhin të gjitha detyrat që i kishin në grup.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin duke i komentuar detyrat e zgjidhura nga secili brenda grupit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë.
- Përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1000 etj.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyetohet përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.  
5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Shumëzimi i numrit dhjetorë**

FJALËT KYÇE: numër dhjetorë, shumëzim, prodhim

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- shumëzon numrin dhjetorë me një numër natyrorë duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për shumëzim dhe ato të veçantat për numrat dhjetorë;
- shumëzon numrin dhjetorë me numër dhjetorë duke shumëzuar numrat e dhënë dhe caktimin e presjes dhjetore sipas rregullës;
- shumëzon numrat dhjetorë me 10, 100, 1000... duke zbatuar rregullën e zhvendosjes së presjes dhjetore në të majtë;
- zbaton rregullat e shumëzimit të numrave dhjetorë në detyra nga situatat jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Shembuj nga jeta e përditshme

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të punojnë për të diskutuar shembullin e dhënë në libër.

Një parcelë ka formë katrori me brinjë  $20\frac{18}{100}$  m.

- Gjeni sa m tel duhen për të rrethuar këtë parcelë.
- Po nëse ktheni gjatësinë e brinjës në numër dhjetor, si do ta gjenit sa m tel duhen?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Ndërthurja I**

Nxënësit ndahen në grupe me nga 3 nxënës. Secilit i caktohet nga një numër nga 1-3. Mësuesi/ja u kërkon atyre të rigrupohen sipas numrave. Nxënësit që mbajnë numrin një në një grup, ata që mbajnë numrin dy në një grup dhe tre në një grup. U caktohen pjesët për të cilën ata do të jenë "ekspert".

- Grupi 1 "Shumëzimi i numrit dhjetorë me një numër natyrorë"

$$20,18 \cdot 4 = 80,72 \quad 2,81 \cdot 5 = 14,05$$

- Grupi 2 "Shumëzimi i një numri dhjetorë me numër dhjetorë"; dhe

18,5	2,74
• 0,6	• 1,3
-----	-----
1110	822
+ 000	+ 274
-----	-----
11,10	3562

- Grupi 3 “Shumëzimi i numrit dhjetorë me 10,100,100,...” .  
 $0,18 \cdot 10 = 1,8$      $5,347 \cdot 100 = 534,7$      $7,8 \cdot 1000 = 7800$

Pasi të kenë diskutuar dhe përgatitur mirë secili grup ekspertësh pjesën e vet do të kthehen në grupet fillestare dhe do t’u shpjegojnë të tjerëve secili pjesën e vet. Ata do t’i zgjidhin secili nga së paku dy detyra për grupin.

Tani që kanë marrë njohuritë e duhura për shumëzimin e numrit dhjetorë do t’i kthehen detyrës së dhënë në fillim për të vërtetuar se a është zgjidhur saktë detyra nga grupet.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Turi i galerisë

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime” në fletë A4. Detyrat e zgjidhura do t’i vendosin në tabelën e punimeve. Nga një nxënës nga secili grup bashkë me mësuesin/en vlerësojnë detyrat e ekspozuara.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin bashkë me mësuesin/en, duke i komentuar detyrat e zgjidhura nga secili grup.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrit dhjetorë me numër natyrorë**

FJALËT KYÇE: numër dhjetorë, numër natyrorë, pjesëtim, herës

**Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- pjesëton numrin dhjetorë me një numër natyrorë duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për shumëzim dhe ato të veçantat për numrat dhjetorë;
- pjesëton numrin dhjetorë me numër natyrorë duke e kthyer atë në thyes dhjetore dhe pastaj duke e shumëzuar me numrin natyrorë;
- zbaton rregullat e pjesëtimit të numrave dhjetorë në detyra nga situatat jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të diskutojnë shembullin e dhënë.

“Katër shoqe kishin kursyer së bashku ca para. Ditën që do të dilnin me klasën, ato vendosën t’i ndanin në mënyrë të barabartë. Sa para mori secila, nëse ato kishin 16,80 euro.”

Mësuesi/ja merr përgjigjet nga nxënësit dhe nuk jep vlerësimin se cila është përgjigja e saktë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Shembujt e dhënë në këtë rubrikë t’i zgjidhin duke u përqendruar në dy mënyrat për pjesëtimin e numrit dhjetorë me numër natyrorë.

Mënyra e parë: Kthimi i numrit dhjetorë në thyes dhjetore për ta pjesëtuar me numër natyrorë.

Mënyra e dytë: Pjesëtimi i numrit dhjetorë me numër natyrorë duke zbatuar rregullat e pjesëtimit. Pjesëtimi bëhet sikurse te numrat natyrorë. Kur gjatë pjesëtimit mbërrihet te presja dhjetore, atëherë shkruhet presja edhe te herësi dhe vazhdohet me pjesëtimin si më parë.

Përmes dy metodave do të zgjidhin detyrat e dhëna.

Beni bëri me biçikletë 2,25 km për 5 minuta, kurse Tani bëri 2,76 km për 8 minuta. Cili është më i shpejtë?

Një pìrg prej 10 000 fletësh letre është 89 cm i trashë. Sa mm është trashësia e 1 fije letre?

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime”. Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t'i zgjidhin disa nga nxënësit në tabelë duke i komentuar ato edhe me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë zgjidhur detyrat në tabelë në ditarin personal të mësuesit/es.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë.

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

***Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrit dhjetorë me numër natyrorë***

FJALËT KYÇE: numër dhjetorë, numër natyrorë, pjesëtim, herës

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- pjesëton numrin dhjetorë me një numër natyrorë duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për shumëzim dhe ato të veçantat për numrat dhjetorë;
- pjesëton numrin dhjetorë me numër natyrorë duke e kthyer atë në thyes dhjetore dhe pastaj duke e shumëzuar me numrin natyrorë;
- zbaton rregullat e pjesëtimit të numrave dhjetorë në detyra nga situatat jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në dyshe, me shokun/shoqen pranë të diskutojnë shembullin e dhënë.

Bëni pjesëtimin e numrit dhjetor 12,6 me numrin natyror 45. Më pas, përdorni rezultatin e arritur për të gjetur herësin e pjesëtimit të 12,6 me 4,5.

Merren mendimet e nxënësve se si kanë vepruar dhe shkruhen në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela T**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore, rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Pasi të kenë lexuar do të plotësojnë tabelën.

Detyra		Komentimi i mënyrës së zgjidhjes
1.	$12,6 : 4,5$  $126 : 45 = 2,8$ $\begin{array}{r} - 90 \\ 360 \\ - 360 \\ 000 \end{array}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shumëzojmë të dy numrat me 10, për t'i kthyer në numra natyrorë (herësi nuk ndryshon).</li> <li>- I pjesëtojmë numrat dhe fitojmë herësin 2,8.</li> </ul>
2.	$4,5 : 0,125$  $4500 : 125 = 36$ $\begin{array}{r} - 375 \\ \hline 750 \\ - 750 \\ \hline 000 \end{array}$	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvendoset presja dhjetore me 3 shifra djathtas tek i pjesëtueshmi dhe te pjesëtuesi (shumëzojmë më 1000).</li> <li>- Kryejmë pjesëtimin dhe fitojmë 36.</li> </ul>

Në tabelë para klasës do t'i zgjidhin nxënësit duke i komentuar zgjidhjet e detyrave. Mësuesi/ja u jep sqarime në qoftë se kanë nevojë.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës "Ushtrime". Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t'i zgjidhin disa nga nxënësit në tabelë duke i komentuar ato edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë zgjidhur detyrat në tabelë në ditarin personal të mësuesit/es.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdorur kalkulatorin.
- Identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjet matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Kthimi i thyesës së zakonshme në thyesë dhjetore. Përdorimi i makinës llogaritëse*

**FJALËT KYÇE:** numër dhjetorë, periodik, pjesëtim, herës

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- kthen thyesat në thyesa dhjetore duke i zgjeruar;
- kthen thyesat në numra dhjetorë duke pjesëtuar numëruesin me emëruesin e thyesës;
- përkufizon numrat dhjetorë periodik duke specifikuar periodën;
- përdorë kalkulatorin për të kthyer thyesat në numra dhjetorë;
- zbaton rregullat për fitimin e numrave dhjetorë në detyra nga situatat jetësore.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në dyshe (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në dyshe, me shokun/shoqen pranë të diskutojnë shembullin e dhënë.

Ktheni në thyesë dhjetore e pastaj në numër dhjetor, numrat thyesorë:

$$\frac{1}{2}; \frac{2}{5}; \frac{3}{20}.$$

- A mund të ktheni në thyesë dhjetore thyesën  $\frac{1}{3}$ ?
- Po thyesën  $\frac{2}{7}$ ?
- Tregoni pse?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Grupet e ekspertëve II**

Mësuesi/ja grupon nxënësit në grupe me nga katër veta. Secilit nxënës i cakton numrat nga 1-4. U kërkon nxënësve të rigrupohen sipas numrit të caktuar.

Nëpër grupet e ekspertëve nxënësit do të lexojnë pjesën e ndarë në libër që i takon numrit përkatës. Diskutimin brenda grupit të ekspertëve do ta orientojnë në gjetjen e përgjigjeve për pyetjet e dhëna në tiketa nga mësuesi/ja për secilin grup. Mësuesi/ja i këshillon që të përdorin kalkulatorin për llogaritje.

Grupi i parë: Janë dhënë thyesat  $\frac{7}{4}$ ,  $\frac{2}{5}$ ,  $\frac{3}{125}$ .

- Thyesat e dhëna kthejini në thyesa dhjetore dhe pastaj në numra dhjetorë.
- Shpjegoni veprimet për të ardhur deri te numri dhjetorë.

Grupi i dytë: Janë dhënë thyesat  $\frac{1}{3}$ ,  $\frac{3}{7}$ ,  $\frac{2}{9}$ .

- A mund t'i ktheni thyesat e dhëna në thyesa dhjetore? Pse
- Si do t'i ktheni në numra dhjetorë? Shpjegoni si.

Grupi i tretë: Janë dhënë thyesat  $\frac{1}{3}$ ,  $\frac{3}{7}$ ,  $\frac{2}{9}$ .

- Nëse i ktheni thyesat në numra dhjetorë çfarë numri fitohet?
- Si quhet shifra e cila përsëritet te pjesa dhjetore e herësit?

Grupi i katërt: Janë dhënë thyesat  $\frac{48}{7}$ ,  $\frac{37}{13}$ .

- Çfarë numri dhjetorë fitohet me pjesëtimin e numëruesit me emëruesin e thyesave?
- A është i saktë numri që fitohet në këtë pjesëtim?

Nxënësit kthehen në grupet amë dhe secili shpjegon për shokët/shoqet pjesën e përgatitur në grupet e ekspertëve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës "Ushtrime". Ata këshillohen që të përdorin makinën llogaritëse për të llogaritur. Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t'i zgjidhin disa nga nxënësit në tabelë duke i komentuar ato edhe me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë zgjidhur detyrat në tabelë në ditarin personal të mësuesit/es.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdorur kalkulatorin.
- Identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.1 Demonstron zbatimin e numrave racionalë në shprehje të ndryshme numerike dhe shkronjore.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Shprehje numerike me numra dhjetorë. Përdorimi i makinës llogaritëse*

**FJALËT KYÇE:** numër dhjetorë, shprehje numerike, radhë e veprimeve

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- njehson vlerën e shprehjeve numerike duke zbatuar radhën e veprimeve;
- përdor makinën llogaritëse për të llogaritur shumë, ndryshimin, prodhimin dhe herësin në detyrat e dhëna;
- zbaton radhën e veprimeve dhe llogaritjen e vlerës së shprehjes numerike në shembuj nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të zgjidhin detyrat e dhëna (për llogaritje të përdorin makinën llogaritëse).

a)  $36 : 5 + 12 \cdot 3,4 - 5,64$ ;

b)  $0,12 : 3 + (0,49 : 7 + 3 \cdot 0,6) \cdot (0,08 + 2,5 - 0,58)$ .

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që për të gjetur vlerën e shprehjeve numerike me numra dhjetorë, duhet respektuar radhën e veprimeve sikurse te numrat natyrorë.

Shembujt e dhënë do t'i zgjidhin duke komentuar radhën e veprimeve, ndërsa llogaritjet do t'i bëjnë me makinë llogaritëse.

Detyra (hapat e zgjidhjes)	Komenti i veprimeve
$36 : 5 + 12 \cdot 3,4 - 5,64 =$ $7,2 + 40,8 - 5,64 =$ $48 - 5,64 = 42,36$	<p>kryhet pjesëtimi dhe shumëzimi</p> <p>kryhet mbledhja dhe zbritja sipas radhës</p>
$0,12 : 3 + (0,49 : 7 + 3 \cdot 0,6) \cdot (0,08 + 2,5 - 0,58)$ $=$ $0,12 : 3 + (0,07 + 1,8) \cdot (2,58 - 0,58) =$ $0,12 : 3 + 1,87 \cdot 2 =$ $0,04 + 3,74 = 3,78$	<p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p>

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Ata këshillohen që të përdorin makinën llogaritëse për të llogaritur. Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t'i zgjidhin disa nga

nxënësit në tabelë duke i komentuar ato edhe me mësuesin/en.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë zgjidhur detyrat në tabelë në ditarin personal të mësuesit/es.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje.
- Llogarit përqindjen e numrave..

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.5 për zgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Kuptimi i përqindjes**

FJALËT KYÇE: **përqindje, thyesë dhjetore, numër dhjetorë**

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- kthen thyesat në numra dhjetorë dhe në përqindje;
- kthen numrat dhjetorë në thyesa dhe në përqindje;
- kthen përqindjen në numra dhjetorë dhe në thyesa;
- llogarit vlerën e përqindjes së një numri;
- zbaton përqindjen në shembuj të përditshmërisë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi, sport

Shembuj nga jeta e përditshme

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe (stuhi mendimesh)

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grupe të bashkëbisedojnë dhe t'u përgjigjen kërkesës.

- Për 2-3 minuta bëni një listë me emrat e vendeve ku e keni hasur shenjën %.
- Nxënësit japin idetë e tyre dhe mësuesi/ja liston përgjigjet e tyre në tabelë.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Nxënësit ftohen të lexojnë pjesën e mësimit “Vrojtoni dhe mësoni” duke u përqendruar në përkufizimin për përqindjen.

$\frac{12}{100}$  shënohet 12% dhe lexohet “12 për qind”.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në katërshe duke marrë secili prej tyre një detyrë.

Pastaj i shpjegojnë tre të tjerëve detyrën që kanë zgjidhur.

Detyra e parë: kthimi i thyesës në numër dhjetorë dhe në përqindje.

$$\frac{2}{5} = \frac{40}{100} = 0,4 = 40\%$$

Detyra e dytë: kthimi i numrit dhjetorë në thyes dhjetore dhe në përqindje.

$$1,73 = \frac{173}{100} = 173\%$$

Detyra e tretë: kthimi i përqindjes në thyes dhjetore dhe në numër dhjetorë.

$$25\% = \frac{25}{100} = \frac{1}{4} = 0,25$$

Detyra e katërt: llogaritja e vlerës së përqindjes së një numri.

$$15\% \text{ e } 200 = \frac{15}{100} \cdot 200 = \frac{15 \cdot 200}{100} = 30$$

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t’i zgjidhin disa nga nxënësit në tabelë duke i komentuar ato edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti për zgjidhjet e detyrave ku kërkohet zbatim i përqindjes në shembuj nga jeta e përditshme.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Llogarit përqindjen e numrave.
- Përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Zbatime të përqindjes**

FJALËT KYÇE: **përqindje, vlerë e përqindjes, tërësi**

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- gjen vlerën e përqindjes për çmimet e produkteve të ndryshme të ofruara me zbritje në përqindje;
- llogarit përqindjen duke e ditur tërësinë dhe vlerën e përqindjes;
- zbaton në shembuj nga përditshmëria llogaritjen e përqindjes, vlerës së përqindjes dhe tërësisë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletushkat e dyqaneve

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti

Shembuj nga jeta e përditshme

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe (stuhi mendimesh)**

Mësuesi/ja u shpërndanë nxënësve në grupe nga një fletushkë të reklamave të dyqaneve që ofrojnë produkte me zbritje. Në fletushka janë të dhëna çmimet e produkteve dhe zbritja e shprehur në përqindje.

Kërkon nga ata/ato që të llogarisin çmimin e disa produkteve pas zbritjes së vlerës së përqindjes së ofruar nga dyqani.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe**

Nxënësit ftohen të punojnë në grupe shembujt e dhënë në libër duke pasur parasysh hapat për zgjidhjen e problemave matematikore.

Lexojnë me vëmendje tekstin e detyrës.

Shkruajnë të dhënat nga detyra.

Zgjidhin problemën matematikore të dhënë me përqindje.

Vërtetojnë zgjidhjen duke bërë provën e detyrës.

“Në rrethin e matematikës bëjnë pjesë 7 nxënës, që përbëjnë 20% të nxënësve të klasës. Sa nxënës ka klasa?”

”Babai bleu një frigorifer. Ai pagoi në fillim 12% të çmimit dhe më pas pjesën që mbetej, që ishte 350 euro. Sa euro kushtoi frigoriferi?”

“Para dy vjetësh, fqinji im peshonte 89 kg. Me dietë dhe ushtrime fizike, tani ai ka arritur peshën

75,6 kg. Me sa për qind është zvogëluar pesha e tij?”

“Një filatelist (koleksionist pullash) ka 180 pulla shqiptare, që përbëjnë 30% të koleksionit të tij. Sa pulla ka ai në koleksion?”

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza e rrumbullakët**

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrimë”. Shumica e shembujve janë nga jeta reale dhe kërkohet që t’i diskutojnë duke i krahasuar me situatat jetësore që ata kanë pas në lidhje me përqindjen. Detyrat që kanë zgjidhur në grupe do t’i shkëmbejnë me grupin fqinjë për të vlerësuar njëri-tjetrin.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti për zgjidhjet e detyrave ku kërkohet zbatim i përqindjes në shembuj nga jeta e përditshme. Vlerësimi i ndërsjellë në fazën e fundit është me vlerë për të shkëmbyer përvojat e tyre.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### **Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1000 ...).
- Shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjellas.
- Shkruan, lexon, cakton vendvlerat e shifrave.
- Rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë.
- Përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1 000 etj.
- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit - të numrave dhjetorë.
- Kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdorur makinën llogaritëse.
- Identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë.
- Shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje.
- Llogarit përqindjen e numrave.
- Përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencat natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)**

**FJALËT KYÇE:** thyesat dhjetore, numrat dhjetorë të fundmë, të pafundmë, vendvlerat, veprimet aritmetike me numrat dhjetorë, përqindja

**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:**

Nxënësi/ja:

- përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1000 ...);
- shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjellas;
- shkruan, lexon, cakton vendvlerat e shifrave;
- rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë;
- përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1000 etj.;
- zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë;
- kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdor makinën llogaritëse;
- identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë;
- shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje;
- llogarit përqindjen e numrave;
- përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari dyfletësh**

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
kuptimin e thyesave dhjetore;	1. Shkruani pesë thyesa dhjetore.
si veprohet për të shkruar një thyesë dhjetore në numër dhjetor dhe anasjelltas;	2. Ktheni në thyesë dhjetore dhe shkruani pastaj si numër dhjetor. a) $\frac{7}{2}$ ; b) $\frac{3}{20}$ ; c) $\frac{5}{40}$ . 3. Shkruani si thyesë të zakonshme: 0,9; 0,123; 0,03; 0,007
vendvlerat e secilës shifër në numrin dhjetor;	4. Lexoni numrat dhjetorë. Tregoni vlerën e secilës shifër. a) 2,03      b) 13,004
rregullin e rrumbullakimit të numrave dhjetorë, të njëjtë me rrumbullakimin i numrave natyrorë.	5. Cili nga përafritmet është kryer saktë? Argumentoni. a) $0,36 \approx 0,4$ apo $0,36 \approx 0,3$ . b) $1,654 \approx 1,6$ apo $1,654 \approx 1,7$ . c) $3,834 \approx 3,83$ apo $3,834 \approx 3,84$ ?
.....	.....

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë në grupe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e kthimit të thyesave dhjetore në numra dhjetor dhe anasjelltas, përcaktimi i vendvlerave të shifrave të numri dhjetor, rrumbullakimin, krahasimin e numrave dhjetor, veprimet aritmetike me numrat dhjetor, kthimin e thyesës në numër dhjetor, të fundmë, të pafundmë, periodik, kuptimin e përqindjes, njësimin e saj, gjetjen e të tërës dhe të pjesës, zbatimin e njohurive në situata problemore dhe argumentimin e zgjidhjes së tyre.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat dhjetorë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1000 ...).
- Shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjellas.
- Shkruan, lexon, cakton vendvlerat e shifrave.
- Rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë.
- Përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1 000 etj.
- Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit - të numrave dhjetorë.
- Kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdor makinën llogaritëse.
- Identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë.
- Shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje.
- Llogarit përqindjen e numrave.
- Përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësim

**FJALËT KYÇE:** thyesat dhjetore, numrat dhjetorë të fundmë, të pafundmë, vendvlerat, veprimet aritmetike me numrat dhjetorë, përqindja

### Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1000 ...);
- shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjellas;

- shkruan, lexon, cakton vendvlerat e shifrave;
- rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë;
- përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1000 etj.;
- zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtimit të numrave dhjetorë;
- kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdor makinën llogaritëse;
- identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pafundmë periodikë;
- shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje;
- llogarit përqindjen e numrave;
- përcakton situatat jetësore ku përdoren numrat dhjetorë, numrat thyesorë dhe përqindjet.

### **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës. shoqëria dhe mjedisi

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e kthimit të thyesave dhjetore në numra dhjetor dhe anasjelltas, përcaktimi i vendvlerave të shifrave të numri dhjetor, rrumbullakimin, krahasimin e numrave dhjetor, veprimet aritmetike me numrat dhjetor, kthimin e thyesës në numër dhjetor, të fundmë, të pafundmë, periodik, kuptimin e përqindjes, njësimin e saj, gjetjen e të tërës dhe të pjesës, zbatimin e njohurive në situata problemore dhe argumentimin e zgjidhjes së tyre.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ◊TEMA 7

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Matje të madhësive geometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përdor njësitet dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret.
- Kryen matje të gjatësisë në situata problemore.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.3 Përdor matjet në figurat 2D ( $D = \text{dimensionale}$ ) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

4.2 Integron njohuritë e shprehjet matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Kuptimi për matjen. Matja e gjatësisë*

**FJALËT KYÇE:** matje, mjetet matëse, njësi matje, matje e gjatësisë

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- numëron disa mjete matëse që përdor në jetën e përditshme;
- përkufizon matjen bazuar në njësinë matëse të përzgjedhur;
- mat objekte përreth tij duke përdorur pjesë të trupit, si gjerësinë e gishtit tregues, madhësinë e pëllëmbës etj.;
- përcakton njësinë e matjes së gjatësisë së objekteve në jetën reale.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

matematika, fletore pune, mjete matëse: metër, vizore, termometër, peshore, orë etj.

### **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrë, gjeografia.

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së madhësive të ndryshme krahasuar me njësinë matëse.

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla. Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”. Të ndarë në grupe, secili prej tyre përzgjedh disa objekte që nxënësit kanë personalisht ose që ndodhen në mjediset e klasës. Sipas objektit nxënësit do të përzgjedhin pjesë të trupit për të matur përmasat e tyre: përmasat e librit të matematikës, të kuletës së bojërave, të bankës, të tabelës, të fletores të karriges etj.

Ftohen nxënësit të krahasojnë rezultatet e gjetura me ato të grupeve të tjera.

Secili grup ju përgjigjet pyetjeve:

- Cilën pjesë të trupit përdorët për të matur gjatësinë e prefësës së lapsave?
- Cilën pjesë të trupit përdorët për të matur gjatësinë e librit të matematikës?
- Cilën pjesë të trupit përdorët për të matur gjatësinë e tabelës?
- Cilën pjesë të trupit përdorët për të matur përmasat e klasës?

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Në bashkëbisedim me nxënësit tregohen disa mjete matëse dhe çfarë matet me to, duke ju referuar dhe figurave të tekstit në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

Nxiten nxënësit të tregojnë dhe mjete të tjera matëse që përdoren në veprimtarinë e përditshme, si dhe çfarë matit me to.

Tërhiqen nxënësit në diskutim rreth pyetjes: Çdo të thotë të matësh?

Si i përdorën pjesët e trupit, si gjerësinë e gishtit tregues, gjatësinë e pëllëmbës së dorës, gjatësinë e hapit në matjet që ata kryen në grupe.

Për të njëjtat objekte, rezultatet e grupeve të ndryshme a ishin të njëjta? Nëse jo plotësisht pse?

Po nëse përmasat e librit do të mateshin nga të gjithë grupet më vizoren e shkallëzuar, a do të kishim të njëjtin rezultat?

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grup**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar mes vete. Bashkëbisedohet për ushtrim 6 të tekstit ku me ndihmën e përmasave të kutisë së shkrepëses maten përmasa të objekteve të tjera në mjedisin rrethues të klasës.

Ju jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në përzgjedhjen e mjetit matës, si dhe njësisë matëse të përmasave të objekteve në jetën reale, përdorimi i pjesëve të trupit në gjetjen e gjetjen e përmasave të objekteve në mjedisin e klasës.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër.
- Këmben njësitë e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njësi të gjatësisë. Sistemi metrik

**FJALËT KYÇE:** njësitë e matjes së gjatësisë: km, m, cm, dm

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- tregon njësinë bazë të matjes së gjatësisë, shumëfishat dhe nënfishat e saj;
- shndërron nga njësia më e madhe te njësia më e vogël dhe anasjelltas duke përdorur numrat dhjetor;
- argumenton kalimet nga njësia më e madhe te më e vogla dhe anasjelltas;
- demonstroi zbatimin e njësive matëse në situata nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, mjete matëse: metër, vizore

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi.

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së madhësive të ndryshme krahasuar me njësinë matëse.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: DI/DUA TË DI/MËSOVA**

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”.

“Gjatësia e garës së maratonës është 42 195 m. Si mund të tregoni sa km e m është kjo garë?”

Iu jepet kohë të bashkëbisedojnë për zgjidhjen e situatës problemore.

Nxiten nxënësit/et të kujtojnë njësinë bazë të matjes së gjatësisë, shumëfishat dhe nënfishat e saj.

Duke kujtuar çfarë dinë, ata plotësojnë rubrikën “Di” dhe vazhdojnë të bëjnë pyetje për çfarë duan të dinë më shumë për to duke plotësuar rubrikën “DUA TË DI”.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim, “Di/Dua të di/Mësova”**

Në bashkëbisedim me nxënësit/et tregohet njësia themelore e matjes, shumëfishat dhe nënfishat e tij.

Di	Dua të di	Mësova
Cilat janë njësitë e matjes së gjatësisë: m njësia themelore dm, cm, mm nënfishat km shumëfish i metrit Të kaloj nga njësia më e madhe te më e vogla. .....	Si të kaloj nga njësia më e vogël te më e madhja?  .....	Të kaloj nga njësia më e vogël te më e madhja duke përdorur numrat dhjetor.  .....

Duke ditur që  $1\text{ m} = 10\text{ dm} = 100\text{ cm} = 1000\text{ mm}$ , nxiten nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve:

Ç'pjesë e m është cm, dm, mm?

Ç'pjesë e km është m?

Bashkëbisedohet rreth shembujve të zgjidhur në rubrikën “Vrojtani dhe mësoni”.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grup**

Ftohen nxënësit/et të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar mes tyre. Bashkëbisedohet për ushtrim 6 të tekstit ku nxënësit/et të tregojnë njësinë e gjatësisë së objekteve në jetën reale.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura në grup do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit/et për saktësinë në përgjigjet e dhëna në përzgjedhjen e mjetit matës, si dhenjësisë matëse të përmasave të objekteve në jetën reale, kalimin nga njësia më e madhe të njësia më e vogël dhe anasjelltas.

Argumentimi i veprimeve të kryera gjatë shndërrimeve nga një njësi në tjetrën.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësitet udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike**Rezultati i të nxënit të temës:**

- shndërron njësiti matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër;
- këmben njësiti e matjes (kg, g, km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;
- kryen matje të gjatësisë në situata problemore;

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyetohet përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencat natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Përdor matjet në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Veprime me njësitë e gjatësisë**

FJALËT KYÇE: **njësitë e matjes së gjatësisë: km, m, cm, dm, veprimet aritmetike me to**

**Rezultati/et e të nxënimit për orën mësimore**

- kryen veprimin e mbledhjen dhe zbritjes me njësitë e gjatësisë duke i kthyer në njësinë më të madhe ose në njësinë më të vogël;
- kryen veprimin e shumëzimit dhe të pjesëtimit të njësive të gjatësisë me numër natyror;
- argumenton veprimet e kryera gjatë shndërrimit të njësive duke kryer veprimet matematikore;
- demonstroi zbatimin e njohurive në situata nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, mjete matëse: metër, vizore

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së madhësive të ndryshme krahasuar me njësinë matëse.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla dyshe** Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”. Të gjejnë perimetrin e trekëndëshit të dhënë.

Kujtojnë si gjendet perimetri i një shumëkëndëshi?

Nxiten nxënësit/et të gjejnë perimetrin në mënyra të ndryshme.

Zgjidhja e situatës problemore paraqitet dhe në tabelë nga disa nxënës.

Bashkëbisedohet rreth përfundimeve.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim, punë në grupe**

Nga zgjidhja e situatës së rubrikës së parë do të diskutohet për të tria mënyrat e mbledhjes së njësive të gjatësisë:

Perimetri i trekëndëshit gjendet duke mbledhur gjatësitë e brinjëve:

4 cm 2 mm + 3 cm 6 mm + 5 cm 1 mm.

a) Gjejmë perimetrin duke i mbajtur njësitë siç janë.

4 cm 2 mm + 3 cm 6 mm + 5 cm 1 mm = 12 cm 9 mm

b) I kthejmë njësitë në njësinë më të vogël (mm).

4 cm 2 mm = 42 mm; 3 cm 6 mm = 36 mm; 5 cm 1 mm = 51 mm.

Gjejmë shumën: 42 mm + 36 mm + 51 mm = 129 mm.

c) I kthejmë njësitë në njësinë më të madhe.

$4\text{ cm } 2\text{ mm} = 4,2\text{ cm}$   $3\text{ cm } 6\text{ mm} = 3,6\text{ cm}$   $5\text{ cm } 1\text{ mm} = 5,1\text{ cm}$

Bëjmë mbledhjen:  $4,2\text{ cm} + 3,6\text{ cm} + 5,1\text{ cm} = 12,9\text{ cm}$ .

A janë njësoj të tria përfundimet?

Bashkëbisedohet rreth shembujve të zgjidhur në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

Si të zbresin njësitë e matjes po në tri mënyra, si t'i shumëzojnë dhe si t'i pjesëtojnë me numër natyrorë.

Grupeve iu caktohet një veprim 1. Të mbledhë. 2. Të zbrësë. 3. Të shumëzojë me numër natyror. 4. Të pjesëtojë me numër natyrorë.

Brenda grupit të kryejnë veprime në mënyra të ndryshme. Bashkëbisedojnë për rezultatin e fituar.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grup**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke i komentuar mes vete. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 të tekstit ku nxënësit argumentojnë zbatimin praktik të njohurive të mara.

Ju jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime” të ndarë në grupe. Ushtrimi 8 jep informacion për lartësitë reale të ndërtesave.

Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në kryerjen e veprimeve me njësitë e gjatësisë. Argumentimi i veprimeve të kryera gjatë shndërrimeve nga një njësi në tjetrën.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Njehson perimetrin e shumëkëndëshave, të katrorit; të drejtkëndëshit.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.  
6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Perimetrat e shumëkëndëshave

**FJALËT KYÇE:** shumëkëndësh, perimetër, formula për njësimin e perimetrit të katrorit, drejtkëndëshit.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- njehson perimetrin e një shumëkëndëshi çfarëdo;
- tregon formulën për njësimin e perimetrit të shumëkëndëshit të rregullt, katrorit dhe drejtkëndëshit;
- zbaton formulat në situata problemore për njësimin e perimetrit të një shumëkëndëshi;
- demonstroi zbatimin e njohurive për matjen e perimetrit në situata nga jeta reale;
- argumenton zgjidhjen detyrave që kanë të bëjnë me situatat problemore;

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, mjete matëse: metër, vizore

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrë

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së madhësive të ndryshme krahasuar me njësinë matëse.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla dyshe

Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”.

Situata e parë: Si do të njësojnë gjatësinë e vijës së thyer?

Situata e dytë: të gjejnë gjatësinë e telit që duhet për rrethuar kopshtin e kullotës në formë drejtkëndëshi.

Iu jepet kohë të punojnë në grup.

Bashkëbisedohet për zgjidhjen e situatave.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim, punë në grupe

Nga bashkëbisedimi për zgjidhjen e situatave të mësipërme, nxënësit iu përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë matjesh duhet të kryejmë për të gjetur gjatësinë e vijës së thyer? Sa është kjo gjatësi?

- Sa është perimetri i një shumëkëndëshi çfarëdo?

- Për të gjetur gjatësinë e telit që nevojitet për rrethimin e kullotës, çfarë duhet të gjejnë?

- Si e gjejnë perimetrin e kullotës? Çfarë forme ka ajo? Sa përmasa na nevojiten për të gjetur perimetrin e fushës?

Në grupe nxënësit nxjerrin formulat për të njësuar perimetrin e katrorit, drejtkëndëshit dhe shumëkëndëshit të rregullt. Përfundimet demonstrohen dhe në tabelë.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke i komentuar mes tyre. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 të tekstit ku nxënësit argumentojnë zbatimin praktik të njohurive të mara.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime” të ndarë në grupe.

Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në njësimin e perimetrit të shumëkëndëshit çfarëdo, në nxjerrjen e formulave për njësimin e perimetrit të katrorit, drejtkëndëshit dhe shumëkëndëshit të rregullt, argumentimin e veprimeve të kryera.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.3 Përdor matjet në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Syprinat e figurave

**FJALËT KYÇE:** syprina e figurave, njësitë e matjes së syprinës  $m^2$ ,  $dm^2$ ,  $cm^2$ ,  $mm^2$ ,  $km^2$

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përcakton njësinë e matjes së syprinës duke u bazuar në katrorin njësi;
- mat me anë të katrorëve syprinën e sipërfaqes së një figure jo të rregullt;
- zbaton njohuritë për njësitë e syprinës së sipërfaqes në situata problemore;
- argumenton zgjidhjen e shembujve me situatat problemore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4, vizore e shkallëzuar

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrë

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së syprinave

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe, Gjeje titullin

Mësuesi/ja shpërndan në grupe fletët e punës ku është dhënë detyra e punës në grup.

- Vizatoni në fletoren me katrore një katror me brinjë 1 dm (10 cm).
- Ndajeni atë në katrorë me brinjë 1 cm.
- Sa katrorë me syprinë  $1 \text{ cm}^2$  vendosen në katrorin e madh?
- Plotësoni barazimin:  $1 \text{ dm}^2 = \dots \text{ cm}^2$ .

Bashkëbisedohet për situatën problemore të dhënë në rubrikën “**Kërkoni dhe zbuloni**”.

- A kanë ato të njëjtën syprinë dy parcelat e fermerëve?
- Fermerët duan t'i rrethojnë perimoret me gardhe. Cila perimore do të ketë gardhin më të gjatë? Nga diskutimi i situatave të mësipërm nxënësit nxjerrin se për çfarë flitet në këtë temë mësimi.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Nxënësit udhëzohen të lexojnë rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Kur nxënësit të kenë mbaruar leximin fillojnë diskutimin në grup për pjesën e lexuar.

Iu përgjigjen pyetjeve:

- Çdo të thotë të matësh syprinën e një figure?
- Cilat janë njësitë matëse të syprinës?
- Si mund të plotësohen barazimet:

$$1 \text{ cm}^2 = \dots \text{ mm}^2; 1 \text{ dm}^2 = \dots \text{ Cm}^2; 1 \text{ m}^2 = \dots \text{ Dm}^2; 1 \text{ km}^2 = \dots \text{ m}^2.$$

- Po nëse figura nuk është e rregullt si do të vlerësohet me ndihmën e katrorëve syprina e tyre?

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” ku do të njësojnë syprinën e figurave me ndihmën e njërive katrore. Diskutojnë me njëri-tjetrin. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 të tekstit ku nxënësit njësojnë në % sipërfaqen e ngjyrosur.

Kërkohet nga nxënësit të bëjnë një përmbledhje të njohurive që u trajtuan gjatë orës.

Çfarë mësuan	Si e kuptojnë	shembull
syprinë	.....	.....
$\text{cm}^2$	.....	.....
...	.....	.....

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”.

Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë në tabelë duke i diskutuar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në listimin e njërive të syprinës, në njësimin me ndihmën e njërive katrore të syprinave të të figurave jo të rregullta.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Njehson syprinën e shumëkëndëshave, katrorit, e drejtkëndëshit.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.4 Sugjeron formula të ndryshme dhe përshtatshme për zgjidhje të detyrave.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Syprina e drejtkëndëshit. Syprina e katrorit*

**FJALËT KYÇE:** syprina e drejtkëndëshit, katrorit, njësitë e matjes së syprinës  $m^2$ ,  $dm^2$ ,  $cm^2$ ,  $mm^2$ ,  $km^2$ .

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- nxjerr formulën për të njësuar syprinën e drejtkëndëshit dhe katrorit;
- zbaton formulat për syprinën e sipërfaqeve drejtkëndëshe dhe katrore në situata problemore;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore duke përshkruar zgjidhjen e detyrës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4, vizore e shkallëzuar

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së syprinave.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe**

Ftohen nxënësit të zgjidhen situatat e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”. Për këtë shpërndahen në grupe fletët e punës në A4 ku është dhënë detyra e punës në grup.

Janë vizatuar drejtkëndëshi dhe katrori të dhënë në figurën e librit ku brinjët janë ndarë në pjesë me nga 1cm. Kërkohet të gjejnë syprinën e tyre duke e ndarë në katrorë të vegjël.

Për detyrën e dytë mendoni një drejtkëndësh me gjatësi 6 cm dhe gjerësi 5 cm të ndarë në katrorë me brinjë 1 cm.

Në sa shirita horizontale është ndarë?

Sa katrorë ka në secilin shirit?

Sa është numri i përgjithshëm i katrorëve?

A është syprina  $6 \cdot 5 = 30 \text{ cm}^2$ .


A mund ta gjeni më shpejt (pa numërim) numrin e katrorëve?

Argumentoni.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Vrojtohet shembulli i zgjidhur në “Vrojtoni dhe mësoni”. Diskutohet.

Organizojnë njohuritë:

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” ku do të njësojnë syprinën e figurave me ndihmën e formulave. Diskutojnë me njëri-tjetrin. Bashkëbisedohet për ushtrim 6 të tekstit ku do të gjejnë me dy mënyra syprinën e parcelës së mbjellë.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”. Grupet kontrollojnë dhe vlerësojnë zgjidhjen e grupeve të tjera.

Detyrat e zgjidhura prezantohen dhe në tabelë duke i diskutuar.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në argumentimin e nxjerrjes së formulës për njësimin e syprinës së katrorit dhe drejtkëndëshit, në njësimin me ndihmën e formulave të syprinave të drejtkëndëshit dhe katrorit.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër.
- Kryen matje të gjatësisë në situata problemore.
- Vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

4.2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Veprime me njësitë e matjes së syprinës*

FJALËT KYÇE: **syprina, njësiti e matjes së syprinës  $m^2$ ,  $dm^2$ ,  $cm^2$ ,  $mm^2$ ,  $km^2$ , veprimet aritmetike.**

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- liston njësiti e matjes së syprinës;
- shndërron njësiti nga më e madhe në njësinë më të vogël dhe anasjelltas;
- kryen veprime aritmetike me njësiti e syprinës;
- demonstroi zbatimin e njohurive njësiti e sipërfaqes në situata nga jeta reale.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4, vizore e shkallëzuar

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së syprinave

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim

Ftohen nxënësit të zgjidhen situatat e rubrikës “**Kërkoni dhe zbuloni**”. Për këtë shpërndahen në grupe fletët e punës në A4 ku është dhënë detyra e punës në grup.


Piramida e faraonit Xhoser ka bazë drejtkëndëshe me gjatësi 100 m dhe syprinë 12 500  $m^2$ . Një turist ecën për qark saj me shpejtësi prej 30 m në minutë. A mund të tregoni për sa minuta e mbaron ai xhiron e tij?

Bashkëbisedoni.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Zgjidhja e situatës së mësipërme do të çojë në kryerjen e veprimit  $12\,500\,m^2 : 100\,m$ .

Me ndihmën e organizuesit grafik, në bashkëbisedim me nxënësit tregohet si kalohet nga njësia më e madhe te më e vogla dhe anasjelltas:



Nxiten nxënësit të japin shembuj të kalimeve nga një njësi në tjetrën. Vrojtohen dhe shembujt e zgjidhur të rubrikës “**Vrojtoni dhe mësoni**”.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke

zbatuar” ku do të njësojnë syprinën e figurave me ndihmën e formulave. Diskutojnë me njëri-tjetrin. Bashkëbisedohet për ushtrim 4 të tekstit ku do të gjejnë syprinën e liqenit me ndihmën e njësive katrore.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”. Grupet kontrollojnë dhe vlerësojnë zgjidhjen e grupeve të tjera.

Detyrat e zgjidhura prezantohen dhe në tabelë duke i diskutuar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në renditjen e njësive të matjes së syprinës, kryerjen e veprimeve me njësitë e syprinës. Argumentimi i veprimeve të kryera gjatë shndërrimeve nga një njësi në tjetrën.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Këmben njësitë matëse të vëllimit (litri, decilitri etj.).
- Përdor matjet dhe përvetëson formulat për caktimin e vëllimit të trupave, si dhe zgjidh probleme nga situata reale.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.3 Përdor matjet në figurat 2D ( $D = \text{dimensionale}$ ) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore: Vëllimet e trupave. Njësitë e vëllimit**

FJALËT KYÇE: vëllimi, njësitë e vëllimit,  $m^3$ ,  $dm^3$ ,  $cm^3$ ,  $mm^3$ ,  $km^3$ , veprimet aritmetike me to.

**Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përkufizon çfarë është vëllimi i një trupi në hapësirë;
- tregon njësinë themelore të matjes së vëllimit, shumëfishat dhe nënfishat e tij;
- shndërron njësitë e vëllimit nga njësia më e madhe në njësinë më të vogël dhe anasjelltas;
- arsyeton veprimet e kryera për të shndërruar njësitë e matjes së vëllimit duke shpjeguar këtë shndërrim;
- demonstroi zbatimin e njohurive për matjen e vëllimit të trupave në situata nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, kub, kuboid

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të matjes së vëllimit të trupave.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe, bashkëbisedim**

Ptohen nxënësit të zgjidhen situatat e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë sa kube ka kuboidi i dhënë në figurë. Sa kube duhen për të plotësuar kuboidin e dhënë në figurën e librit.

Një kuboid ka të njëjtën bazë me kuboidin që është paraqitur në figurën 7.44/b. Ai ka disa shtresa të tilla dhe përbëhet gjithsej nga 156 kube të vegjël. A mund të gjeni sa do të jetë numri i shtresave të këtij kuboidi?

Bashkëbisedoni.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim, organizuesi grafik**


Zgjidhja e situatës së mësipërme çon në trajtimin e koncepteve vëllim, njësitë e vëllimit.

Organizon njësitë e matjes së vëllimit njësinë themelore.

Metri kub	Decimetri kub	Centimetri kub	Milimetri kub
$1 m^3$	.....(simboli)	.....(simboli)	.....(simboli)

Me ndihmën e organizuesit grafik nxënësit plotësojnë diagramin.

Vrojtohet shembulli i zgjidhur në “Vrojtoni dhe mësoni”. Diskutohet rreth tij.



Punohet punë në grup: Vrojttoni figurën 7.45 me gjatësi të brinjëve  $a = 4$  cm,  $b = 3$  cm,  $c = 5$  cm.

- Sa kube me brinjë 1 cm ka në shtresën e poshtme?
- Sa shtresa të tilla ka kuboidi?
- Sa kube me brinjë 1 cm përmban kuboidi?
- A mund të themi që vëllimi i kuboidit me përmasa  $a, b, c$  është  $V = a \cdot b \cdot c$ ? Po i kubit me brinjë a?

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtruhuni duke zbatuar**” ku do të njësojnë syprinën e figurave me ndihmën e formulave. Diskutojnë me njëri-tjetrin. Bashkëbisedohet për ushtrim 4 të tekstit ku do të gjejnë vëllimin e depozitës dhe sa litra nxë ajo.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”.

Kontrollohet puna në grupe nga vetë nxënësit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në renditjen e njësive të matjes së vëllimit dhe të nxënësisë, kryerjen e veprimeve me njësitë e vëllimit, njësimin e vëllimit të kubit dhe kuboidit. Argumentimi i veprimeve të kryera gjatë shndërrimeve nga një njësi në tjetrën.

Argumentimi i zgjidhjes së situatave praktike.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përcakton njësitë matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit.
- Përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret.
- Shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër.
- Këmben njësitë e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.
- Kryen matje të gjatësisë në situata problemore.
- Njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit, perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit.
- Vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt.
- Këmben njësitë matëse të vëllimit (litri, decilitri etj.).
- Përdor matjet dhe përvetëson formulat për caktimin e perimetrit, syprinës së sipërfaqes së figurave dhe vëllimin e trupave, si dhe zgjidh probleme nga situata reale.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.3 Përdor matjet në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Përsëritje

FJALËT KYÇE: matja, njësitë e matjes së gjatësisë, syprinës dhe vëllimit, veprimet aritmetike me to

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përcakton njësitë matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit;
- përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret;

- shndërron njësité matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër;
- këmben njësité e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;
- njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit; drejtkëndëshit me ndihmën e formulave.
- vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt;
- këmben njësité matëse të vëllimit (litri, decilitri etj.);
- argumenton veprimet e kryera;
- demonstroi zbatimin e njohurive në situata nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshë/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Në këtë temë mësuam:	Provoni të zgjidhni.
çdo të thotë të matësh; cilat janë njësité themelore të matjes së gjatësisë, syprinës dhe vëllimit;	1. Tregoni objekte: a) me gjatësi afërsisht 1 cm, 2 dm, 2 km b) me syprinë afërsisht 2 dm <sup>2</sup> ; 4 m <sup>2</sup> ; 5 km <sup>2</sup> c) me vëllim afërsisht 1 dm <sup>3</sup> ; 10 m <sup>3</sup> ; 1 litër; 5 ml
si përzgjidhen njësité dhe mjete i përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret.	2. Me çfarë mjete mund të matni dhe cilën njësi mund të shprehni: a) përmasat e klasës? b) syprina e faqeve anësore të klasës? c) vëllimi i klasës?
.....	.....
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në përcaktimin e njësive matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit; shndërrimin e njësive matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër; njehsimin e perimetrit dhe syprinën e katrorit; drejtkëndëshit me ndihmën e formulave. Argumentimin e veprimeve të kryera.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje të madhësive. Gjeometrike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përcakton njësitë matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit.
- Përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret.
- Shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër.
- Këmben njësitë e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.
- Kryen matje të gjatësisë në situata problemore.
- Njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit, perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit.
- Vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt.
- Këmben njësitë matëse të vëllimit (litri, decilitri etj.).
- Përdor matjet dhe përvetëson formulat për caktimin e perimetrit, syprinës së sipërfaqes së figurave dhe vëllimin e trupave, si dhe zgjidh probleme nga situata reale.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.3 Përdor matjet në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D (prizmave) për zgjidhjen problemore.

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Vlerësim*

FJALËT KYÇE: **matja, njësitë e matjes së gjatësisë, syprinës dhe vëllimit, veprimet aritmetike me to**

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përcakton njësitë matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit;
- përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret;
- shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër;
- këmben njësitë e matjes (km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;
- njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit; drejtkëndëshit me ndihmën e formulave.
- vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt;
- këmben njësitë matëse të vëllimit (litri, decilitri etj.);
- argumenton veprimet e kryera;
- demonstroi zbatimin e njohurive në situata nga jeta reale.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në përcaktimin e njësive matëse të gjatësisë, syprinës dhe vëllimit; shndërrimin e njësive matëse nga njëra njësi në njësinë tjetër; njehsimin e perimetrit dhe syprinën e katrorit; drejtkëndëshit me ndihmën e formulave. Argumentimin e veprimeve të kryera.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ◀TEMA 8

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

3.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Kuptimi i numrit të plotë*

**FJALËT KYÇE:** numrat pozitivë, numrat negativ, zero, numrat e plote, numrat e kundërt

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon numrat pozitivë dhe negativë;
- përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim i numrave pozitivë, negativë dhe zero;
- demonstroi zbatimin e numrave të plotë në situata nga jeta e përditshme;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, termometër

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, gjeografia,  
Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të numrave me shenjë.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla. Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”. Në grupe të vogla japin zgjidhje për situatën:

Në tabelën e mëposhtme jepen disa temperaturat në një ditë dimri në disa nga qytetet e Kosovës.

Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren
-4°C	+3°C	-3°C	-2°C	+1°C	-3°C	+2°C

Cilat qytete kanë temperaturën nën 0 gradë?


Cili ka temperaturën më të ulët? Po më të lartën?

Me çfarë numri tregohen temperaturat nën 0 gradë? Po mbi 0 gradë?

Bashkëbisedoni me shokun/shoqen.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Nga bashkëbisedimi për zgjidhjen e situatës së mësipërme, jepet kuptimi i numrave të plotë



Numrat e kundërt,  $n$  dhe  $-n$ .

Bashkësia e numrave natyrorë shënohet me  $Z$ .

Nxiten nxënësit të tregojnë shembuj të përdorimit të numrit të plotë në jetën e përditshme.

**Përmbledhin njohuritë**

Di	Dua të di	Mësova
Si të shënoj lartësinë e malit?	Si të shënoj temperaturën nën zero?	Temperaturën nën 0 e shënoj me $-$ para. Shembuj
	Si të shënoj thellësinë ku ndodhet zhytësi/	Thellësinë e shënoj me $-$ . Shembuj.
.....	.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar mes tyre. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 dhe 6 ku kemi përdorim në praktikë të numrit me shenjë.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura në grup do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në kuptimin e numrit me shenjë, përdorimin e tij në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike.
- Krahason numrat e plotë në drejtëzën numerike.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Paraqitja e numrave të plotë në boshtin numerik*

**FJALËT KYÇE: numrat pozitivë, numrat negativë, zero, numrat e plotë, numrat e kundërt, bosht numerik**

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- gjen vendndodhjen e numrit të plotë në boshtin numerik;
- krahason numrat e plotë duke i vendosur ato në boshtin numerik;
- radhit në varg rritës ose zbritës numrat e plotë;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore me numra të plotë nga jeta e përditshme.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, gjeografia

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të numrave me shenjë

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla. Bashkëbisedim

Mësuesi/ja fton nxënësit të rreshtohen nga pesë nxënës në anën e majtë dhe të djathtë të saj. Më anën e lojës shpjegon numrat që ndodhen në anë të majtë të saj dhe të djathtë:

- Të bëj një hap para nxënësi që ndodhet dy njësi larg nga unë në anën e majtë.
- Të bëj një hap pas nxënësi që ndodhet tre njësi larg nga unë në anën e djathtë.
- Të bëj një hap para nxënësi që ndodhet dy njësi larg nga unë?
- Kush nxënës do të lëvizte? A mjafton vetën kaq për të vënë në lëvizje nxënësit?

Vazhdohet të punojnë veprimtarinë e rubrikës “Kërkoni dhe zbuloni”.

Në grupe të vogla japin zgjidhje për situatën:

- Vizatoni një bosht numerik, ku keni përzgjedhur dhe njësinë u të ndarjes së boshtit. Gjeneroni në bosht vendndodhjen e pikës dy njësi larg nga pika O. Sa pika të tilla do të gesh?

Kërkoni shokut të gjejë në boshtin numerik pikën që ndodhet pesë njësi larg nga pika O. Sa pika të tilla do të gjejë shoku juaj?

Si do të dalloni pikat që ndodhen në anë të kundërt të pikës O?

Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Nga bashkëbisedimi për zgjidhjen e situatës së mësipërme, jepet kuptimi i numrave të plotë.

Koncepti i ri: numrat me shenjë	Koncepti i njohur analog: Vendosja e nxënësve në banka
Vendosja në bosht	Vendosja e nxënësve në dyja anët e mësuesit/es
	Niveli i detit, lartësitë mbi nivelin e detit, thellësitë nën nivelin e detit
	Temperatura 0 gradë, mbi dhe nën zero gradë.
Krahasimi i numrave të plotë	

Vrojtohen shembujt e zgjidhur të rubrikës “Vrojtoni dhe mësoni”.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit, të organizuar në grupe, për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke i bashkëbiseduar për zgjidhjen e tyre. Bashkëbisedohet për ushtrim 7 ku kemi përdorim në praktikë të numrit me shenjë.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”. Në një minikonkurs, nxënësit kontrollojnë përgjigjet e ushtrimeve.

Detyrat e zgjidhura në grup do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në kuptimin e numrit me shenjë, vendosjen e tij në boshtin numerik, krahasimin e numrit të plotë duke gjetur vendndodhjen e tij në boshtin numerik, përdorimin e tij në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

### **Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjet matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Mbledhja e dy numrave të plotë**

**FJALËT KYÇE: numrat pozitivë, numrat negativ, zero, numrat e plote, numrat e kundërt, bosht numerik, shuma e numrave të plotë**

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- gjen shumën e numrave të plotë me të njëjtën shenjë duke përdorur boshtin numerik;
- gjen shumën e numrave të plotë me shenjë të kundërt duke përdorur boshtin numerik;
- kryen veprimin e mbledhjes me numrat e plotë;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore me numra të plotë nga jeta e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, gjeografia.

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të numrave me shenjë..

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë veprimtarinë e rubrikës “**Kërkoni dhe zbuloni**”.

Në grupe të vogla japin zgjidhje për situatën:

Një zhytës ndodhet 4 m nën nivelin e detit. Ai zhytet dhe 5 m të tjera. Në çfarë thellësie nga niveli i detit ndodhet zhytësi? Pas disa minutash, ai ngjitet 7 m.

Diskutoni me shokun/shoqen: sa larg nga niveli i detit ndodhet zhytësi?

Duke marrë si 0 nivelin e detit udhëzohen nxënësit të bëjnë një skicë ndihmëse të zhvendosjes së zhytësit.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**


Nga bashkëbisedimi për zgjidhjen e situatës së mësipërme, shkojmë në kryerjen e veprimit:

$$(-4) + (-5) + (+7) = ?$$

Si mblidhen dy numra me të njëjtën shenjë?

Si mblidhen dy numra me shenjë të kundërt?

Duke u zhvendosur në boshtin numerik duke marrë disa shembuj, vetë nxënësit nxjerrin përfundimet për të dyja rastet.



Vrojtohen shembujt e zgjidhur të rubrikës “Vrojtoni dhe mësoni”.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla.

Ftohen nxënësit, të organizuar në grupe, për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Punë në grup**” duke përdorur numrat me shenjë. Nxënësit gjejnë se si del tregtari gjatë aktivitetit të tij. Më pas, iu jepet nxënësve të punojnë e ta bashkëbisedojnë për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës “**Ushtrohemi duke punuar**”. Bashkëbisedohet për ushtrim 4 ku kemi përdorim në praktikë të shumës të numrave me shenjë.

Ju jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”. Në një minikonkurs “Më i shpejti më i sakti” kontrollohen dhe vlerësohet zgjidhja e ushtrimeve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në gjetjen e shumës së numrave me të njëjtën shenjë, me shenjë të kundërt, me ndihmën e boshtit numerik dhe pa bosht numerik, përdorimin e njohurive në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehje numerike me mbledhje e zbritje të numrave të plotë

**FJALËT KYÇE:** numrat pozitiv, numrat negativ, zero, numrat e plote, numrat e kundërt, bosht numerik, shuma dhe ndryshimi i numrave të plotë

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- gjen shumën dhe ndryshimin e numrave të plotë me të njëjtën;
- gjen vlerën e shprehjes numerike me numra të plotë;
- zgjidh ekuacione të thjeshta me numra të plotë;
- argumenton veprimet e kryera;
- demonstroi përdorimin e numrave me shenjë në situata problemore nga jeta e përditshme.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të numrave me shenjë.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Nëpërmjet bashkëbisedimit kujtohet cila është radha e kryerjes së veprimeve në një shprehje me dhe pa kllapa me veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes me numra natyrorë.

Më pas ftohen nxënësit të punojnë veprimtarinë e rubrikës “**Kërkoni dhe zbuloni**”.

- Agimi ka të depozituara në bankë 5500 euro. Në muajin e parë, tërheq 1200 euro dhe depoziton 500 euro. Në muajin e dytë, tërheq 1100 euro dhe depoziton 800 euro. Sa euro ka Agimi në bankë, pas muajit të dytë?

Shkruani një shprehje numerike për të zgjidhur problemën, duke përdorur numrat me shenjë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Zgjidhja e situatës së rubrikës së parë do të kërkojë gjetjen e vlerës së shprehjes:

$$5500 - 1200 + 500 - 1100 + 800 = ?$$

Si do të gjendet vlera e shprehjes?

Udhëzohen nxënësit të gjejnë vlerën e shprehjes:

a) Duke kryer veprimet sipas radhës.

b) Duke grupuar numrat me të njëjtën shenjë.

Bashkëbisedim: A do t'ju dali i njëjti përfundim?

Në rastin kur shprehja ka kllapa, cila është radha e kryerjes së veprimeve?

Vrojtohen shembujt e zgjidhur në tekstin e nxënësit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Ndahet klasa në grupe. Ftohen nxënësit për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohemi duke punuar**”. Bashkëbisedohet për ushtrim 4 ku kemi përdorim në praktikë të shumës dhe ndryshimit të numrit me shenjë.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”. Nxiten nxënësit të kontrollojnë dhe të vlerësojnë punën e shokëve të grupeve të tjera.

Diskutohen zgjidhjet dhe në tabelë, duke argumentuar dhe veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në gjetjen vlerës së shprehjes numerike me dhe pa kllapa me numra të plotë, përdorimin e njohurive në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore dhe të veprimeve të kryera gjatë gjetjes së vlerës së shprehjes.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike.
- Përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero.
- Rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë.
- Identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike.
- Krahason numrat e plotë në boshtin numerik.
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situatë konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Çfarë mësuam (përsëritje)

**FJALËT KYÇE:** numrat pozitivë, numrat negativ, zero, numrat e plotë, numrat e kundërt, bosht numerik, shuma dhe ndryshimi i numrave të plotë

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike;
- përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero;
- rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë;

- identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike;
- krahason numrat e plotë në boshtin numerik;
- kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

<i>Tashmë kemi mësuar</i>	<i>Provoni të zgjidhni.</i>
si vendosen numrat e plotë në boshtin numerik, cilat numra vendosen në të majtë të origjinës së boshtit, pikës O, dhe cilët në të djathtë të saj;	1. Shënoni me numra të plotë. a) katër gradë nën zero; b) dhjetë gradë mbi zero; c) pesë metra mbi nivelin e detit; d) pesëmbëdhjetë metra nën nivelin e detit; e) depozitoi në bankë 500 euro; f) tërhoqi nga banka 1200 euro.
kush numra bën pjesë në bashkësinë e numrave të plotë, dhe si shënohet ajo.	2. Tregoni element të bashkësisë së numrave të plotë. 3. A mund të tregoni: a) numrin më të vogël të plotë; b) numrin më të madh të plotë; c) numrin e plotë më të madh negativ; d) numrin më të vogël të plotë pozitiv; e) numrin pa shenjë.
.....	.....
.....	.....

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë në grupe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në vendosjen e numrit me shenjë në boshtin numerik, në gjetjen e shumës dhe ndryshimit të numrave me shenjë, gjetjen vlerës së shprehjes numerike me dhe pa kllapa me numra të plotë, përdorimin e njohurive në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore dhe të veprimeve të kryera gjatë gjetjes së vlerës së shprehjes.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Numrat e plotë

#### Rezultati i të nxënit të temës:

- Identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike.
- Përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero.
- Rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë.
- Identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike.
- Krahason numrat e plotë në boshtin numerik.
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

#### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.2 Demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situatë konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Vlerësim**

**FJALËT KYÇE: numrat pozitive, numrat negativ, zero, numrat e plote, numrat e kundërt, bosht numerik, shuma dhe ndryshimi i numrave të plotë**

### Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike;
- përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkim (union) i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero;
- rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë;
- identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike;
- krahason numrat e plotë në boshtin numerik;
- kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, duke shfrytëzuar boshtin numerik;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar numrat e plotë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**  
Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në vendosjen e numrit me shenjë në boshtin numerik, në gjetjen e shumës dhe ndryshimit të numrave me shenjë, gjetjen vlerës së shprehjes numerike me dhe pa kllapa me numra të plotë, përdorimin e njohurive në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore dhe të veprimeve të kryera gjatë gjetjes së vlerës së shprehjes.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# TEMA 9

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike.
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.3 zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.4 sugjeron formula të ndryshme dhe përshtatshme për zgjidhje të detyrave.

4.3 integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehjet shkronjore

**FJALËT KYÇE:** Shprehje shkronjore, vlerë e shprehjes, gjuha e matematikës

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon shprehjet shkronjore duke e paraqitur si problemë;
- gjen vlerën e shprehjes shkronjore duke e zëvendësuar ndryshoren me numër të caktuar;
- përkthen gjuhën e folur në gjuhë të matematikës dhe anasjelltas;
- vlerëson rëndësinë e këtij “përkthimi” për të zgjidhur problema të ndryshme jetësore përmes shprehjeve shkronjore.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me fjalë nga përditshmëria, me anë të matematikës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Makina udhëtoi për dy orë. Orën e parë ajo përshkoi 85 km, kurse orën e dytë përshkoi 5 km më tepër se në orën e parë. Sa km përshkoi makina për dy orë?

- Hartoni shprehjen numerike që jep zgjidhjen e problemës.
- Gjeni vlerën e shprehjes numerike.
- Po nëse makina udhëton në orën e dytë a km më tepër se në orën e parë, sa km udhëton makina për dy orë?
- Shkruani një shprehje që do t'ju ndihmojë të zgjidhni pikën (c).

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Bashkë me mësuesin/en dhe klasën bashkëbisedojnë për konceptet themelore të shprehjeve shkronjore:  $85 + (85 + a)$  – quhet shprehje shkronjore  $A = 5$  – quhet vlerë e shprehjes shkronjore Shprehjet shkronjore – “fjalë” matematike

Kur shprehjet shkronjore lidhen me  $=$ ,  $\neq$ ,  $<$ ,  $>$  formohen “fjali” matematike

Nxënësit me radhë “përkthejnë” nga një fjali në gjuhën e zakonshme në gjuhën e matematikës

ose anasjelltas.

Kontrolloni saktësinë e përkthimit në gjuhën e matematikës.

Gjuha e zakonshme	Gjuha matematike
Shuma e 7 me x.	$7 + x$
Ndryshimi i 8 me y.	$8 - y$
Numri që është 5 njësi më i madh se a.	$5 + a$
Numri që është 5 herë sa a.	$5a$
Numri që është 3 njësi më i madh se dyfishi i b.	$3 + 2b$
Numri që është trefishi i shumës së x me 2.	$3(x + 2)$
Dyfishi i x zmadhuar me 3 është 10.	$2x + 3 = 10$

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grup

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Ata këshillohen që të shkruajnë saktë fjalitë e folura për t'i “përkthyer” në gjuhën e matematikës. Detyrat e punuara i prezantojnë para klasës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë prezantuar detyrat në tabelë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike.
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Shprehjet shkronjore. Thjeshtimi i tyre*

**FJALËT KYÇE:** shprehje shkronjore, vlerë e shprehjes, thjeshtim i shprehjes

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përcakton kufizat dhe koeficientet e shprehjes shkronjore duke i veçuar ato;
- thjeshton shprehjet shkronjore duke i mbledhur, përkatësisht zbritur koeficientet e kufizave të njëjta;
- zbaton shprehjet shkronjore dhe thjeshtimin e tyre në shembuj të situatave jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me fjalë nga përditshmëria, me anë të matematikës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grup**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Shkruani me gjuhën e matematikës fjalitë e dhëna:


- shumën e një numri  $x$  me numrin 20;
- ndryshimin e dyfishit të një numri  $x$  me tre;
- pesëfishin e shumës së numrave  $a$  dhe  $b$ .

Sa do të jetë vlera numerike e shprehjeve nëse, në vend të ndryshoreve, vendosim vlerat  $x = 5$ ,  $x = 4$ ; për  $a = 1$  dhe  $b = 3$ ;  $a = 2$  dhe  $b = -4$ .

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

Bashkë me mësuesin/en dhe klasën bashkëbisedojnë për konceptet e reja të shprehjeve shkronjore dhe do të plotësojnë skemën.

**II. Thjeshtimi i shprehjeve shkronjore**

Shembull: Thjeshtojmë shprehjet shkronjore duke përdorur vetinë e shpërndarjes.

- $7x - 5x = (7 - 5)x = 2x$
- $7x - 5x + 9x = (7 - 5 + 9)x = 11x$

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza e rrumbullakët**

Nxënësit në grupe punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime”. Mësuesi/ja shpërndanë fletë A4 ku kërkon t'i zgjidhin detyrat duke e përcjellë fletën brenda grupit. Secili nxënës zgjidhë nga një detyrë. Kështu vazhdojnë në cikël derisa t'i përfundojnë të gjitha detyrat.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë prezantuar detyrat në tabelë me anë të instrumenteve në listën e kontrollit.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

#### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe zgjidhjet përkatëse të tyre.

#### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

#### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Barazimet numerike dhe vetitë e tyre*

**FJALËT KYÇE: barazim numerik, vlerë numerike, veti të barazimeve**
**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përkufizon barazimet numerike duke treguar se si formohen ato;
- arsyeton vetitë e barazimeve numerike duke argumentuar vërtetësinë e tyre në shembujt e dhënë;
- zbaton barazimet numerike dhe vetitë e tyre duke i përdorë ato në shembujt të situatave jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të barazimeve

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Duke përdorur numrat 3; 5; 8, shkruani një barazim me mbledhje dhe dy barazime me zbritje.

Nxënësit bashkëbisedojnë mes tyre dhe shkëmbejnë ide rreth barazimeve të fituara.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë barazimet e dhëna nga grupet.

**Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e mësimin të ri në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Gjatë leximit, ata do të vendosin në fund të çdo informate nga një simbol që tregon se si e kanë kuptuar atë informatë.

“√” – nëse informacioni është i njohur për ju.

“+” – nëse informacioni është i ri.

“?” – nëse informacioni është i paqartë.

“-” – nëse informacioni që lexuat është ndryshe nga ai që e dinit më parë.

Nxënësit në fletore do të vizatojnë tabelën në të cilën do të shkruajnë informacionet sipas simboleve që kanë vendosur.

√	+	-	?
Kemi $4 = 4$ ; $3 = 3$ ; $0 = 0$ . Çdo numër është i barabartë me veten.	Dy numra ose dy shprehje numerike, të lidhura ndërmjet tyre me shenjën “=” formojnë një barazim numerik.	$7 + 5 = 6 + 9$	Në qoftë se janë të vërteta barazimet $a = b$ dhe $b = c$ , atëherë është i vërtetë edhe barazimi $a = c$ . Kjo quhet vetia tranzitive (vetia e kalimit) e barazimit numerik.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe (Tabela INSERT)**

Në tabelën e klasës, mësuesi/ja plotëson tabelën e INSERT-it duke marrë mendimet e nxënësve dhe duke u ndalur më gjatë te kolona me shenjë “?” për të dhënë sqarimet e informacioneve që nxënësit nuk i kanë kuptuar.

Nxënësit në grupe në një fletë A4 punojnë detyrat e rubrikës “**Ushtrime**” dhe punimet i vendosin në tabelë për t’i komentuar dhe vlerësuar bashkë me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënimit në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti detyrat e prezantuara në tabelë. Nxënësit vlerësohen me anë të instrumenteve në listën e kontrollit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet**Rezultati i të nxënimit të temës:**

- përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre.

**Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Ekuacioni

FJALËT KYÇE: ekuacion, rrënjë e ekuacionit, zgjidhje e ekuacionit

#### Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon ekuacionet duke e shprehur si barazim që përmban ndryshore;
- zgjidh ekuacione duke kryer veprime matematikore në to;
- arsyeton vërtetësinë e zgjidhjes së ekuacionit duke bërë provën e tij;
- zbaton zgjidhjen e ekuacioneve në shembuj nga jeta e përditshme.

#### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4

#### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të ekuacioneve

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

#### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës. Në njërën pjatë të një peshoreje të baraspeshuar ndodhet një pjepër dhe një gur peshe prej 2 kg, kurse në pjatën tjetër një gur peshe 5 kg.

- Shënoni masën e pjeprit me  $x$  (kg).
- Shkruani një barazim për të gjetur  $x$ .
- Gjeni vlerën e  $x$  (masën e pjeprit).

Përgjigjet e disa grupeve shkruhen në tabelë.

#### Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari trepjesësh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e mësimit të ri në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Gjatë leximit, ata do të plotësojnë tabelën ku do të dallojnë shembullin, zgjidhjen dhe provën e zgjidhjes së ekuacionit.

Shembulli	Zgjidhja	Prova
Zgjidhni ekuacionin $15 + x = 62$ .	Sipas kuptimit të zbritjes, ky barazim do të thotë që mbledhori i panjohur ( $x$ ) është ndryshimi midis shumës (62) dhe mbledhorit tjetër (15). Pra $x = 62 - 15$ , d.m.th. $x = 47$	Numri 47 është vërtetë zgjidhje e ekuacionit $15 + x = 62$ , sepse duke zëvendësuar në të $x$ me 47, marrim barazimin e vërtetë $15 + 47 = 62$ .
Zgjidhni ekuacionin $y - 6 = 13$ .	Sipas kuptimit të zbritjes, ky barazim do të thotë që $y$ është shumë e numrave 13 dhe 6. Pra, $y = 13 + 6$ d.m.th. $y = 19$ .	Numri 19 është vërtetë zgjidhje e ekuacionit $y - 6 = 13$ , sepse duke zëvendësuar në të $y$ me 19, marrim barazimin e vërtetë $19 - 6 = 13$ .

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe (Pesëvargëshi)**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup të shkruajnë një pesëvargësh për ekuacionet.

Ekuacioni

I zgjidhshëm      I pazgjidhshëm  
Zgjidhet      Diskutohet      Provohet  
Ekuacionet zbatohen në jetën e përditshme

Barazim

Nxënësit në grupe në një fletë A4 punojnë detyrat e rubrikës “**Ushtrime**” dhe punimet i shkëmbejnë mes grupesh për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit. Disa nxënës zgjidhin detyrat në tabelë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënës në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë prezantuar detyrat në tabelë. Nxënësit vlerësohen me anë të instrumenteve në listën e kontrollit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

**Rezultati i të nxënës të temës:**

- Zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur (duke përdorur vetitë aditive dhe multiplikative).

**Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi

(matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.  
4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Ekuacioni  $x + a = b$  dhe  $ax = b$**

FJALËT KYÇE: ekuacion, rrënjë e ekuacionit, zgjidhje e ekuacionit

### Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- zgjidh ekuacione të formës  $x + a = b$  dhe  $ax = b$  duke kryer veprimet sipas radhës së caktuar;
- arsyeton vërtetësinë e zgjidhjes së ekuacionit duke bërë provën e tij;
- zbaton zgjidhjen e ekuacioneve në shembuj nga jeta e përditshme.
- zbaton zgjidhjen e ekuacioneve në shembuj nga jeta e përditshme.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, fletë A4

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të ekuacioneve

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës. Në bibliotekën e tij, Miri kishte 12 libra artistikë më shumë se Bora, ndërsa Arbi kishte 2 herë më shumë se Miri. Nëse Miri kishte 35 libra artistikë, gjeni sa libra artistikë kishin Bora dhe Arbri në bibliotekat e tyre.

Shkruani ekuacionet që do t'ju ndihmojnë për të zgjidhur problemën.

Zgjidhni ekuacionin me dy mënyra:

- a) sipas kuptimit të veprimeve;
- b) duke përdorur vetitë e barazimeve.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i avancuar

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e mësimin të ri në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Duke bashkëbiseduar me nxënësit, mësuesi/ja zgjidh në tabelë detyrën. Ai/ajo zgjidh detyrën duke pyetur nxënësit:

Zgjidhni ekuacionin  $x - 8 = 6$ .

- Çfarë duhet të bëjmë në fillim për të zgjidhur ekuacionin?
- Cili është veprimi që duhet kryer?

- Sa është rrënja (zgjdhja) e ekuacionit?
- Jepni formën e përgjithshme të zgjidhjes së ekuacionit  $x + a = b$ .  
Zgjidhni ekuacionin  $5x = 75$ .
- Çfarë duhet të bëjmë në fillim për të zgjidhur këtë formë të ekuacionit?
- Cili është veprimi që duhet kryer?
- Sa është rrënja (zgjdhja) e ekuacionit?
- Jepni formën e përgjithshme të zgjidhjes së ekuacionit  $ax = b$  ku  $a$  dhe  $b$  janë numra dhe  $a \neq 0$ .  
Nxënësit në grupe zgjidhin detyrën:  $2x - 4 = 16$  dhe u bënë të njëjtat pyetje si më lart për të përforcuar të nxënësit.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Nxënësit në grupe në një fletë A4 punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime” dhe punimet i shkëmbejnë mes grupesh për të vlerësuar punën e njëri tjetrit. Disa nxënës zgjidhin detyrat në tabelë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësit në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë prezantuar detyrat në tabelë. Nxënësit vlerësohen me anë të instrumenteve në listën e kontrollit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

**Rezultati i të nxënësit të temës:**

- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

**Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.1 Përdor simbole, fakte, për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.

7.1 Identifikon ndryshoret dhe strukturat matematike në një problem të botës reale.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Problema që zgjidhen me ekuacione me një ndryshore*

FJALËT KYÇE: ekuacion, rrënjë e ekuacionit, zgjidhje e ekuacionit

**Rezultati/et e të nxënimit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- zgjidh ekuacione duke kryer veprimet sipas radhës së caktuar;
- arsyeton vërtetësinë e zgjidhjes së ekuacionit duke bërë provën e tij;
- zbaton zgjidhjen e ekuacioneve në shembuj nga jeta e përditshme;
- vlerëson nevojën e zgjidhjes së situatave të ndryshme jetësore përmes ekuacioneve.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të ekuacioneve

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Iliri e lexoi librin me 280 faqe për tri ditë. Ditën e dytë lexoi 40 faqe më tepër se ditën e parë, kurse ditën e tretë dyfishin e ditës së parë. Sa faqe lexoi ditën e parë?

Shtroi një ekuacion për zgjidhjen e problemës, duke shënuar me  $x$  faqet që lexoi ditën e parë.

Zgjidhni ekuacionin dhe argumentoni.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë këshillat për zgjidhjen e problemave me anë të ekuacioneve.

Duke bashkëbiseduar me nxënësit, mësuesi/ja zgjidh në tabelë detyrën e parë dhe kërkon nga nxënësit që gjatë zgjidhjes së detyrës të identifikojnë këshillat që lexuan në fillim për zgjidhjen e problemave.

**Shembull1:** Beni është 12 vjeç, kurse babai i tij është 40 vjeç. Pas sa vitesh babai do të jetë dy herë më i madh se Beni?

**Këshilla e parë:** Lexoni me kujdes problemën; kuptoni për çfarë bën fjalë ajo dhe çfarë duhet gjetur. Mbani shënim të dhënat dhe kërkesën.

**Këshilla e dytë:** Madhësinë e panjohur shënojeni me një shkronjë (ndryshore).

**Këshilla e tretë:** Madhësitë e tjera të panjohura në problemë përpiquni t'i shprehni nëpërmjet ndryshores (të ndërtoni për to shprehje shkronjore).

**Këshilla e katërt:** Duke barazuar dy shprehje që japin të njëjtën madhësi, formoni një ekuacion me një ndryshore.

**Këshilla e pestë:** Zgjidhni ekuacionin.

**Këshilla e gjashtë** Jepni përgjigjen e problemës

Zgjidhja e detyrës:

$$\begin{aligned}2 \cdot (12 + x) &= 40 + x \\2 \cdot 12 + 2 \cdot x &= 40 + x \\24 + 2x &= 40 + x \\2x - x &= 40 - 24 \\x &= 16\end{aligned}$$

**Përgjigje:** Pas 16 vjetësh.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur**

Nxënësit në mënyrë të pavarur punojnë detyrat e rubrikës “Ushtrime”. Fletoret do t'i shkëmbejnë me shokun/shoqen pranë për të vlerësuar zgjidhjen e detyrave. Vlerësimin do ta bëjnë me anë të simboleve ☺ ☹. Disa nxënës zgjidhin detyrat në tabelë.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënësve në bashkëpunim në grupe, në fund vlerësohen në veçanti nxënësit që kanë prezantuar detyrat në tabelë. Në pjesën e fundit të orës bëhet vlerësim i ndërsjellë mes tyre. Nxënësit vlerësohen me anë të instrumenteve në listën e kontrollit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon ekuacion (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre.
- Zgjidh inekuacione lineare me një të panjohur (duke përdorur vetitë aditive dhe multiplikative).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mosbarazime numerike dhe shkronjore

**FJALËT KYÇE:** mosbarazi, më e madhe, më e vogël

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon mosbarazimet numerike dhe shkronjore duke treguar se si formohen ato;
- gjen të përbashkëtat dhe veçoritë e barazimeve dhe mosbarazimeve;
- arsyeton vetitë e mosbarazimeve duke argumentuar vërtetësinë e tyre në shembujt e dhënë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të ekuacioneve

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Në mosbarazimin  $2x + 5 < 9$ , vendosni në vend të  $x$  numrin 1.

A merret mosbarazim numerik i vërtetë?

Po në rastin kur në vend të  $x$  vendosim numrin 2?

Çfarë mendoni se tregon kjo?

Vendosni numra të tjerë në vend të  $x$ .

Bashkëbisedoni me shokët/shoqet e grupit.

### **Ndërtimi i njohurive të reja: Ndërthurja I**

Mësuesi/ja formon grupe me nga 5 nxënës. Secilit i cakton një numër nga 1-5. Nxënësit rigrupohen sipas numrave. Ata marrin detyrat përkatëse për grupin dhe fillojnë të lexojnë mësimin e ri në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

Detyrat janë:

Grupi i parë: Kuptimi i mosbarazive

Grupi i dytë: Vetia e mosbarazive nëse  $a < b$  atëherë  $b > a$


Grupi i tretë: Për  $a > b$  vlen  $a + c > b + c$  dhe  $a - d > b - d$ ,

Grupi i katërt: Për  $a + b > c$  rrjedh  $a > c - b$ .

Grupi i pestë: Për  $a > b$  vlen  $a > b \cdot k$  dhe  $a > b : k$

Vetitë i arsyetojnë me anë të shembujve.

Ata kthehen në grupet bazë dhe iu sqarojnë shokëve/shoqeve pjesën për të cilën u përgatitën në grupet ekspertëve.



### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur**

Nxënësit në grupe përmes Diagramit të Venit gjejnë të përbashkëtat dhe veçoritë e barazive dhe mosbarazive. Punimet i vendosin në tabelë dhe një nxënës nga secili grup prezanton punimin.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënit në bashkëpunim në grupe. Në pjesën e fundit të orës bëhet vlerësim i ndërsjellë mes tyre duke vlerësuar punën e grupeve.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Zgjidh ekuacione (barazime) inekuacione (jobarazime) lineare me një të panjohur si dhe zgjidhjet përkatëse të tyre..
- Paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Inekuacionet me një ndryshore*

**FJALËT KYÇE:** mosbarazi, bashkësi zgjidhjesh, bosht numerik, ndryshore

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përkufizon zgjidhjen e inekuacionit me një ndryshore;
- shqyrton trajtat e inekuacioneve dhe rastet i konkretizon me shembuj;
- argumenton zgjidhjet e trajtave të inekuacioneve përmes boshtit numerik.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune veglat e gjeometrisë

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Zgjidhja e problemave të shprehura me anë të ekuacioneve

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që në grup, të diskutojnë shembullin e dhënë dhe t'u përgjigjen kërkesave të detyrës.

Jepen shprehjet  $x + 5$  dhe  $2x$ . A mund të gjeni dy vlera të plota të ndryshores, për të cilat vlera e shprehjes  $x + 5$  të jetë më e madhe se vlera e shprehjes  $2x$ .

Përgjigjet e nxënësve për detyrën e dhënë shkruhen në tabelë dhe vërtetohen.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë në njësinë e re mësimore rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**” dhe gjatë leximit të plotësojnë tabelën.

Pyetje	Përgjigje
Çfarë quajmë zgjidhje të inekuacionit?	Çdo vlerë e ndryshores që e kthen inekuacionin në mosbarazim numerik të vërtetë, me të njëjtin kah quhet <b>zgjidhje e inekuacionit</b> .
Si zgjidhen inekuacionet e trajtës $x + a > b$ ;  $ax > b$ ?	1. kalimin e kufizave nga njëra anë në tjetrën, duke ndërruar shenjën para tyre;  2. shumëzimin ose pjesëtimin e të dyja anëve të inekuacionit me të njëjtin numër natyror, pa ndërruar kahun.
Paraqitni grafikisht bashkësitë e zgjidhjeve të trajtave të inekuacioneve me një ndryshore.	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Mësuesi/ja fton nxënësit që në grupe të zgjidhin detyrat e rubrikës “**Ushtrime**”. Disa nxënës zgjidhin në tabelë detyrat.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet gjatë gjithë procesit të të nxënit në bashkëpunim në grupe. Në pjesën e fundit të orës bëhet vlerësim i nxënësve që zgjidhin detyrat në tabelë dhe vlerësohen në listën e kontrollit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike.
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.
- Modelon problema me shprehje shkronjore.
- Shndërron shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjellas.
- Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre.
- Zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur.
- Paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të

dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)**

**FJALËT KYÇE:** shprehje shkronjore, vlerë e shprehjes, thjeshtim i shprehjes, barazim numerik, vlerë numerike, veti të barazimeve, ekuacion, rrënjë, mosbarazi, më e madhe, më e vogël, bashkësi zgjidhjesh, bosht numerik, ndryshore

### Rezultati/et e të nxënimit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave;
- modelon problema me shprehje shkronjore;
- shndërron shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjellas;
- përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre;
- zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur;
- paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfaqësh**  
Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
si të dallojmë një shprehjen shkronjore nga një shprehje numerike;	1. Përktheni me simbole matematike: a) shumën e pesës me tetën; b) ndryshimi i një numri me pesë; c) prodhimi i shumës së katrës me tre me numrin dy; d) herësi i një numri me nëntë. Dalloni shprehjet numerike dhe ato shkronjore.
si të gjejmë vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të dhëna të ndryshores;	2. Gjeni vlerën e shprehjes. a) $12a - 4b$ për $a = 1$ dhe $b = 2$ b) $3xy - y + 5$ për $x = 1,5$ dhe $y = 3,4$
si të përkthejmë me simbole matematike.	3. Përktheni me simbole matematike. a) Shuma e trefshit të $a$ me $b$ ; b) Perimetri i drejtkëndëshit me brinjë $x$ dhe $y$ është 12; 4. Shndërroni me fjalë shprehjen: a) $2x + 3$ b) $3(x - y)$
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e të shkruarit të shprehjes shkronjore, dallimin e kufizave të ngjashme, thjeshtimin e shprehjes, gjetjen e vlerës numerike, zbatimin e vetive të barazimit, zgjidhjen e ekuacionit me vetitë e veprimeve dhe të barazimit, shkrimin e mosbarazimeve numerike dhe shkronjore, zgjidhjen e inekuacionit të fuqisë së parë me një ndryshore, dhënia e bashkësisë së zgjidhjes në boshtin numerik, argumentimin e zgjidhjes së situatave problemore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shprehjet, ekuacionet, inekuacionet**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike.
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.
- Modelon problema me shprehje shkronjore.
- Shndërron shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjellas.
- Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre.
- Zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur.
- Paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.1 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Vlerësim**

**FJALËT KYÇE:** shprehje shkronjore, vlerë e shprehjes, thjeshtim i shprehjes, barazim numerik, vlerë numerike, veti të barazimeve, ekuacion, rrënjë, mosbarazi, më e madhe, më e vogël, bashkësi zgjidhjesh, bosht numerik, ndryshore

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave;
- modelon problema me shprehje shkronjore;
- shndërron shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjellas;
- përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe gjen zgjidhjet përkatëse të tyre;
- zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur;
- paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në boshtin numerik dhe tregon bashkësinë e zgjidhjes;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**  
Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbëhen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e të shkruarit të shprehjes shkronjore, dallimin e kufizave të ngjashme, thjeshtimin e shprehjes, gjetjen e vlerës numerike, zbatimin e vetive të barazimit, zgjidhjen e ekuacionit me vetitë e veprimeve dhe të barazimit, shkrimin e mosbarazimeve numerike dhe shkronjore, zgjidhjen e inekuacionit të fuqisë së parë me një ndryshore, dhënia e bashkësisë së zgjidhjes në boshtin numerik, argumentimin e zgjidhjes së situatave problemore.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ▼TEMA 10

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Shndërron valutat e monedhave që përdoren në vendin tonë dhe vendet e tjera.
- Këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Paratë

**FJALËT KYÇE:** euro, cent, dollarë, kartëmonedha dhe monedha kombëtare

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- tregon monedhat dhe kartëmonedhat që përdoren në vendin tonë;
- kthen euron në cent dhe anasjellas;
- këmben euron me dollarin dhe monedha të tjera;
- kryen veprime me euron;
- zgjidh situata praktike nga jeta reale ku vepron me monedhat dhe kartëmonedhat e euros dhe cent;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, kartëmonedha dhe monedha të euros, monedha të centit, lap-topi

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, ekonomia

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të monedhave dhe kartëmonedhave të euros, dollarit dhe centit

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim/loja në role**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për monedhat dhe kartëmonedhat që kanë përdorur prindërit e tyre më parë.

Tregohen këto kartëmonedha dhe monedha. Për këtë mund të përdoren dhe foto të mara nga burime të internetit.

Më pas kalohet diskutimi në monedhën që përdoret sot në Kosovë, në euron.

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë disa vende të Evropës, ku përdoret monedha euro si monedhë kombëtare.

Një dyqan në klasë.

Me imitim të prerjeve të kartëmonedhave dhe monedhave në euro dhe dollarë, nxënësit të ndarë në grupe vendosen në rolin e atij që shet dhe të atij që blen objekte të cilat kanë dhe një çmim.

Si dhe në rolin e atij që ka euro dhe do t'i këmbëjë me dollarin duke marrë dhe informacion për kursin e këmbimit të euros në dollarë.

Si dhe në rolin e një turisti që do të vizitojë Shqipërinë dhe i duhet të ketë me vete lekë, të këmbëjë euron me lekun shqiptar.<sup>85</sup>

Në përfundim të lojës, do bëjnë një përmbledhje të njohurive.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Tregohen monedhat e euros që përdoren dhe monedhat e përdorura para saj.

Di	Dua të di	Mësova
Cilat janë monedhat që kanë përdorur prindërit para euros.	Si këmbëhet euro me monedhën e përdorur para saj.	Kursin e këmbimit të euros
Tani përdoret euro.	Si këmbëhet euro me dollarin.	Si të kthej në cent euron dhe anasjellas
Si të kryej veprimet me euron në jetën e përditshme.		
.....	.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupet e vogla**

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar mes tyre.

Bashkëbisedohet për ushtrim 6 ku kemi përdorim në praktikë të veprimeve me euro.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura në grup do t'i prezantojnë me radhë në “telin e tharjes” duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në veprime me kartëmonedhat dhe monedhat e euros, në këmbimin e saj me dollarin dhe lekun shqiptar, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore nga jeta e përditshme.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.
- Kryen matje të gjatësisë, masës dhe kohës
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur matjet.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Masa e trupit. Peshimi**

FJALËT KYÇE: masa, njësitë e masës, kg, g, mg, kv, t, peshore

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- rendit disa nga njësitë më të përdorshme të masës;
- kalon nga njësia më e madhe në më të voglën dhe anasjelltas, nga më e vogla te më e madhja duke përdorur numrat dhjetor;
- kryen veprimet me njësitë e matjes së masës;
- zgjidh situata praktike nga jeta reale ku vepron me njësitë e masës;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, peshore, gurë peshimi

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, ekonomia, qytetaria

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të njësive të masës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim/punë në grupe të vogla

Mësuesi/ja iu tregon nxënësve një peshore me gurët e peshimit. Kërkon prej tyre të tregojnë përse shërben, cilët janë gurët e peshimit, si përdoret? A njohin ata peshore të tjera që shërbejnë për të matur masën e trupave?

Më pas kalohet në bashkëbisedimin për zgjidhjen e situatës problemore të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”

Vlerësoni afërsisht masën e vazove që peshohen në figurën 10.2.




### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Për të zgjidhur situatën e mësipërme, nxënësit do të kryejnë veprime me njësitë e masës.

Për këtë, së pari tregojnë njësinë themelore të masës dhe shumëfishat dhe nënfishat më të përdorshme të tij.

Me ndihmën e organizuesit grafik tregojnë se:



Si kalohet nga njësia më e madhe te më e vogla dhe anasjelltas? Si mblidhen dhe zbriten njësitë e matjes? Për këtë kërkohet nga nxënësit të vrojtojnë dhe të mësojnë nga shembujt e zgjidhur në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit, të organizuar në grupe, për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtroni duke zbatuar**” duke organizuar dhe një konkurs midis grupeve kush do të përgjigjet më shpejtë dhe më saktë. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 ku kemi përdorim në praktikë të njësive të masës ku jepet masa e disa kafshëve. Duke i kthyer në njësi të njëjtë tregohet secila nga kafshët ka masë më të madhe.

Në grupe të vogla dyshe punohen ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”. Zgjidhja e tyre prezantohet dhe në tabelë pasi është përfunduar, për të treguar saktësinë e përgjigjes.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në renditjen e njësive të matjes së masës, njësisë themelore, shumëfishat dhe nënfishat më të përdorshëm të saj, kthimin e nga njësia më e madhe në më të voglën dhe anasjelltas, nga më e vogla te më e madhja duke përdorur numrat dhjetorë, zgjidhjen e situatave praktike të veprimeve njësitë e matjes dhe argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato.
- Kryen matje të gjatësisë, masës dhe kohës.
- Lexon dhe përdor sistemin 24-orësh.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Matja e kohës*

**FJALËT KYÇE:** koha, ora, minuta, sekonda, dita, java, muaji, viti, dekada, sistemi 24-orësh, sistemi 12-orësh.

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- tregon njësitë e matjes së kohës;
- lexon orën në sistemin 24 orësh dhe 12 orësh;
- llogarit kohën e ndodhjes së një ngjarje;
- kryen veprimet me njësitë e matjes së kohës;
- zgjidh situata praktike nga jeta reale ku vepron me njësitë e matjes së kohës;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore duke arsyetuar veprimet e kryera.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, peshore, sahare dhe orë elektronike, kalendarë

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të njësive të matjes së kohës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim/punë në grupe të vogla

Mësuesi/ja prezanton para nxënësve një sahat që mat orën në sistemin 12-orësh, si dhe një orë elektronike që mat kohën në sistemin 24-orësh. Kërkon prej tyre të tregojnë përse shërben, dhe si lexohet ora në secilën prej tyre.

Më pas kalohet në bashkëbisedimin për zgjidhjen e situatës problemore të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

- Një orë muri ecën çdo ditë 1,5 minuta para. Atë e rregullojnë në mesditën e datës 10 të çdo muaji. Sa do të ketë ecur para ora në datën 30 shtator, në orën 8 pasdite?

Diskutoni.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Për të zgjidhur situatën e mësipërme, nxënësit do të kryejnë veprime me njësitë e kohës. Është rregulluar në datën 10 shtator, ka kaluar 20 ditë, kështu që ora do të jetë përpara  $1,5 \text{ min} \times 20 =$  Njësitë e kohës:

- Njësia bazë e matjes së kohës është **sekonda** (shënohet sek).

- 60 sekonda formojnë **1 minutë** (shënohet 1 min).

- 60 minuta formojnë **1 orë** (shënohet 1 h).

- **Ditë-nata** ka 24 orë (shkurt thuhet **dita**).

- **Java** ka 7 ditë.

- Muaji ka 30 ditë ose 31 ditë (muaji shkurt ka 28 ose 29 ditë).

- **Viti** ka 12 muaj. Viti ka 365 ose 366 ditë. Viti me 366 ditë quhet i **brishtë**. Në këtë vit, muaji shkurt ka 29 ditë.

- **Shekulli** ka 100 vjet.

Si kalohet nga njëra njësi në tjetrën. Vrojtohen shembujt e zgjidhur në rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të organizuar në grupe për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar”. Me ndihmën e orëve model, nxënësit iu kërkojnë shokëve të lexojnë orën në sistemin 12 orësh. Bashkëbisedohet për ushtrim 5, ku kemi përdorim në praktikë të njësive të kohës ku jepet koha që zgjati fluturimi i parë i anijes kozmike në Hënë, kur u nis dhe kur mbërriti ajo.

Në grupe të vogla dyshe punohen ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”. Zgjidhja e tyre prezantohet dhe në tabelë pasi është konkluduar për saktësinë e përgjigjes.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në renditjen e njësive të matjes së kohës, njësisë themelore, shumëfishat e saj, leximin e orës në sistemin 12-orësh dhe 24-orësh, zgjidhjen e situatave praktike të veprimeve njësitë e kohës dhe argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

Të kërkojnë materiale për udhëtimin e parë të anijes kozmike në Hënë.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24-orësh;
- Përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

VIII.8 Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Veprime me njësitë e kohës**

**FJALËT KYÇE: koha, ora, minuta, sekonda, dita, java, muaji, viti, dekada, sistemi 24-orësh, sistemi 12-orësh, koha zonale, tabela të orareve**

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- kalon nga një njësi në tjetrën duke argumentuar veprimet;
- kryen veprimet me njësitë e matjes së kohës;
- llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24-orësh;
- përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore duke arsyetuar veprimet e kryera.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, peshore, sahatë dhe orë elektronike, tabela të orareve në sistemin 24-orësh

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të njësive të matjes së kohës.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla/loja me role**

Mësuesi/ja fton në tabelë tre ose katër nxënës. Secili prej tyre ndodhet në vende të ndryshme të botës. Pasi kanë përzgjedhur vendin ku ndodhen, nëpërmjet dhe informacionit të siguruar në internet, përcaktojnë diferencën e orës nga nxënësit që ndodhet në Kosovë.

Krijohen situata problemore nga nxënësit ku kërkohet të përcaktohet sa tregon ora në të njëjtin moment në zona të ndryshme të botës.

Nëse nisësh nga Kosova për një udhëtim, duke ditur dhe kohën sa zgjat udhëtimi, kur mbërrin në një vend tjetër.

Nëse një nxënës që ndodhet në Kosovë, është duke bërë mësim, çfarë mund të bëjë një moshatar i tij në Amerikë, në Japoni, në Francë etj.

Më pas vazhdohet loja duke u kthyer pas në kohë dhe duke shkuar më para në kohë. Për këtë përdoret dhe kalendarin.

Më pas kalohet në bashkëbisedimin për zgjidhjen e situatës problemore të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

Në datën 20 mars 2010, dielli lindi në orën 6:56 dhe perëndoi në orën 19:02. Sa kohë zgjati dita? Diskutoni.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Për të zgjidhur situatën e mësipërme nxënësit do të kryejnë veprime me njësitë e kohës.

Duhet të gjejnë ndryshimin 19 h 02 min – 6 h 56 min. Kërkohet të kryhen veprimet në dy mënyra:

a) Duke i kthyer në njësinë më të vogël.

$$19 \text{ h } 02 \text{ min} = 19 \cdot 60 \text{ min} + 2 \text{ min} = 1140 \text{ min} + 2 \text{ min} = 1142 \text{ min.}$$

$$6 \text{ h } 56 \text{ min} = 6 \cdot 60 \text{ min} + 56 \text{ min} = 360 \text{ min} + 56 \text{ min} = 416 \text{ min.}$$

$$\text{Kemi } 1142 \text{ min} - 416 \text{ min} = 726 \text{ min.}$$

b) Duke i mbajtur siç janë dhe duke kryer veprimet në shtyllë

Kryejmë zbritjen në shtyllë.

$$19 \text{ h } 02 \text{ min} = 18 \text{ h} + 1 \text{ h } 02 \text{ min} = 18 \text{ h } 62 \text{ min.}$$

$$18 \text{ h } 62 \text{ min}$$

$$\underline{- 6 \text{ h } 56 \text{ min}}$$

$$12 \text{ h } 6 \text{ min}$$

A kemi të njëjtin përfundim? Cilën mënyrë përdorni më shumë në jetën e përditshme?

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**”. Bashkëbisedohet për ushtrim 3 ku kemi përdorim në praktikë të njësive të kohës ku jepet koha e udhëtimit të magelanit. Magelani u nis nga Spanja për udhëtimin rreth botës në 10 gusht 1519. Anija e tij u kthye në Spanjë në 6 shtator 1522. Sa kohë zgjati lundrimi?

Në grupe të vogla dyshe punohen ushtrimet e ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”, ku nxënësit orientohen me ndihmën e tabelave të orareve në sistemin 24-orësh.

Zgjidhja e tyre prezantohet dhe në tabelë pasi është përfunduar, për të treguar saktësinë e përgjigjes.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në gjetjen e orës në vende të ndryshme të botës në të njëjtin moment, për orientimin dhe përdorimin e tabelave të orareve, në llogaritjen e kohës duke përdorur kalendarin, në kryerjen e veprimeve me njësitë e kohës, në zgjidhjen e situatave praktike të veprimeve njësitë e kohës dhe argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato. Të kërkojnë material për zonat kohore.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

### **Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje, në një rast konkret.
- Këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.
- Kryen matje të gjatësisë, masës dhe kohës.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Nxënësit e enëve (vëllimi i lëngjeve në to)*

FJALËT KYÇE: nxënësia, njësitë e nxënësisë, litri, decilitri, centilitri, mililitri, hektolitri

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- rendit njësitë e nxënësisë;
- kalon nga njëra njësi në tjetrën duke argumentuar veprime;
- mat vëllimin e lëngut me ndihmën e enës së shkallëzuar;
- argumenton zgjidhjen e situatës problemore duke arsyetuar veprimet e kryera.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, enë të shkallëzuara.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të njësive të matjes së nxënësisë, lidhja me njësitë e vëllimit.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe të vogla/loja me role**

Mësuesi/ja njih nxënësit me disa enë të shkallëzuara. Vrojtohet në cilën njësi janë të shkallëzuar. I mbushim me ujë. Dhe nxënësit lexojnë sasinë e lëngut që është në enë. E përsërisim veprimin disa herë.


Më pas kalohet në bashkëbisedimin për zgjidhjen e situatës problemore të dhënë në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”.

Për të bërë një përzierje lëng frutash, Beni përdori 4 lloje: lëng portokalli, qitroje, shege dhe limoni, në sasinë e treguara në figurën 10.10.

a) Ç’sasi lëngu përmban secila gotë?

b) Ç’sasi lëngu mori Beni pasi i përzjeu të katra lëngjet?


Bashkëbisedohet për të gjetur sasinë e lëngut që përftohet po t’i përziejmë të katra lëngjet.



**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/organizuesi grafik**

Për të zgjidhur situatën e mësipërme, nxënësit kujtojnë njësitet e nxënësishë, lidhjen e tyre me njësitet e vëllimit.

Me ndihmën e organizuesit, organizon njohuritë.



Si do të kryhen veprimet me njësitet e matjes së nxënësishë?

Vrojtohen shembujt e zgjidhur në tekst.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit, të ndarë në grupe, për të punuar detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**”. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 ku kemi përdorim në praktikë të njësive të matjes së nxënësishë.

Trupi i një njeriu të rritur humb (në ditë) ujë siç tregohet më poshtë:

1,5 l për shkak të urinimit; 50 cl nga djersitja; 500 ml nga frymënxjerrja.

Sa l ujë humb në ditë (mesatarisht) trupi i një njeriu të rritur?

Në grupe të vogla dyshe punohen ushtrimet e ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”. Zgjidhja e tyre prezantohet dhe në tabelë nga përfaqësues të grupeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në renditjen e njësive të nxënësishë, për kalimin nga njëra njësi në tjetrën duke përdorur dhe numrat dhjetorë, në kryerjen e veprimeve me njësitet e nxënësishë, në zgjidhjen e situatave praktike të veprimeve njësitet e nxënësishë dhe argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Matje madhësish të tjera

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Shndërron valutat e monedhave që përdoren në vendin tonë dhe vendet e tjera.
- Përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje, në një rast konkret.
- Këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes.
- Zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato.
- Kryen matje të masës, kohës dhe nxënësisë.
- Lexon dhe përdor sistemin 24-orësh.
- Llogarit kohën, duke përdor njësitë matëse (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada, shekuj, mijëvjeçarë).
- Llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24-orësh.
- Përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur matje.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Çfarë mësuam (përsëritje)

**FJALËT KYÇE:** monedhat dhe kartëmonedhat, njësitë e matjes së kohës, masës dhe nxënësisë, kalimin nga një njësi në tjetrën, veprimet me njësitë e matjes.

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- shndërron valutat e monedhave që përdoren në vendin tonë dhe vendet e tjera;

- përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje, në një rast konkret;
- këmben njësitë e matjes me numra dhjetorë deri në dy shifra pas presjes;
- zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato;
- kryen matje të masës, kohës dhe nxënësisë;
- lexon dhe përdor sistemin 24-orësh;
- llogarit kohën, duke përdorur njësitë matëse (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada, shekuj, mijëvjeçarë); llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24-orësh;
- përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur matje.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
cila monedhë përdoret në jetën e përditshme; në cilat vende të tjera përdoret kjo monedhë;	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa euro na bëhen nëse kemi 2 kartëmonedha 100 euro dhe 4 kartëmonedha 50 euro?</li> <li>2. Nëse keni 150 euro. Shtoni dy kartëmonedha për të pasur shumën 270 euro. Cilat janë ato?</li> </ol>
si zgjidhet mjeti dhe njësia e përshtatshme gjatë një matje në një rast konkret.	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Zgjidhni njësinë matëse për të matur masën e : a) një libri; b) një lapsi; c) një automjeti.</li> <li>4. Ç'njësi do të zgjidhni për të matur secilën kohëzgjatje: a) orën e mësimit (sekonda, minuta, orë); b) noti për 100 m (sekonda, minuta, orë); c) rrotullim i Tokës rreth diellit (ditë, vite, shekuj).</li> <li>5. Plotësoni me njësinë e duhur. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një lugë çaj përmban 10... .</li> <li>• Një shishe verë përmban 1... .</li> </ul> </li> </ol>
.....	.....
.....	.....

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përgjigjet e dhëna në veprimet me monedhat dhe kartëmonedhat, në renditjen e njësive të matjes, kalimet nga njëra njësi në tjetrën, veprimet me njësitë e matjes, përdorimin e njohurive në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore dhe të veprimeve të kryera.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ▽TEMA 11

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Simetria sipas një drejtëze (simetria boshtore)*

**FJALËT KYÇE:** bosht numerik, dyshe e renditur, koordinatat e pikës, abshisë, ordinatë, rrjet koordinativ, kuadrate

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- konstrukton rrjetin koordinativ në rrafsh;
- dallon boshtin e abshisave dhe të ordinatave; bashkësisë ose jo;
- paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës;
- argumenton veprimet e kryera.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, vizore, letër me kutia

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme të përcaktimit të vendndodhjes.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t’i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.


- Era dhe Agimi prenë bileta për në kinema. Në biletën e Erës, vendi i saj përcaktohej nga numrat (3; 8), ndërsa në biletën e Agimit ishin shënuar numrat (8; 3).

- Jemi në të njëjtin vend, – thotë Agimi.
- Jo, jemi në vende të ndryshme, – i përgjigjet Era.

Cili ka të drejtë? Argumentoni përgjigjen. A tregojnë dy dyshet e renditura të njëjtin vend në sallën e kinemasë?

Bashkëbisedoni me shokun/shoqen.

- Kujtoni si jepen koordinatat e pikave në bosht. Vizatohet një bosht numerik. Kujtohet që çdo numri i takon një pikë në bosht dhe anasjellas.



Diskutimi i situatave të mësipërme nga nxënësit do të çojë në trajtimin e koncepteve të reja të njësisë mësimore. Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë dinë për vendndodhjen e pikës në boshtin numerik. Si dhe si të gjejnë vendndodhjen e pikës në rrafsh.

Di?	Dua të di?	Mësova
Boshtin numerik	Të tregoj vendndodhjen e një pike në rrafsh	Rrjetin koordinativ në rrafsh
Tregoj vendndodhjen e një pike në bosht.		Boshtin e abshisave
Koordinatën e pikës në bosht.	.....	Boshtin e ordinatave
.....		Kuadratet
		Koordinatat e pikës (x; y)
		Dyshe e renditur.
		Vendndodhjen e pikës në rrafshin koordinativ.
		.....

Vrojtohen shembujt e dhënë në rubrikën “Vrojtoj dhe mësoj”, si të gjejnë koordinatat e një pikë në rrafshin koordinativ dhe anasjellas, të gjejnë vendndodhjen e pikës në rrafsh kur njihen koordinatat e pikës.

Lojë me role. Në klasë mund të krijohet modeli i një rrafshi koordinativ. Nxënësit të përcaktojnë vendndodhjen e tyre në këtë model.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të diskutojnë detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke

i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 3. Tregohet vendndodhja e dysheve të renditura që përftohen (numri i fletoreve). Diskutohet cila nga madhësitë do të vendosen në boshtin e abshisave dhe cila në boshtin e ordinatave.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e konstruktimit të sistemit kënddrejtë në rrafsh, përcaktimit të vendndodhjes së dyshe së renditur në rrafshin koordinativ, dhe anasjellas, për gjetjen e dyshes së renditur për një pikë çfarë do të rrafshit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijës.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.  
8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Simetria sipas një drejtëze (simetria boshtore)*

FJALËT KYÇE: drejtëz (bosht) simetrie, fytyrë, shëmbëllim

**Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- dallon figurat me bosht simetrie;
- konstruktin shëmbëllim e një pike sipas një drejtëze të simetrisë;
- gjen boshtet e simetrisë në figura të ndryshme me anë të vizatimit dhe Geogebra;
- demonstroi përdorimin e drejtëzës së simetrisë në situata praktike.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, disa objekte që kanë drejtëza simetrie, si dhe foto të marra nga interneti, Lap-top

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, arti, arkitektura

Shembuj nga jeta e përditshme të objekteve që kanë drejtëza simetrie

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë "Kërkoni dhe zbuloni".

Tregohen foto në natyrë të figurave që kanë drejtëz simetrie.

Tek bimët, në gjallesat, në ndërtimet, në arkitekturë, në mozaikët e ndryshëm etj.

Sjellin shembuj të objekteve në klasë që kanë drejtëza simetrie.

Punë në grup:

Merrni një fletë letre. Tërhiqni në të një drejtëz dhe paloseni fletën sipas kësaj drejtëze. Shpojeni fletën e palosur me një gjilpërë. Më pas, hapeni plotësisht atë. Çfarë vini re?



Bashkoni dy pikat që morët. Kontrolloni me trekëndëshin e vizatimit si është kjo drejtëz me drejtëzën që tërhoqët në fillim? Si janë largesat e dy pikave nga x drejtëza që tërhoqët?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/organizuesi grafik/INSERT**

Diskutimi i situatave të mësipërme do të kërkojë trajtimin e koncepteve:



Kërkohet nga nxënësit të lexojnë rubrikën e dytë të njësise mësimore “Vrojtoni dhe mësoni”. Gjatë leximit, ata do të vendosin në fund të çdo informate nga një simbol që tregon se si e kanë kuptuar atë informatë.

“√” – nëse informacioni është i njohur për ju;

“+” – nëse informacioni është i ri;

“?” – nëse informacioni është i paqartë;

“–” – nëse informacioni që lexuat është ndryshe nga ai që e dinit më parë.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim

Ftohen nxënësit të diskutojnë detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 ku kemi një shembull nga praktika të tabelave të sinjaleve rrugore që kanë ose jo drejtëza simetrie. Cilat prej tyre kanë dhe cilat jo. Sillen shembuj të tjerë të sinjaleve rrugore që kanë boshte simetrie.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t’i provojnë edhe përmes programit Geogebra duke i diskutuar me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e konstruktimit të shëmbëllimit të një pike në lidhje me një drejtëz, gjetjen e boshteve të simetrisë në figura, sjelljen e shembujve nga objektet reale që kanë drejtëz simetrie.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon simetrinë boshtore.
- Cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

8.1 Përdor teknologjinë për hulumtime, kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Simetria boshtore në rrafshin koordinativ

**FJALËT KYÇE:** drejtëz (bosht) simetrie, fytyrë, shëmbëllim, simetri në rrafshin koordinativ, sipas  $Ox$  dhe  $Oy$ .

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- gjen pikën simetrike të një pike të dhënë sipas boshteve  $Ox$  dhe  $Oy$ ;
- konstrukton shëmbëllim e një figure pike sipas boshteve  $Ox$  dhe  $Oy$ ;
- demonstroi përdorimin e drejtëzës së simetrisë në situata praktike;
- përdor programin Geogebra për të gjetur pikën simetrike të një pike sipas boshteve  $Ox$  dhe  $Oy$ .

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, disa objekte që kanë drejtëza simetrie, si dhe foto të marra nga interneti, lap-top

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, arti, arkitektura

Shembuj nga jeta e përditshme të objekteve që kanë drejtëza simetrie

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe/bashkëbisedim

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.


- Ndërtoni në fletën me katrore një sistem kënddrejtë koordinativ dhe merrni në të pikën A (3; +2).
- Ndërtoni pikën simetrike të pikës A në lidhje me boshtin e abshisave dhe gjeni koordinatat e saj.
- Ndërtoni pikën simetrike të A në lidhje me boshtin y'y dhe gjeni koordinatat e saj.
- Përsëriteni ushtrimin duke marrë pika të tjera në rrafsh.
- Merrni një pikë. Kërkoni nga shoku të gjejë koordinatat në sistemin koordinativ. Të gjejë simetrikën e pikës sipas boshtit Ox dhe Oy.

Ç’vini re? Bashkëbisedoni me shokun/shoqen.

Punohet njëkohësisht dhe në tabelë me dy ose tre nxënës.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/organizuesi grafik/insert**

Diskutimi i situatave të mësipërme, do të kërkojë trajtimin e koncepteve:



Jepen shembuj nga nxënësit të pikave simetrike në lidhje me Ox dhe Oy.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të punojnë dhe të diskutojnë detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 3 ku kërkohet të vrojtohet largesave ndërmjet pikave simetrike. Nga diskutimet do të vërehet që kjo largesë është e njëjtë me largesën ndërmjet pikave fytyrë.

Ju jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “**Ushtrime**”.

Detyrat e zgjidhura do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en. Disa nga shembujt do t’i paraqesin përmes programit GeoGebra.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e konstruktimit të shëmbëllimit të një pike në lidhje me një drejtëz, gjetjen e boshteve të simetrisë në figura, sjelljen e shembujve nga objektet realë që kanë drejtëz simetrie.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përshkruan trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre;
- përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).
- Përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit).

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Shumëfaqëshet**

**FJALËT KYÇE:** brinjë, kulme, faqe shumëfaqësh, trup rrotullues

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon shumëfaqëshet duke i prezantuar vetitë e tyre përmes punimeve dhe vizatimeve;
- dallon shumëfaqëshet nga trupat rrotullues duke i analizuar të dyja llojet;
- emërton elementet e shumëfaqësheve duke i caktuar për disa lloje;
- zbaton format shumëfaqëshe të mësura në objekte dhe sende që i rrethojnë.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, plastelinë, fije shkrepëse

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna,

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma shumëfaqëshe.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grup**

Mësuesi/ja fton nxënësit që të punojnë në grup detyrën e dhënë.

Ndërtoni me plastelinë dhe fije shkrepësesh modelin e një kubi.

Sa fije shkrepësesh duhen?

Me këtë sasi plasteline, ndërtoni modelet e trupave të tjerë që ju kujtohen.

Cili prej tyre është shumëfaqësh?

Pyetjeve do t'u përgjigjen duke shkruar në fletore dhe kur të kenë përfunduar nga një nxënës do të prezantojë nga secili grup.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore, përkatësisht rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Ata do të diskutojnë në grupe për trupat gjeometrik, karakteristikat e të cilëve i lexuan.

Duke komentuar vetitë e trupave, dallojnë shumëfaqëshet nga trupat rrotullues. Mësuesi/ja do të kërkojë nga secili grup të vizatojë dhe ta prezantojë para klasës njërin nga shumëfaqëshet e mësuara. Njëri grup do ta ketë për detyrë të prezantojë trupat rrotullues duke argumentuar pse ata nuk mund të hyjnë në grupin e shumëfaqësheve.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Analizë e tipareve semantike**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga një fletë A4 ku është dhënë tabela të cilën duhet plotësuar.

Shumëfaqëshi	Numri i faqeve (F)	Numri i brinjëve (B)	Numri i kulmeve (K)	$F + K - 2 = B$
Kubi	6	12	8	
Kuboidi				
Prizmi trekëndor	5	9	6	
Prizmi gjashtëkëndor				
Piramida trekëndore				
Piramida katërkëndore	5	8	5	
Piramida gjashtëkëndore				

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet për çdo pyetje që bëjnë dhe përgjigje që japin dhe punën në grupe. Do të vlerësohen edhe për shembujt me të cilat do të konkretizojnë shumëfaqëshet.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kubi

FJALËT KYÇE: brinjë, kulme, faqe, kub, syprina e sipërfaqes, vëllimi

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- përkufizon kubin duke i prezantuar vetitë e tij përmes punimeve dhe vizatimeve;
- dallon kubin nga shumëfaqëshet e tjerë duke i përmendur karakteristikat e tij;
- emërton elementet e kubit duke i caktuar në vizatim dhe në punim me kube lidhëse;
- njehson syprinën dhe vëllimin e kubit duke u bazuar në syprinën e katrorit prej të cilit formohet.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, kube lidhëse, letër me ngjyrë, gërshërë, ngjitës

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Jeta dhe puna,

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma kubike.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grup**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe “kube shumë lidhëse” dhe kërkon nga nxënësit që me to të ndërtojnë nga një kub.

Ai/ajo pyet:

Sa kube lidhëse ju deshën për të ndërtuar kubin?

Si mund ta arsyetoni këtë?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela T**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore përkatësisht rubrikën “**Vrojtoni dhe mësoni**”. Ata do të shtrojnë pyetjet dhe do të përgjigjen duke plotësuar tabelën.

Pyetje	Përgjigje
Sa faqe ka kubi?	Kubi ka gjashtë faqe.
Çfarë figura janë faqet e kubit?	Faqet e kubit janë katrorë të barabartë.
Sa kulme ka kubi?	Kubi ka tetë kulme.
Numëro sa brinjë i ka kubi.	Kubi ka dymbëdhjetë brinjë
Si gjendet syprina e sipërfaqes së kubit?	Syprina e sipërfaqes së kubit gjendet duke i mbledhur syprinat e gjashtë faqeve të tij katrore.
.....	.....

Tabelën do ta vizatojë edhe mësuesi/ja në tabelë dhe do ta plotësojë duke i marrë pyetjet dhe përgjigjet nga nxënësit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punime dore**

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga një letër me ngjyrë, gërshërë dhe ngjitës. Ai/ajo kërkon nga nxënësit që të punojnë një kub me gjatësi të brinjës  $a = 4$  cm. Kubit të punuar t’ia njehsojnë syprinën e sipërfaqes dhe vëllimin.

Punimet do t'i vlerësojë nga një nxënës nga secili grup.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për çdo pyetje që bëjnë dhe përgjigje që japin dhe punën në grupe. Do të vlerësohen edhe për shembujt me të cilat do të konkretizojnë kubet. Në pjesën e fundit të orës vlerësimin do ta bëjnë nxënësit përmes vlerësimit të ndërsjellë.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

### Rezultati i të nxënësit të temës:

- Përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin)
- përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).

### Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.2 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.2 Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Kuboidi

FJALËT KYÇE: brinjë, kulme, faqe, kuboidi, syprina e sipërfaqes, vëllim

#### Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përkufizon kuboidin duke i prezantuar vetitë e tij përmes punimeve dhe vizatimeve;
- dallon kuboidin nga shumëfaqëshet e tjera duke i përmendur karakteristikat e tij;
- emërton elementet e kuboidit duke i caktuar në vizatim dhe në punim me kube lidhëse;
- njehson syprinën dhe vëllimin e kuboidit duke u bazuar në syprinën e faqeve drejtkëndëshe prej të cilave formohet ai dhe tri përmasave (gjatësi, gjerësi, lartësi).

#### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, kube lidhëse, letër me ngjyrë, gërshërë, ngjites

#### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma kuboide.


## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

#### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grup

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe materialet (letër e fortë, gërshërë dhe ngjites). Fton nxënësit të punojnë nga një kuboid me përmasa të atilla që më vonë ta përdorin për të mbajtur lapsat në të.

#### Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re mësimore përkatësisht rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Njohuritë për kuboidin do t'i paraqesin përmes hartës së mëndjes.



Të gjitha karakteristikat e kuboidit do të diskutohen me klasën duke i konkretizuar me punimin e ndërtuar nga secili grup në fillim.

#### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Aktivitet në grup

Mësuesi/ja fton nxënësit që në kutitë që i punuan në fillim të orës në formë kuboidi të punojnë sipas udhëzimeve që u jepen. Pasi do ta përdorin kutinë për lapsa, ata/ato do ta dekorojnë.

Për të zbukuruar kutinë ku do të mbani lapsat, ju do të ngjiti nga:

- një lule në çdo faqe;
  - një yll në çdo kulm;
  - një shirit në çdo brinjë.
- Sa lule, sa yje e sa shirita ju duhen?

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për çdo pyetje që bëjnë dhe përgjigje që japin dhe punën në grupe. Do të vlerësohen edhe për punimet me të cilat do të konkretizojnë kuboidin.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

6.2 Krijon modele të thjeshta të figurave gjeometrike dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Hapja e kubit dhe kuboidit**

FJALËT KYÇE: brinjë, kulme, faqe, kub, kuboid

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

- dallon hapjen e kubit përkatësisht kuboidit nga shumëkëndëshat që nuk paraqesin hapje të tyre;
- emërtton shumëkëndëshat e fituar nga hapja e kubit dhe kuboidit të punuar më parë;
- ndërton hapjet e kubit dhe kuboidit bazuar në dimensionet e dhëna.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, kube lidhëse, letër me ngjyrë, gërshërë

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Jeta dhe puna

Shembuj të objekteve të ndryshme që na rrethojnë e që kanë forma të hapjeve të kubit dhe kuboidit

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Aktivitet në grup

Mësuesi/ja fton nxënësit që në grupe të punojnë duke bërë hapjen e kubit ose kuboidit që e kanë punuar më herët. Kur të hapet njëri nga trupat e përmendur, fitohet një shumëkëndësh.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë e re mësimore në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”. Pasi të përfundojnë leximin ai/ajo kërkon nga nxënësit që të komentojnë prerjet e fituara nga kubi dhe kuboidi që i punuan më parë.

Sipërfaqja shumëkëndëshe e fituar e kubit, quhet hapje e kubit.

Shumëkëndëshi i fituar nga hapja e kuboidit quhet hapje e kuboidit.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Aktivitet në grup

Mësuesi/ja shpërndanë në grupe nga një letër me ngjyrë dhe gërshërë. Kërkon nga nxënësit që të punojnë detyrat:

Grupi i parë punon hapjen e një kubi me brinjë  $a = 3$  cm.

Grupi i dytë punon hapjen e një kuboidi me përmasa  $a = 2$  cm,  $b = 3$  cm dhe  $c = 5$  cm.

Grupi i tretë punon hapjen e një kutie në formë kubi pa kapak (hapur).

Grupi i katërt punon hapjen e një kutie në formë kuboidi pa kapak (hapur).

Grupi i pestë punon një shumëkëndësh që nuk paraqet hapjen e kubit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për çdo pyetje që bëjnë dhe përgjigje që japin dhe punën në grupe. Do të vlerësohen edhe për shembujt me të cilat do të konkretizojnë hapjet e kubit dhe kuboidit. Në pjesën e fundit të orës vlerësimin do ta bëjnë nxënësit përmes vlerësimit të ndërsjellë të grupeve.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

### Rezultati i të nxënësve të temës:

- Paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës.
- Përkufizon simetrinë boshtore.
- Cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave.
- Përshkruan trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre.
- Përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin).
- Përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).
- Përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit).
- Paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)**

**FJALËT KYÇE:** dyshe e renditur, koordinatat e pikës, abshisa, ordinata, boshtet koordinative, kuadrate, simetria boshtore, boshti i simetrisë, trup gjeometrik, shumëfaqësh, kub, kuboid, kulme, brinjë, faqe, hapje te trupave në rrafsh, formula e Eulerit.

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës;
- përkufizon simetrinë boshtore;
- cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave;
- përshkruan trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre;
- përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin);
- përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet);
- përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit);
- paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, arkitektura

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**  
Nxiten nxënësit të kujtojnë se çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
çfarë paraqet çdo dyshe e renditur në rrafshin Oxy; çfarë tregojnë x dhe y;	1. Ndërtoni një sistem kënddrejtë koordinativ dhe shënoni në të pikat A (-2; 3), B (-1; 4), C (-3; -2), D (0; -3), E (2; 0). 2. Jepen pikat A (1; 3), B (-1; 4), C (7; -5), D (0; 6), E (2,5; 0), F (-3; 3). Cilat nga këto pika ndodhet: a) mbi boshtin e abshisave? b) në të majtë të boshtit të ordinatave?
si veprohet për të identifikuar koordinatat e pikës;	3. Gjeni koordinatat e pikave A, B, C, D në figurën 11.53.
kur një figurë ka bosht simetrie;	4. Tregoni figura nga jeta reale që kanë boshte simetrie.
të përcaktojmë sa drejtëza simetrie ka një shumëkëndësh.	5. Sa drejtëza simetrie ka: • një trekëndësh dybrinjënjëshëm? • një trekëndësh barabrinjës? • një pesëkëndësh i rregullt? • një gjashtëkëndësh i rregullt?
.....	.....

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të vendndodhjes së pikës në rrafsh me ndihmën e dysheve të renditur, gjetjen e koordinatave të pikës, abshisës dhe ordinatës, gjetjen e figurave me boshte simetrie, gjetjen e figurës simetrike në sistemin koordinativ në rrafsh, emërtimin e shumëfaqësheve, gjetjen e numrit të brinjëve, kulmeve dhe faqeve, vetitë e kubit dhe kuboidit, konstruktimin e hapjes së tyre, përdorimin e koncepteve në situata problemore nga veprimtaria e përditshme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

**----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----****ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Shndërrimet gjeometrike dhe trupat gjeometrikë**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Paraqet pikën si dyshe të renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës.
- Përkufizon simetrinë boshtore.
- Cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave.
- Përshkruan trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre.
- Përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin).
- Përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).
- Përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit).
- Paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE*****Njësia mësimore: Vlerësim***

**FJALËT KYÇE:** dyshe e renditur, koordinatat e pikës, abshisa, ordinata, boshtet koordinative, kuadrate, simetria boshtore, boshti i simetrisë, trup gjeometrik, shumëfaqësh, kub, kuboid, kulme, brinjë, faqe, hapje te trupave në rrafsh, formula e Eulerit.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës;
- përkufizon simetrinë boshtore;
- cakton numrin e drejtëzave të simetrisë së figurave;
- përshkruan trupat gjeometrikë, sipas vetive të tyre;
- përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin);
- përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet);
- përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit);
- paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku  
Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të vendndodhjes së pikës në rrafsh me ndihmën e dyshes së renditur, gjetjen e koordinatave të pikës, abshisës dhe ordinatës, gjetjen e figurave me boshte simetrie, gjetjen e figurës simetrike në sistemin koordinativ në rrafsh, emërtimin e shumëfaqësheve, gjetjen e numrit të brinjëve, kulmeve dhe faqeve, vetitë e kubit dhe kuboidit, konstruktimin e hapjes së tyre, përdorimin e koncepteve në situata problemore nga veprimtaria e përditshme.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# TEMA 12

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** *Kuptimi i bashkësisë dhe ndryshorja*

**FJALËT KYÇE:** bashkësi, elementë të bashkësisë, ndryshore, bën pjesë, nuk bën pjesë, emërtim, diagram Veni, përshkrim

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon rastet kur disa objekte formojnë bashkësi;
- tregon me simbole objektin që është element i bashkësisë ose jo;
- tregon bashkësinë me tri mënyra: emërtim, me diagram, përshkrim;
- tregon shembuj objektësh nga jeta e përditshme që formojnë bashkësi.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, disa objekte: si libra shkollor, trupa gjeometrik etj., me të cilët të formojmë bashkësi.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme të objekteve që formojnë bashkësi

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst:

- A i përket mali i Pashtrikut bashkësisë së maleve të larta?
- Po bashkësisë së maleve me lartësi nën 2000 m?
- Tregoni male të tjera që i përkasin kësaj bashkësie.
- Çfarë kuptoni me fjalën “bashkësi”?

Sillen shembuj të tjerë nga nxënësit të rasteve kur objektet formojnë bashkësi si dhe rastet kur nuk formojnë bashkësi:

A formojnë bashkësi:


Vajzat e klasës tonë.

Djemtë më të shkathët të klasës.

Argumentoni përgjigjen.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/organizuesi grafik**

Diskutimi i situatave të mësipërme, do të çojë në dallimin kur një grup objektesh formon bashkësi.



Nxiten nxënësit të japin shembuj të bashkësive. Të tregojnë elementet e tyre me një nga mënyrat e dhënies së funksionit.

A mund të tregojmë me emërtim ose me diagram Veni bashkësinë e numrave natyrorë? Bashkësinë e numrave çift? Pse?

Përdorimi i ndryshores për të treguar elementet e një bashkësie.

Vrojtohen shembujt e dhënë në rubrikën “Vrojtoj dhe mësoj”.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të diskutojnë detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 ku kemi një shembull nga praktika të objekteve që formojnë ose jo bashkësi.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të grupit të objekteve që tregojnë bashkësi, të gjetjes së elementeve të një bashkësie, të paraqitjes së bashkësisë në tri mënyra, përdorimin e konceptit të bashkësisë në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore: Çiftimi (shoqërimi) i elementeve të dy bashkësive**

**FJALËT KYÇE:** bashkësi, elemente të bashkësisë, ndryshore, bën pjesë, nuk bën pjesë, emërtim, diagram Veni, përshkrim, çiftimi i elementëve, dyshet e radhitura.

### Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- lidh elementet e dy bashkësive si pas një rregulli të dhënë;
- tregon çiftimin e dy elementeve të dy bashkësive më ndihmën e diagramit;
- tregon çiftimin e dy elementeve të dy bashkësive më ndihmën e tabelës;
- shpreh më fjalë rregullin e shoqërimit të elementeve të dy bashkësive.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, disa objekte: si libra shkollor etj. me të cilët të formojmë bashkësi.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

Shembuj nga jeta e përditshme të objekteve që formojnë bashkësi.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/bashkëbisedim.

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”:

- Shkolla ka 400 nxënës. A ka aty dy nxënës që e kanë datëlindjen në të njëjtën ditë të vitit?
- Cilin numër rendor keni ju në ditarë? A ka nxënës me dy numra rendorë?

Diskutoni.

Në rastin e parë kush janë dy bashkësitë elementet e të cilave do të shoqërojmë?


Po kështu dhe në rastin e dytë.

Çilët janë dyshet e renditura në secilin rast?

Nxiten nxënësit të sjellin shembuj të shoqërimit të elementeve të dy bashkësive nga veprimtaria e tyre e përditshme.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Hartë sementale

Nga zgjidhja e situatave problemore të rubrikës së parë, jepet koncepti i dyshes së renditur me element të parë nga bashkësia A dhe element të dytë nga bashkësia B.



Diskutim: A janë të njëjta dyshet e renditura me element të parë nga A dhe element të dytë nga B me dyshen e renditur me element të parë nga B dhe element të dytë nga B? Jepni shembuj. Shqyrtohen disa shembuj dhe nxënësit dalin në përfundim: janë të ndryshme. Vrojtohen shembujt e zgjidhur në tekst te rubrika e dytë “Vrojtoni dhe mësoni”.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit të punojnë në grupe të vogla detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 5 ku kërkohet që të pyeten nxënësit e klasës se tyre se cila lëndë iu pëlqen më shumë.

Dy nxënës në tabelë tregojnë dyshe të renditura sipas rregullit:

“x është lënda më e pëlqyer e y”.

“x-it i pëlqen më shumë lënda y”.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të grupit të objekteve që tregojnë bashkësi, të gjetjes së elementeve të një bashkësie, të paraqitjes së bashkësisë në tri mënyra, të formojnë dyshe të renditura me element të parë nga bashkësia A dhe element të dytë nga bashkësia B, përdorimin e konceptit të bashkësisë në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.3 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Funkzioni**

FJALËT KYÇE: **bashkësi, ndryshore, emërtim, diagram Veni, përshkrim, çiftimi i elementeve, dyshet e radhitura, funksion**

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- dallon kur lidhja ndërmjet dy bashkësive është funksion;
- paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura;
- tregon bashkësinë e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësinë e vlerave të funksionit (kodomena);
- argumenton zgjidhjen e situatave problemore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të objekteve që formojnë bashkësi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/bashkëbisedim.**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën "Kërkoni dhe zbuloni":

- Shoqëroni elementet e bashkësisë P me elementet e bashkësisë Q sipas rregullës:


- a) "x është pjesëtues i y";
- b) "x është 4 njësi më i vogël se y";
- c) "katrori i x është y".

Tregoni me diagram me shigjeta secilin nga rastet.

Bashkëbisedoni me shokun. Çfarë vini re? Nxiten nxënësit të sjellin shembuj të shoqërimit të elementeve të dy bashkësive nga veprimtaria e tyre e përditshme.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Hartë sementale**

Nga zgjidhja e situatave problemore të rubrikës së parë, nxënësit duke shoqëruar elementet e bashkësisë së parë me atë të dytë do të marrin diagramet shigjetore si më poshtë:



Në rastin e tretë, ku çdo element i bashkësisë së parë shoqërohet me një dhe vetëm një element të bashkësisë së dytë, është funksion.

Di?	Dua të di?	Mësova
Të shoqëroj elementet e bashkësisë së parë me elementet e bashkësisë së dytë sipas një rregulli të dhënë.  Të tregoj më tabelë, diagram e dyshe të renditura  .....	Kur lidhja ndërmjet dy bashkësive është funksion?  .....	Funksioni $f: A \rightarrow B$  bashkësinë e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit),  bashkësinë e vlerave të funksionit (kodomena)  Si jepet funksioni  .....

Vrojtohen shembujt e zgjidhur në tekst të rubrika e dytë “Vrojtoni dhe mësoni”.

Punë në grup

Jepni shembuj të shoqërimit të dy bashkësive. Tregoni raste kur ky shoqërim është funksion.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla**

Ftohen nxënësit të diskutojnë detyrat 1 dhe 2 të dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 3 ku është dhënë një shembull i zbatimit praktik të kuptimit të funksionit.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t’i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë e dallimit kur një lidhje ndërmjet dy bashkësive është funksion, gjetjen e bashkësisë së përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësisë së vlerave të funksionit (kodomena), të paraqitjes së funksionit me dyshe të renditura me element të parë nga bashkësia A dhe element të dytë nga bashkësia B, përdorimin e konceptit të funksionit në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Identifikon koordinatat e pikës (dyshe së renditur) në rrjetin koordinativ.
- Vendos pikat në rrjetin koordinativ.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.4 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tema: Funksione dhe vargje numerike

**FJALËT KYÇE:** dyshet e radhitura, funksioni, bashkësia e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësia e vlerave të funksionit (kodomena), tabelë, grafik

**Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- paraqet funksionin me tabelë dhe diagram;
- formon dyshtet e renditura të funksionit;
- vendos dyshtet e renditura në rrjetin koordinativ;
- tregon bashkësinë e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësinë e vlerave të funksionit (kodomena);
- argumenton zgjidhjen e situatave problemore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, letë A4 me katrorë

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të konceptit të funksionit

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**
**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”:

Shqyrtoni tabelën:

x	3	2	1	0	1	2	3
y	9	4	1	0	1	4	9

Gjeni bashkësitë e vlerave të ndryshoreve  $x$  dhe  $y$ .

Çdo vlerë të  $x$  nga rreshti i parë i tabelës shoqërojeni me vlerën e  $y$ , që ndodhet pikërisht nën të në rreshtin e dytë ( , etj.). Ju kërkohet nxënësve të shkruajnë të gjitha dyshtet e renditura. Të gjejnë vendndodhjen e këtyre dysheve në rrafshin koordinativ.

Çfarë vini re?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Di/dua të di/mësova**

Nga diskutimi për zgjidhjen e situatave problemore të rubrikës së parë, nxënësit do të marrin një bashkësi pikash në rrafshin koordinativ.

Di?	Dua të di?	Mësova
Të tregoj më tabelë, diagram e dyshtet e renditura funksionit.  Të gjej vendndodhjen e një pikë në rrafshin koordinativ.  .....	Kush është grafiku i një funksioni.  .....	Grafik i funksionit $f$ quhet bashkësia e pikave të rrafshit koordinativ $xOy$ , të cilat kanë si abshisë elemente të $A$ dhe si ordinatë vlerën përgjegjëse të funksionit.  Shembuj.  .....

Nxiten nxënësit të plotësojnë vetë tabelën e mësipërme.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të diskutojnë për detyrën 1 dhe 2 të dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar” duke i komentuar përgjigjet. Bashkëbisedohet për ushtrim 3 ku kemi një shembull nga veprimtaria e përditshme e shoqërimit të bashkësive i cili është funksion.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t'i prezantojnë me radhë në “telin e tharjes” duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë e gjetjes së lidhjeve të bashkësive kur këto janë funksion, për gjetjen e domenës dhe kodomenës së një funksioni, paraqitjen e funksionit me tabelë, diagram dhe dyshe të renditura dhe me grafik, përdorimin e konceptit të funksionin në situata praktike, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

*Njësia mësimore: Vargje numerike*

**FJALËT KYÇE:** vargu, varg me figura, vargu numerik, kufiza paraardhëse dhe pasardhëse, rregulli për formimin e vargut

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- plotëson vargun me kufiza të tjera;
- dallon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa);
- zbulon rregullin e formimit të vargut;
- vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa-vendos dyshet e renditura);
- argumenton veprimet e kryera për plotësimin e kufizave të vargut.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, letë A4 me katrorë, vargje me figura

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të konceptit të funksionit.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim/punë në grup/stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”:

- Iu kërkohet të plotësojnë vargun e figurave me tri kufiza të tjera:



Nxiten nxënësit në grupe të krijojnë vargje me figura. Të kërkojnë nga shokët e grupeve të tjerë të plotësojnë vargun e formuar prej tyre si dhe të zbulojnë rregullin e formimit.

Më pas kalohet në situatën e dytë, të vargut numerik.

- Jepet vargu numerik: 9; 14; 19; 24; 29; ...; ...; ...;


Plotësojeni me tri kufiza të tjera.

Krijohen shembuj të tjerë të vargjeve nga vetë nxënësit. Këmbehen detyrat ndërmjet grupeve për plotësimin dhe zbulimin e rregullit të vargut.

Diskutohet: a mund të merren të gjitha kufizat e një vargu?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Organizimi grafik i njohurive/punë në grupe

Nga diskutimi për zgjidhjen e situatave problemore të rubrikës së parë, nxënësi/ja përmbledh njohuritë:



### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të punojnë në grupe detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” në format A4. Zgjidhjet e ushtrimeve i demonstrojnë në tabelë, ose te “teli i tharjes”.

Bashkëbisedohet për ushtrimin 6 ku kemi një shembull nga veprimtaria e përditshme e konceptit të vargut.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”. Organizohet një minikonkurs se cili nga grupet plotëson më shpejtë dhe më saktë vargjet duke shpjeguar dhe rregullin e formimit të vargut.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë e gjetjes së rregullit të plotësimit të kufizave të vargut, plotësimin me kufiza të tjera një varg numerik, gjetjen e kufizave të vargut të Fibonaccit, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

Të mësojnë më shumë për vargun e Fibonaçit dhe jetës së tij. Informacion nga burime të internetit.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.2 Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Vargje numerike në situata të ndryshme*

**FJALËT KYÇE:** vargu, varg me figura, vargu numerik, kufiza paraardhëse dhe pasardhëse, rregulli për formimin e vargut

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- zbulon rregullin e formimit të vargut;
- plotëson vargun me kufiza të tjera;
- vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa-vendos dyshet e renditura);
- argumenton veprimet e kryera për plotësimin e kufizave të vargut.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, letër A4 me katrorë, vargje me figura.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

Shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të konceptit të funksionit.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Bashkëbisedim/punë në grup/stuhi mendimesh

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën “Kërkoni dhe zbuloni”:

- Përdorni një fletë me katrorë.

a) Vizatoni në të një drejtkëndësh me gjatësi 2 njësi dhe gjerësi 1 njësi.

(1 njësi = brinja e një kutize). Numëroni dhe shënoni perimetrin e drejtkëndëshit.

b) Vizatoni një drejtkëndësh me gjatësi 3 dhe me gjerësi 2 njësi. Numëroni dhe shënoni perimetrin e tij.

c) Vazhdoni punën, duke bërë në çdo hap rritjen e gjatësisë e të gjerësisë me nga një njësi. Për secilin prej drejtkëndëshave, shënoni gjatësinë, gjerësinë dhe perimetrin.

Numri i drejtkëndëshit	Gjatësia	Gjerësia	Perimetri
1	2	1	6
2	3	2	10
3	4	3	.....
4	5	4	.....
5	6	5	.....

Plotësoni tabelën.

d) Cili është rregulli për formimin e vargut të perimetrave?

e) Sa do të jetë perimetri i drejtkëndëshit të dhjetë? Po i drejtkëndëshit të njëzetë?

f) A do të kemi drejtkëndësha me perimetër 42? Po 44? Po 46?

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe

Nga diskutimi për zgjidhjen e situatave problemore të rubrikës së parë, nxënësit zbulojnë rregullin e formimit të vargut të perimetrave të drejtkëndëshit në varësi dhe të numrit të drejtkëndëshit.

Kërkohet nga nxënësit të vrojtojnë shembullin e dhënë në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

Ku do të gjejnë rregullin e formimit të vargut të perimetrit të trekëndëshit në varësi të numrit të trekëndëshit.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe të vogla

Ftohen nxënësit të diskutojnë për ushtrimin 1 dhe 2 të dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar”. Bashkëbisedohet për ushtrim 3 ku kemi një shembull nga veprimtaria e përditshme e të konceptit të vargut.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimet e rubrikës “Ushtrime”.

Zgjidhjet e ushtrimeve demonstrohen dhe në tabelë nga përfaqësues të grupeve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë e e gjetjes së rregullit të plotësimit të kufizave të vargut, plotësimin me kufiza të tjera një varg numerik, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për detyrat e shtëpisë në Fletore pune dhe u jepen sqarime për to.

Të krijojnë vetë vargje me figura dhe numerike. Të kërkojnë nga shokët e tyre të plotësojnë vargun me disa kufiza. Të vlerësojnë punën e shokut.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.
- Identifikon koordinatat e pikës (dyshe së renditur) në rrjetin koordinativ.
- Vendos pikat në rrjetin koordinativ.
- Dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

1.3 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)*

**FJALËT KYÇE:** bashkësi, elementë të bashkësisë, ndryshore, bën pjesë, nuk bën pjesë, emërtim, diagrame Veni, përshkrim, dyshet e radhitura, funksioni, bashkësia e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësia e vlerave të funksionit (kodomena), tabelë, grafik vargu, varg me figura, vargu numerik, kufiza paraardhëse dhe pasardhëse, rregulli për formimin e vargut.

### Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ;
- identifikon koordinatat e pikës (dyshe të renditura) në rrjetin koordinativ;
- vendos pikat në rrjetin koordinativ;
- dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë  
Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
kur një grumbull elementesh formojnë bashkësi; në sa mënyra mund të përshkruhet një bashkësi;	1. Cili nga grumbujt e mëposhtëm formon bashkësi? a) ditët e bukura të javës; b) ditët e javës. 2. Paraqitni me tri mënyra bashkësinë e numrave dyshifrorë që janë shumëfisha të dhjetës.
si formohen dyshet e renditura me elementet e dy bashkësive;	3. Jepen bashkësitë $E = \{2, 4, 5\}$ dhe $F = \{1, 2\}$ . Jepni me diagram shigjetor dhe me tabelë, shoqërimin e elementeve të $E$ me ata të $F$ , sipas rregullës: “ $x$ është dy herë më i madh se $y$ ”.
kur një shoqërim i elementeve të dy bashkësive është funksion;	4. Cili nga shoqërimet e mëposhtme është funksion? a) shkronjat e alfabetit me shkronjën e parë të emrit të nxënësit; b) çdo nxënës me vlerësimin e tij në test; c) çdo nxënës me numrin e tij të ditarit. Argumentoni përgjigjen.
.....	.....

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të grupit të objekteve që tregojnë bashkësi, të gjetjes së elementeve të një bashkësie, të paraqitjes së bashkësisë në tri mënyra, e gjetjes së lidhjeve të bashkësive kur këto janë funksion, për gjetjen e domenës dhe kodomenës së një funksioni, paraqitjen e funksionit me tabelë, diagram dhe dyshe të renditura dhe me grafik, përdorimin e konceptit të funksionin në situata praktike, në gjetjen e rregullit të plotësimit të kufizave të vargut, plotësimin me kufiza të tjera një varg numerik, gjetjen e kufizave të vargut të Fibonaccit, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Funksione dhe vargje numerike

#### Rezultati i të nxënit të temës:

- Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.
- Identifikon koordinatat e pikës (dyshe të renditur) në rrjetin koordinativ.
- Vendosi pikat në rrjetin koordinativ.
- Dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

- 1.3 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.
- 2.3 Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave të ndryshme matematikore.
- 3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Vlerësim**

**FJALËT KYÇE:** bashkësi, elementë të bashkësisë, ndryshore, bën pjesë, nuk bën pjesë, emërtim, diagrame Veni, përshkrim, dyshtet e radhitura, funksioni, bashkësia e përcaktimit të funksionit (domena e funksionit), bashkësia e vlerave të funksionit (kodomena), tabelë, grafik vargu, varg me figura, vargu numerik, kufiza paraardhëse dhe pasardhëse, rregulli për formimin e vargut.

**Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshtet e renditura në rrjetin koordinativ;
- identifikon koordinatat e pikës (dyshtet e renditura) në rrjetin koordinativ;
- vendos pikat në rrjetin koordinativ;
- dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa).

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të grupit të objekteve që tregojnë bashkësi, të gjetjes së elementeve të një bashkësie, të paraqitjes së bashkësisë në tri mënyra, e gjetjes së lidhjeve të bashkësive kur këto janë funksion, për gjetjen e domenës dhe kodomenës së një funksioni, paraqitjen e funksionit me tabelë, diagram dhe dyshtet e renditura dhe me grafik, përdorimin e konceptit të funksionit në situata praktike, në gjetjen e rregullit të plotësimit të kufizave të vargut, plotësimin me kufiza të tjera një varg numerik, gjetjen e kufizave të vargut të Fibonaccit, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përsërisin njohuritë e temës.

----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

# ◀ TEMA 12

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë përfundime.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

1.4 Kryen vrojtime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe organizimi i të dhënave. Piktogramet

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, popullimi, individi, tipar statistikor, piktogrami

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon popullin, individin, tiparin në një studim statistikor;
- dallon piktogramin, si një nga format e paraqitjes së të dhënave të grumbulluara;
- paraqit të dhënat me ndihmën e piktogramit;
- demonstroi shembuj nga jeta e përditshme e grumbullimit të të dhënave për një studim të caktuar.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune



**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi  
Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë **“Kërkoni dhe zbuloni”**.

Nëpërmjet shenjave si ajo që një libër paraqet 4 libra, ne mund të tregojmë sa libra ka lexuar secili nga 5 nxënësit (Agimi, Besniku, Drita, Edlira, Genci), gjatë pushimeve verore, si në figurë.

Agimi	Besniku	Drita	Edlira	Genci
				
4	8	16	12	8


- Cili nxënës ka lexuar më shumë?
- Cilët nxënës kanë lexuar të njëjtin numër librash?
- Cili nxënës ka lexuar më pak?

A mund të përzgjidhni një simbol tjetër për të treguar sa ka libra ka lexuar secili nxënës?  
Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimin duke përzgjedhur një simbol tjetër.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/  
organizuesi grafik

Diskutimi i situatave të mësipërme, nxënësit kuptojnë që për të marrë përgjigje për një çështje i duhet:

- të mblidhen të dhënat për problemën që duam të shqyrtojmë;
- të sistemohen këto të dhëna;
- të përpunohen këto të dhëna;
- të interpretohen këto të dhëna.



Nxiten nxënësit të japin shembuj ku të dallojnë popullimin, individin dhe tiparin.

Piktogrami një mënyrë e të paraqiturit të dhënave të grumbulluara.

Vrojtohen shembujt e dhënë në rubrikën “Vrojtoni dhe mësoni”.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të punojnë detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar” duke i komentuar përgjigjet. Për secilin nga rastet, iu kërkohet që secili grup të zgjedhë vetë shenjën treguese të piktogramit.

Punohet për të mblledhur të dhënat në lidhje me pyetjen e ushtrimit 3: Me cilin sport merreni në kohën e lirë? Grupet përcaktojnë simbolin me të cilin do të plotësojnë piktogramin. Pasi të kenë grumbulluar të dhënat e nevojshme dhe të kenë plotësuar piktogramet e tyre, iu përgjigjen

kërkesave të ushtrimit.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimin e rubrikës “Ushtrime”.

Detyrat e zgjidhura do t'i prezantojnë me radhë në tabelë duke i diskutuar edhe me mësuesin/en.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të popullimit, individit, tiparit statistikor që do të studiohet, plotësimi i piktogramit, dhe interpretimi i tij, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

**Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë përfundime.

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Tabelat statistikore**

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, popullimi, individi, tipar statistikor, tabela statistikore, denduria

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- tregon informacionin e grumbulluar me ndihmën e tabelës statistikore;
- interpreton informacionin e dhënë nga një tabelë statistikore;
- gjen dendurinë për një vlerë të dhënë të tiparit statistikor;
- demonstron shembuj nga jeta e përditshme në përdorimin e tabelave statistikore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë "Kërkoni dhe zbuloni".

Nga nxënësit kërkohet t'u përgjigjen pyetjeve:

- Ku janë dhënë të dhënat për sipërfaqet e oqeaneve?
- A mund të tregoni raste të tjera ku të dhënat jepen në tabelë?
- Nga libri i matematikës plotësoni një tabelë ku të keni të dhëna për numrin e njësive mësimore që ka teksti, figurat që janë përdorur, për numrin e punëve në grup, numrin e figurave gjeometrike që ka teksti. Detyra punohet duke e ndarë klasën në grupe.

Krahasohen të dhënat ndërmjet grupeve. Më pas i jepet zgjidhje situatës të paraqitur në libër.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë syprinat e oqeaneve të Tokës (matur në milionë km<sup>2</sup>).

Emri i oqeanit	Syprina (milionë km <sup>2</sup> )
Paqësor	178
Indian	75
Atlantik	92
Arktik	15

- a) Radhitni oqeanet sipas syprinës, nga më i vogli te më i madhi.  
 b) Tregoni oqeanet që i kanë syprinat midis 50 dhe 100 (milionë km<sup>2</sup>).

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Diskutimi i situatave të mësipërme, nxënësit kuptojnë që të dhënat e mara në një studim statistikor tregohen me ndihmën e tabelave statistikore, ku në rreshtin e parë jepet vlera e tiparit statistikor dhe në të dytën sa herë e gjejmë këtë vlerë të tiparit në informacionin që grumbullohet (denduria).



Vrojtohet shembulli i dhënë në rubrikën “Vrojtoj dhe mësoj”.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim

Ftohen nxënësit të punojnë detyrat e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**” duke i komentuar përgjigjet. Për secilin nga rastet iu kërkohet që secili grup të demonstrojë zgjidhjen e tij në “telin e tharjes”. Në ushtrimin 4 ku kemi një zbatim nga praktika nxënësit krijojnë tabelën statistikor me dy denduritë dhe për vitin 2002 dhe 2009. Vrojtojnë ndryshimet e popullsisë në këto vite.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimin e rubrikës “**Ushtrime**”.

Përfaqësues të grupeve demonstrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të popullimit, individit, tiparit statistikor që do të studiohet, vlerën e tiparit statistikor, dendurinë ndërtimin e tabelës statistikore, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë përfundime.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.8 Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III.6 Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

2.1 Klasifikon numrat racionalë sipas vetive të caktuara.

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Diagramet me shtylla

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, popullimi, individi, tipar statistikor, tabela statistikore, denduria, diagramet

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- tregon informacionin e grumbulluar me ndihmën e tabelës statistikore;
- ndërton diagramin shtyllë;
- interpreton informacionin e dhënë në një diagram statistikor;
- demonstroi shembuj nga jeta e përditshme e diagrameve duke interpretuar informacionin e tyre.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, kompjuter, vizore, fletë A4.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** Punë në grupe/bashkëbisedim

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.

Në tabelën e mëposhtme tregohet koha që harxhojnë disa nxënës për rrugën shtëpi-shkollë.

Emri i nxënësit	Tani	Selina	Olsi	Irma	Marita
Koha (në min)	10	25	15	30	15

Vizatoni një kënd të drejtë dhe vendosni në brinjën horizontale emrat e nxënësve (secili emër të paraqitet me një segment). Në brinjën vertikale vendos një shkallëzim për kohën. Tani kohën për rrugën shtëpi-shkollë, për secilin nxënës, mund ta paraqitni me një shtyllë me një lartësi të caktuar. shtylla ka:


a) si bazë emrin e nxënësit; b) si lartësi kohën përkatëse.

Diskutoni për diagramin që morët.

Në kompjuter në programin e Microsoft Office Excel punoni tabelën me të dhënat e mësipërme. Me udhëzimet e mësuesit/es provoni të ndërtoni diagrame të ndryshme. Bashkëbisedoni me shokun për llojet e diagrameve që ndërtuat.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe

Zgjidhja e situatës së mësipërme do të çojë në ndërtimin e diagramit shtyllë.



Udhëzohen nxënësit të ndërtojnë diagramin e shembullit të dhënë në rubrikën e dytë të mësimit “Vrojtoni dhe mësoni”. Udhëzohen që mund të bëjnë diagramin dhe shtylla horizontale, ose dhe vetëm me segmente etj.

Hidhen të dhënat në kompjuter dhe nxënësit krijojnë forma të ndryshme të diagrameve.

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim

Ftohen nxënësit të punojnë detyrat e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar”. Grupet e nxënësve udhëzohen të bëjnë diagrame të ndryshme. Për secilin nga rastet iu kërkohet që secili grup të demonstrojë zgjidhjen e tij në “telin e tharjes”. Në ushtrimin 4 ku kemi një zbatim nga praktika me të dhëna të sakta për sipërfaqet e kontinenteve ndërtohen diagrame shtyllë vertikale dhe horizontale.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë ushtrimin e rubrikës “Ushtrome”. Iu kërkohet të bëjnë diagrame shtylla horizontale dhe vertikale.

Përfaqësues të grupeve demonstrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të popullimit, individit, tiparit statistikor që do të studiohet, vlerën e tiparit statistikor, dendurinë, ndërtimin e tabelës statistikore, ndërtimin e

diagrameve të ndryshme, interpretimin e informacionit të dhënë në to, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

**Rezultati i të nxënës të temës:**

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë përfundime.

**Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

III.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlikuar ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Si të realizojmë një anketë*

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, anketa, pyetjet e anketës, popullimi, individi, tipar statistikor, tabela statistikore, denduria, diagramet

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon të dhënat parësore dhe dytësore;
- shkruan pyetje të qarta për një anketë;
- realizon anketën dhe mbledh informacionin e duhur;
- interpreton informacionin që ka grumbulluar;
- demonstroi shembuj nga jeta e përditshme të përdorimit të anketave.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, kompjuter, vizore, fletë A4.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim/stuhi mendimesh

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për ti dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.

Në një fletë A4, nxënësve iu jepen disa pyetje:

1. Si ndryshon temperatura e ujit në një enë, gjatë kohës që ai ngrohet?
2. Cilët janë filmat e preferuar nga shokët e mi të klasës?
3. Sa nxënës në klasën time kanë flokë gështenjë?
4. A mendoni se do të bjerë shi gjatë 20 minutave të ardhshme?
5. Sa pjesëtarë jeni në familje?
6. Sa kohë harxhoni duke luajtur lojëra elektronike?
7. Si ka ndryshuar numri i popullsisë së Kosovës?
8. Cili nga librat shkollorë ka përdorur më shumë diagrame?
9. Sa nxënës ka secila klasë në shkollën tonë?
10. Sa është gjatësia e nxënësve të klasës sonë?

Tregoni si mund të mblidhni të dhëna për pyetjet e mësipërme, (me anketë, me vëzhgim apo me matje).

Mësuesi mund të hartojë vetë pyetje të tjera.

### Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe

Nxënësit në rastet e mësipërme dallojnë të dhënat parësore dhe ato dytësore.

Si mund të hartoni një anketë?

1. Formulohet pyetja për çështjen që na intereson.
2. Të pyeturve u jepet një sasi përgjigjesh të mundshme, nga të cilat ata duhet të zgjedhin njërin.
3. Hartohet një fletë shënimesh për përgjigjet që merren (për çdo përgjigje të mundshme shënohet sa herë është zgjedhur ajo).
4. Të dhënat paraqiten në mënyrë të përshtatshme:

- me tabelë;
- me diagram me shtylla;

5. Përfundimet nxirren duke interpretuar tabelën, diagramin ose grafikun.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të kryejnë anketa me nxënësit e klasës për një pyetje që do të përzgjedhin vetë të dhëna në ushtrimin 3 në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**”. Për secilin nga rastet, nxënësit udhëzohen të ndërtojnë tabelën statistikore, si dhe të paraqesin të dhënat me anën e diagramit. demonstrohet zgjidhjen e situatës në “telin e tharjes” dhe bashkëbisedohet me nxënësit.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimin e rubrikës “**Ushtrime**”. Iu kërkohet të bëjnë diagrame shtyllë horizontale dhe vertikale.

Përfaqësues të grupeve demonstrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e hartimit të pyetjeve të anketës, grumbullimin e informacionit, organizimin e tij në tabelë statistikore, ndërtimin e diagramit dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

<b>Fusha kurrikulare:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla e kurrikulës:</b> III	<b>Klasa:</b> VI (gjashtë)
---	-----------------------------	-------------------------------------	-------------------------------

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### **Rezultati i të nxënit të temës:**

- Llogarit mesataren aritmetike, modën dhe medianën nëpërmjet të dhënave.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

4.2 Integron njohuritë e shprehitë matematike me situatë ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

**ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Mesataret**

FJALËT KYÇE: **statistika matematike, mesorja, mesatarja aritmetike, moda, amplituda**

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- gjen modën, mesoren, mesataren aritmetike, amplitudën në një studim statistikor;
- shpjegon në një studim statistikor rëndësinë e secilës prej tyre;
- demonstroi shembuj nga jeta e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, A4.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS  
ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë "Kërkoni dhe zbuloni".

- Agimi mat temperaturën më të lartë të ditës për një javë. Gjatë matjeve, ai mori përkatësisht vlerat: 30°C; 32°C; 29°C; 27°C; 30°C; 33°C; 35°C.

Iu kërkohet nxënësve:

- a) Të rendisin temperaturat nga vlera më e ulët në më të lartën.
- b) Të gjejnë vlerën më të lartë dhe më të ulët të temperaturës.
- c) Të gjejnë cila është vlera e temperaturës në mes të vargut?
- d) Të gjejnë se cila vlerë e temperaturës matur më shumë.
- e) Të gjejnë ndryshimin ndërmjet temperaturës më të lartë dhe më të ulët.

f) Të gjejnë temperaturën mesatare të javës.  
Të demonstrojnë përgjigjet e tyre në tabelë nga nxënësit.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe/organizuesi i njohurive**  
Dhënia e përgjigjes për pyetjet e mësipërme do të kërkojë sqarimin e koncepteve:

Koncepti	Si e kupton	shembull
Mesorja (mediana)	Vlera në mes të vargut statistikor kur është renditur nga më e vogla tek më e madhja	30 gradë
Moda	Vlera me denduri më të madhe	30 gradë
Mesatarja aritmetike	Herësi i shumës së të gjitha vlerave statistikore me numrin e tyre .....	$\frac{27 + 29 + 2 \cdot 30 + 32 + 33 + 35}{7} =$
Amplituda		.....

Ftohen nxënësit të vrojtojnë shembullin e zgjidhur në tekst për të gjykuar se cili prej nxënësve është më i suksesshëm, duke vrojtuar mesataren, modën, shtrirjen (amplitudën e notës).

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të punojnë ushtrimet e dhëna në rubrikën “**Ushtrohuni duke zbatuar**”. Për secilin nga rastet, nxënësit gjejnë modën, mesoren, mesataren, amplitudën. Përgjigjet e ushtrimeve diskutohen mes grupeve.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimin e rubrikës “**Ushtrime**”.

Përfaqësues të grupeve demonstrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e gjetjes së mesores, modës, mesatares aritmetike dhe amplitudës në një studim statistikor, demonstrimi në situata të veprimtarisë së përditshme.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.).
- Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.
- 4.3 Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

## ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Kuptimi i probabilitetit

**FJALËT KYÇE:** ngjarje, mundësia e ndodhjes së ngjarjes, ngjarje të mundshme, të sigurta, të pamundura, probabiliteti

### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon një ngjarje kur është e mundur e sigurt ose e pamundur;
- përkufizon probabilitetin si masë të ndodhjes së ngjarjes;
- demonstroi shembuj nga veprimtaria e përditshme.

### Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Matematika, fletore pune, A4.

### Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim/lojë me zare**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.

Bashkëbisedoni me shokët për mundësinë e ndodhjeve të ngjarjeve:

- a) A do të bjerë shi nesër?
- b) Nëse hidhni një zar, cili numër do t’ju bjerë?

Kërkohet nga nxënësit të sjellin shembuj të tjerë ngjarjeve ku të bashkëbisedohet për mundësinë e ndodhjes së tyre.

Loja me zare. Një nga nxënësit e klasës hedh një zar. Bashkëbisedohet për mundësitë e rënies së zarit. Çfarë numri mund të bjeri?

Loja me letra. Tërheqim një letër. Çfarë letre ka mundësi të tërheqim?

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe/organizuesi i njohurive**

Dhënia e përgjigjes për pyetjet e mësipërme do të kërkojë sqarimin e koncepteve:



Bashkëbisedohet rreth këtyre koncepteve, duke vrojtuar dhe shembujt e tekstit.

Ndahet klasa në grupe. Secili prej grupeve përfshihet në njërën nga lojërat:

1. Në një qese fusim karamеле të njëjta po me letra të ndryshme p.sh. 4 të kuqe, 5 të verdha, 3 jeshile. Fusim dorën dhe nxjerrim rastësisht njërën prej tyre.
2. Në shirita të njëjtë letre shkruhen germa të fjalës “libër”. Të kthyerat përmbys. Tërhiqet rastësisht njëra prej tyre.
3. Hidhet një monedhë.
4. Tërhiqet rastësisht një letër nga tufa e letrave.
5. Cili nxënës do të ngrihet në tabelë?

Udhëzohen nga mësuesi/ja të shikoj ngjarje të sigurta, të mundshme dhe të pamundshme.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të punojnë ushtrimet e dhëna në rubrikën “Ushtroni duke zbatuar”. Për secilin nga rastet, nxënësit gjykojnë për mundësinë e ndodhjes së ngjarjes, duke dalluar ngjarjet e mundshme, të pamundura dhe të sigurta. Përgjigjet e ushtrimeve diskutohen mes grupeve.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimin e rubrikës “Ushtrime”.

Përfaqësues të grupeve demostrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të llojit të ngjarjes, për shpjegimin e konceptit të probabilitetit, demonstrimin në situata të veprimitarisë së përditshme.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

### ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

#### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.).
- Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

#### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

### ASPEKTET SPECIFIKETË PLANITË ORËS MËSIMORE

*Njësia mësimore: Probabiliteti për ngjarjet me rezultate njëloj të mundshme*

**FJALËT KYÇE:** ngjarje, mundësia e ndodhjes së ngjarjes, ngjarje të mundshme, të sigurta, të pamundura, probabiliteti, rastet e mundshme, rastet favorizuese.

#### Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon një ngjarje kur është e mundur e sigurt ose e pamundur;
- përkufizon probabilitetin si masë të ndodhjes së ngjarjes;
- demonstroi shembuj nga veprimtaria e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim/lojë me zare**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë “Kërkoni dhe zbuloni”.

Bashkëbisedoni me shokët për mundësinë e ndodhjeve të ngjarjeve;

Loja me zare

- Hedhim një zar kubik me 6 numra të lojës “Mos u nxeh”.

a) Cilat janë rezultatet e mundshme të kësaj prove?

b) A janë njëloj të mundshme rezultatet: i) bie 2; ii) bie 5; iii) bie 6?

c) A ka rezultat tjetër veç rezultatit “Zari bie ose 1, ose 2, ose 3, ose 4, ose 5, ose 6”?

- Hedhim një monedhë.

a) Cilat janë rezultatet e mundshme të kësaj prove?

b) A janë njëloj të mundshme rezultatet: i) bie stemë; ii) bie numër.

c) A ka rezultat tjetër veç rezultatit “monedha bie ose stemë, ose numër”?


- Hedhim një kuti shkrepëse.

A kanë mundësi të njëjtë të gjitha faqet e kutisë që të bie? Pse?

Nxiten nxënësit të diskutojnë.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe/organizuesi i njohurive**

Dhënia e përgjigjes për pyetjet e mësipërme do të kërkojë sqarimin e koncepteve:



Vrojtohet shembulli i zgjidhur i tekstit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ftohen nxënësit të punojnë ushtrimet e dhëna në rubrikën “Ushtrohuni duke zbatuar”. Për secilin nga rastet, nxënësit gjykojnë për mundësinë e ndodhjes së ngjarjes, duke dalluar ngjarjet

e mundshme, të pamundura dhe të sigurta, gjejnë numrin e rasteve të mundshme të ngjarjes, numrin e rasteve që favorizojnë ngjarjen dhe njësojnë probabilitetin. Përgjigjet e ushtrimeve diskutohen mes grupeve.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimin e rubrikës “Ushtrime”.

Përfaqësues të grupeve demostrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të llojit të ngjarjes, të numrit të mundësive të ndodhjes së ngjarjes, të mundësive që favorizojnë ngjarjen, njësimin e probabilitetit për ngjarjet e sigurt, të mundshme dhe të pamundur, demonstrimi në situata të veprimtarisë së përditshme.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

### ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi.
- Përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur probabilitetin.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.4 Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: a. gjuhën e përditshme; simbole matematike; b. fjalorin fillestar matematik; c. paraqitje të ndryshme.

5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Probabiliteti statistikor**

FJALËT KYÇE: ngjarje, prova, probabiliteti statistikor

**Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- dallon probabilitetin statistikor;
- kryen prova të ndodhjes së një ngjarje duke shënuar mundësitë që ndodhin;
- njëson probabilitetin statistikor të ndodhjes së një ngjarje;
- demonstroi shembuj nga veprimtaria e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika, fletore pune, fletë A4.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës.

Shembuj nga jeta e përditshme të studimit të disa të dhënave për një qëllim të caktuar.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe/bashkëbisedim/lojë**

Mësuesi/ja fton nxënësit të bashkëbisedojnë për t'i dhënë përgjigje situatës problemore të dhënë në tekst në rubrikën e parë "Kërkoni dhe zbuloni".

Rikujtojmë hedhjen e një kutie shkrepëse ku shënojmë me A, B, C faqet duke filluar nga faqja më e madhe deri te faqja më e vogël.

Hedhim kutinë dhe shqyrtojmë ngjarjet:

- 1) bie faqja A;
- 2) bie faqja B;
- 3) bie faqja C.

Nëse do të luanit lojën "Zgjidh faqen", cilën faqe do të zgjidhni?

A kanë faqet të njëjtën mundësi për të rënë? Cila faqe ka mundësinë më të madhe për të rënë? Pse?

Hidhni kutinë e shkrepëses disa herë dhe mbani shënim për ngjarjen që ndodh.

Luani më zarin. Hidhni disa herë zarin dhe mbani shënim numrin që bie.

**Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim/punë në grupe/organizuesi grafik i njohurive**

Dhënia e përgjigjes për pyetjet e mësipërme do të kërkojë sqarimin e koncepteve:

- probabilitetin statistikor. → numrin e pjesëve që ndodhin
- numrin e provave që kryhen

Vrojtohet shembulli i dhënë në libër.

Udhëzohen nxënësit të japin përgjigje për punën në grup.

A mund të arrijmë, nga këto rezultate, në përfundimin se, nëse e hedhim kutinë 30 herë, ajo do të bjerë 26 herë A, 3 herë B dhe 1 herë C? Argumentoni përgjigjen. Bashkëbisedohet rreth këtyre koncepteve duke vërtetuar dhe shembujt e tekstit.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedim**

Ptohen nxënësit të punojnë ushtrimet 1 dhe 2 të dhëna në rubrikën “**Ushtroni duke zbatuar**”. Për secilin nga rastet, nxënësit gjykojnë pasi kanë kryer provat e kërkuara. Përgjigjet e ushtrimeve diskutohen mes grupeve.

Iu jepet kohë nxënësve të punojnë në grupe ushtrimin e rubrikës “**Ushtrime**”.

Përfaqësues të grupeve demostrojnë zgjidhjen e ushtrimit në tabelë duke argumentuar përgjigjet.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit të llojit të ngjarjes, për gjetjen e numrit të rasteve që ndodhin gjatë kryerjes së provave dhe njësimit e probabilitetit statistikor, demonstrimi në situata të veprimtarisë së përditshme.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen për detyrat e shtëpisë në Fletoren e punës dhe u jepen udhëzime se si të zgjidhen ato.

## **----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----**

## **ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:**  
Matematikë

**Lënda:**  
Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**  
III

**Klasa:**  
VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### **Rezultati i të nxënësve të temës:**

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë konkluzione.
- Llogarit mesataren aritmetike, modën nëpërmjet të dhënave.
- Përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.).
- Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi.
- Përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

3.3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë etj.) dhe simbolet algjebrike e geometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

3.5 Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale.

6.3 Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE**

### ***Njësia mësimore: Çfarë mësuam (përsëritje)***

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, popullimi, individi, tipar statistikor, piktogrami, tabela statistikore, denduria, diagramet, anketa, pyetjet e anketës, mesorja, mesatarja aritmetike, moda, amplituda, ngjarje, mundësia e ndodhjes së ngjarjes, ngjarje të mundshme, të sig-urta, të pamundura, probabiliteti, prova, probabiliteti statistikor.

### **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë);
- pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë konkluzione;
- llogarit mesataren aritmetike, modën, nëpërmjet të dhënave;
- përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.);
- përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi;
- përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.

### **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

### **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe dyshe/bashkëbisedim/ditari i dyfishtë**

Nxiten nxënësit të kujtojnë çfarë kanë mësuar gjatë kësaj teme, duke plotësuar kolonën e parë të ditarit.

Tashmë kemi mësuar	Provoni të zgjidhni.
cilët janë popullimi, individi dhe tipari në një problem statistikor;	1. Dalloni popullimin, individin dhe tiparin: a) gjatë studimit të numrit të votuesve në një qendër votimi; b) gjatë studimit të numrit të popullsisë në vendet e Ballkanit.
si të lexoni dhe të interpretoni të dhënat e marra nga një pyetësor apo eksperiment;	2. Në periudhën 1-10 shkurt u mat temperatura më e lartë ditore: 10°C; 8°C; 6°C; 6°C; 7°C; 9°C; 10°C; 12°C; 12°C; 10°C. a) Cila është temperatura më e lartë? Po më e ulët? b) Në sa ditë është regjistruar temperatura më e lartë? Po më e ulëta? c) Paraqitini të dhënat me ndihmën e një piktogrami.
si të paraqitni të dhënat me tabelë dhe të gjeni dendurinë në një problem statistikor.	3. a) Paraqitni të dhënat e ushtrimit të mësipërm në tabelë. Gjeni denduritë. b) Ndërtoni një diagram me shtylla, për të paraqitur të dhënat.
.....	.....

### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe ushtrimet e kolonës së dytë të ditarit.

Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Zgjidhjet e ushtrimeve paraqiten dhe në tabelë duke argumentuar veprimet e kryera.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit e popullimit, individit dhe tiparit statistikor, grumbullimin e informacionit, gjetja e mesores, mesatares aritmetike, modës, amplitudë, paraqitja e të dhënave me diagrame, përcaktimi i llojit të ngjarjes, e sigurt, e mundshme, e pamundur, mundësitë që mundësojnë dhe ato që favorizojnë ngjarjen, njësimin e probabilitetit, probabilitetin eksperimental, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për detyrat e shtëpisë të përsëriten njohuritë e kreut.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----

## ASPEKTET E PËRGJITHSHMETË PLANITË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:**

Matematikë

**Lënda:**

Matematikë

**Shkalla e kurrikulës:**

III

**Klasa:**

VI (gjashtë)

**Tema:** Statistikë dhe probabilitet

### Rezultati i të nxënit të temës:

- Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë konkluzione.
- Llogarit mesataren aritmetike, modën nëpërmjet të dhënave.
- Përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.).
- Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi.
- Përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj.
- Zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
- III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

### Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- 3.3 Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.
- 4.2 Integron njohuritë e shprehjetë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).
- 5.1 Përdor rregullat dhe paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANITË ORËS MËSIMORE

### Njësia mësimore: Vlerësim

**FJALËT KYÇE:** statistika matematike, popullimi, individi, tipar statistikor, piktogrami, tabela statistikore, denduria, diagramet, anketa, pyetjet e anketës, mesorja, mesatarja aritmetike, moda, amplituda, ngjarje, mundësia e ndodhjes së ngjarjes, ngjarje të mundshme, të sigurta, të pamundura, probabiliteti, prova, probabiliteti statistikor

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat (duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike etj.) për të nxjerrë konkluzione;
- llogarit mesataren aritmetike, modën, medianën nëpërmjet të dhënave;
- përkufizon konceptin e ngjarjes, e paraqet në formë numerike përmes shembujve (p.sh. hedhja e zarit, hedhja e monedhës metalike etj.);
- përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundura duke përdorur shprehjet: me siguri, ka mundësi, me mundësi të barabartë, ka më pak mundësi, nuk ka mundësi;
- përkufizon probabilitetin e një ngjarjeje dhe cakton probabilitetin e saj;
- zgjidh problema nga jeta e përditshme, duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Matematika

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur/vlerësim i shokut nga shoku**

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e dhëna për vlerësim. Iu jepet kohë e mjaftueshme për të punuar ushtrimet.

Këmbehen fletat e zgjidhjes së ushtrimeve ndërmjet shokëve të bankës.

Bashkëbisedohet rreth zgjidhjes së ushtrimeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përcaktimit e popullimit, individit dhe tiparit statistikor, grumbullimin e informacionit, gjetja e mesores, mesatares aritmetike, modës, amplitudë, paraqitja e të dhënave me diagrame, përcaktimi i llojit të ngjarjes, e sigurt, e mundshme, e pamundur, mundësitë që mundësojnë dhe ato që favorizojnë ngjarjen, njësimin e probabilitetit, probabilitetin eksperimental, argumentimin e zgjidhjes së situatës problemore.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për detyrat e shtëpisë të përsëriten njohuritë e kreut.

## ----- Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore -----



## Referenca

1. **Kurrikula Bërthamë** e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (Klasa VI, VII, VIII dhe IX), gusht 2016
2. **Udhëzues praktik për zbatimin e Kurrikulës**-Fusha e kurrikulës Matematika, prill 2018
3. **Kurrikulat Lëndore/Programet Mësimore** Klasa e gjashtë, Prishtinë, 2017
4. **Zhvillimi i Shkathtësive të Shekullit 21 në Lëndën e Matematikës** - [www.kec-ks.org](http://www.kec-ks.org)
5. **Matematika 6**

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

37.016:51(072)(075.2)

Reka, Fatbardha

Matematika 6 : libër për mësuesin/en : për klasën e 9-të të  
arsimit 9-vjeçar / Fatbardha Reka,. - Prishtinë : Pegi, 2024. -  
331 f. : ilustr. ; 28 cm

ISBN 978-9951-843-16-4



**Libër për mësuesin/en**

**Matematika** **6**

ISBN: 978-9951-843-16-4



9 789951 843164